



Shqip



Drejtor **BESNIK MYFTARI**
 Kryeredaktor **BLEDAR ZAGANJORI**
 Zv/Kryeredaktor **URIM BAJRAMI**

Viti II - Nr. 39 (330) E hënë, 12 shkurt 2007 E përditshme e pavarur Çmimi 30 lekë, 1.5 euro

Adresa e redaksisë:
 Bulevardi "Zogu i Parë",
 Pallati 13-katësh, Ap. 3
 Tel: 04 272 565 • 068(9) 20 35 300
 E-mail: info@gazeta-shqip.com
 www.gazeta-shqip.com

Tubimi i "Vetëvendosjes" kthehet në tragjedi. Të lënduarit nga policia nuk mbijetuan dot. Ekipi i Unitetit fajëson Albin Kurtin

Prishtinë, tre të vdekur pas protestës



Që sot,
 "Topnews"
 fillon
 transmetimin



NE FAQEN 4

LA REPUBBLICA

Shqetësimet e një province
 Drama e Kosovës
 në limbo-n
 e pavarësisë

Mensa e manastirit ortodoks të Deçanit në Kosovën Perëndimore, në kufirin mes Maqedonisë dhe Shqipërisë, është bosh. Prifti Sava dhe peshkopi Teodosie, pas takimit me ministrin e Jashtëm...

NE FAQEN 4

SHQIPNI TAVOLINASH

ARTAN LAME

Që të mos mbash të gjitha premtimet që bën në fushatë, është gjë normale ngado. Që të ndërrosh mendje për çështje të caktuara për shkak të ndryshimit të situatave, të njohjes më të thellë të problemeve kur je në qeverisje edhe kjo habet (nuk është shumë normale, por si-dogoftë habet). Por t'u biesha hasha të gjitha atyre ç'ka ke thënë në fushatë, është pak si shumë. Shiheni tabelën që ju sjell këtu dhe zori të më gjeni ndonjë pasaktësi në të. Sipas rregullave të kohëve që jetojmë, njerëzit votojnë dhe zgjedhin për një program të caktuar dhe për një varg gjërash të premtuara. Por, po qe se të gjitha ato që ke premtuar dalin si ke thënë gabim apo u bie hasha pa të keq, do goxha kurajo në bark dhe...

NE FAQEN 11

Nxehet edhe më shumë fushata elektorale. Pas incidenteve dhe përplasjeve fizike mes kandidatëve, nisin tubimet e paligjshme

PD, antimiting Majkos në Postribë

Shtohen tensionet. Një grup militantësh tentojnë të bllokojnë mitingun. Ndërhyn policia

OPINION

Matrapazët
 e demokracisë

MENTOR KIKIA

Në për lagjet e fshatit diën mund të futesh lirshëm fare, pasi qentë janë të gjithë në gjumë të thellë, sepse gjithë natën fshati gjëmon nga të lehurat e tyre. Janë korrierët, korrierët e kandidatëve që futen natën nëpër shtëpitë e fshatarëve dhe bëjnë fushatë". - Po çfarë thonë, si e bëjnë fushatën natën? - E ç'të na thonë? Diku premtojnë miell, diku 20 apo 30 mijë lekë (të vjetra) për familje. Kështu është bërë tani. Këtu kryetari i komunës kandidon për PS-në, shefi i urbanistikës së komunës për PDK-në. Ai është me PD-në në fakt, por s'vijet kaloi me demokristianët...

NE FAQEN 10

Antimitingjet janë rishfaqur sërish gjatë fushatës aktuale për zgjedhjet e pushtetit vendor, pas një mungese të gjatë në jetën politike shqiptare. Në Postribë të Shkodrës, militantët të Partisë Demokratike kanë tentuar të bllokojnë një takim elektorale të parashikuar nga PS-ja lokale, në të cilin merret pjesë edhe sekretari i Përgjithshëm i kësaj partie, Pandeli Majko. Situata është normalizuar vetëm nga ndërhyrja e policisë, e cila ka bërë të mundur evitimin e një përplasjeje të dhunshme midis përkrasheve të të dy partive.

NE FAQEN 5

I PENDUARI

Dëshmoi për linjën Shqipëri-Itali
 Droga, një tjetër shok
 tradhton Lul Berishën

NE FAQEN 6

Në Kosinë të Përmetit, ku banorët e tronditur jetojnë ende me skandalin e eshtrave
 Greqia dënon fshatin e zhvarrimeve,
 tani nuk u jep viza as ortodoksëve



REPORTAZH NGA KAMBER VELAJ FOTO: BEVIS FUSHA NE FAQET 22-23

KOMENT

Ballafaqimet
 televizive
 dhe mungesa
 e modeleve

MUSTAFA NANO

Të gjitha fushatat elektorale të zhvilluara në Shqipëri në postkomuniste janë dominuar nga kacakfytet e partive dhe të kandidatëve, të cilat kanë prodhuar pa fund akuzat, sharjet, fyerjet, denigrime në adresë të shokut, e deri dhunë midis ushtrive të militantëve të të dy krabëve. E megjithatë, në gjithë këtë shernajë gjigante, që vijon për drek edhe në periudhat midis fushatave, nuk kanë munguar edhe do shembuj të mirë. Ka pasur pra tek-nuk ndonjë kandidat, i cili ka bërë çmos të mos bëhet pjesë e kontekstit rrugësor elektorale. Por këta shembuj kanë qenë sporadikë e kanë mbetur të izoluar. Ç'është më e keqja, pjesëmarrës të tillë në garat elektorale ose kanë mbetur të pashpërblyer me mbështetje nga ana e zgjedhësve, ose nuk kanë mundur të garojnë për së dyti, ngaqë partia e tyre ka parë tek ata ca personazhe të sqaqur e të dobët. Dhe kështu janë zhvendësuar nga aspirantët të tjerë për deputetë apo për kryetarë bashkish e komunash, të cilët kanë qenë e janë më afër modelit rutinor, që prodhon e përgjeron politika shqiptare: kandidati që ka mundësi të mbledhë parë, që ka mundësi të bëjë për vete banda të zhurmshme militantësh e mercenarësh, e që nuk ka skrupuj, kur vjen puna për ta kryqëzuar rivalin e tij me të gjitha mënyrat e mjetet e mundshme...

NE FAQEN 10

BOTA



Socialistja
 Royal, "pakt
 nderi" me
 francezët

NE FAQEN 29

SHEGA-GROUP SHA INTERNATIONAL TRANSPORT

- INTERNATIONAL FREIGHT
- FORWARDERS
- CONTAINER SERVICE
- CUSTOMS BROKER

Rr. Tefta Tashko, Tiranë www.shega-trans.com
 Tel 04 255 008/9 Fax 04 255 010

Bushi Sh.p.k. Distributor Ekskluziv për Shqipërinë
 Adresa: Rr.Durrësit "Pallatet Hawai", Lagrarakë, Tiranë

Tel: +355 4 266400 / +355 4 267773
 Fax: +355 4 234115
 E-mail: bushi@albaniainline.net

VARTA

ZGJEDHJE VENDORE 2007
 Vota Juaj Vullneti Juaj

KQZ NJOFTON
 Në faqen 16

Alb Security

Profesionalizmi dhe teknologjia për sigurinë tuaj

- Implante vjedhje - Rrëmbim - Zjarr
- Implant televiziv me qark të mbyllur
- Implant kundër hyrjes perimetrale
- Implant Access Control
- Building Automation

Shoqëri në fazë certifikimi të cilësë ISO 9001

Adresa dhe nr. aktual janë: Rr. Barrikadave, 222 Tirana (Albania)
 Tel: +355 4 274456 - 222977
 Fax: +355 4 274457

Sisteme Antiterorizëm

Kreu i opozitës, takim në njësinë Nr. 9. Biseda me të rinjtë e të majtës

Rama: Fotot e mia thjesht një montazh politik

Kryetari i Partisë Socialiste, njëkohësisht kandidat i opozitës për Bashkinë e Tiranës, vijoi edhe dhe takimet elektorale. Rama nuk u shmang pa komentuar publikimin në shtypin e shkruar të disa fotove. Ai i cilësoi si montazhe politike, që synojnë të fshehin humbjen e sigurt të mazhorancës qeverisë në zgjedhjet e ardhshme. Po dhe Rama ftoi të rinjtë të votojnë të majtën e bashkuar si alternativën më të mirë për një të ardhme evropiane. "Ftoj të gjithë të rinjtë kryeqytetas dhe gjithë të rinjtë e Shqipërisë, si dhe ata që votojnë për herë të parë, ta shfrytëzojnë shansin e madh që u jep 18 shkurti", vlerësoi Rama. Një shans që, sipas tij, jepet për t'i dhënë një goditje të merituar politikës së vjetër, politikës së shpifjeve, të akuzave, politikës së denigrimit dhe cenimit të dinjitetit të njeriut, politikës së baltës. "Është dita për të vendosur për të ardhmen evropiane të Shqipërisë, është dita për të hapur një rrugë të re, nëpërmjet një politike të re", nënvizoi kreu i socialistëve. Do jetë kjo politikë, shtoi ai, që do mund të sigurojë me shumë punësim, jetë, rrugë e cilesi dhe këtë të rinjtë e kryeqytetit dhe të gjithë Shqipërisë do ta ndiejnë si një mision edhe në emër të atyre të cilët në këtë vend u pushtuan, u masakruan. Secili, tha Rama, duhet të thotë fjalën e vet me votën e tij të lirë dhe ku vota e secilit vlen. Aspirant për mandatin e tretë resht në drejtimin e Bashkisë së Tiranës zhvilloi po dhe një takim elektorale me banorët e njësisë vendore nr. 9 në kryeqytet. Në fjalën e tij, para simpatizantëve dhe mbështetësve të selisë rozë, Rama pranoi se me kundërshtarët politikë socialistëve u

ndryshon modeli i qeverisjes. "Do të transformojmë këtë zonë, pasi sot është i papërturueshëm, siç ishte në vitin 2000 transformimi që i bëme Tiranës deri në 2006, pasi modeli ynë është zhvillimi komunitar", theksoi Rama. Sipas tij, transformimi në këtë zonë do të fillojë nga kanalizimet,



"Ftoj të gjithë të rinjtë kryeqytetas dhe gjithë të rinjtë e Shqipërisë, si dhe ata që votojnë për herë të parë, ta shfrytëzojnë shansin e madh që u jep 18 shkurti"

18 shkurtit. Kryetari aktual i Bashkisë së Tiranës kaloi orët e pasdites me të rinjtë në një nga pub-et e kryeqytetit. Ndërsa u ka premtuar edhe këtu të pranishmëve se do të mbahen të gjitha premtimet. Rama akuzoi kryeministrin dhe mazhorancën qeverisë se kanë gënjyer për të gjitha premtimet që kanë bërë. Sipas tij, asgjë nuk është mbajtur nga këto dhe në ato çka thotë mazhoranca ka vetëm demagogji.

D.Malaj

Kandidati i mazhorancës për Bashkinë e Tiranës paraqet platformën për kujdesin social

Olldashi: Do t'i kthejmë bashkisë dimensionin njerëzor

Kandidati i mazhorancës për Bashkinë e Tiranës, Sokol Olldashi, ka vijuar fushatën e tij elektorale duke prezantuar platformën për kujdesin social. Këtë platformë Olldashi e ka prezantuar gjatë takimeve me banorët e zonë nr. 2, ku është shprehur se "Bashkisë së Tiranës i ka mu-

më sot nuk e ka pasur". Duke iu referuar statistikave, Olldashi theksoi se "po t'i shikojmë gjërat në përmasat reale që ato kanë, numri i personave që bëjnë pjesë në grupet në nevojë nuk është i vogël, është gati 140 mijë në Tiranë, nëse konsiderojmë këtu fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit". Sipas tij, "këtu duhet të fillojë ndryshimi, pra kjo është A-ja e ndryshimit që ne do ta fillojmë me hartimin e një regjistri individual për gjithë personat që bëjnë pjesë në grupet në nevojë". Për sa u përket fëmijëve në risk, ku bëjnë pjesë jetimet biologjike, jetimet me një prind apo fëmijët që braktisin shkollën, fëmijët e rrugës dhe viktimat e gjakmarrjes, Olldashi ka theksuar se "kjo është një problematikë tërësisht e neglizhuar nga Bashkia e Tiranës për 6 vjet". Ndërsa për sa i përket personave me aftësi të kufizuara, Olldashi tha se janë 13 mijë e 340 persona, të cilët kanë nevojë për ndihmë. Sipas tij, "deri më sot nuk është bërë asnjë gjë për të garantuar edukimin e këtyre personave, për të stimuluar ata që janë të aftë për punë me mekanizma punësimi, nuk është bërë asnjë gjë për të identifikuar shërbimet në planin e kujdesit shëndetësor



Po t'i shikojmë gjërat në përmasat reale që ato kanë, numri i personave që bëjnë pjesë në grupet në nevojë nuk është i vogël, është gati 140 mijë në Tiranë

dhe për të krijuar një mjedis të pastër, për të cilin ky kontingjent ka nevojë". Ai ka premtuar se në katër vitet e ardhshme do t'u jepet zgjidhje gjithë këtyre problemeve sociale. Gjithashtu, Olldashi ka vijuar takimet e tij elektorale edhe në njësinë nr. 4 dhe nr. 10. Ai është takuar me të moshuar dhe me pas ka zhvilluar një takim me të rinjtë, ku ka shpalosur platformën e tij për këto shtrata. e.gj.

SELIA ROZE

Paragrafi 9 i dokumentit themeltar të partisë parashikon masat ndëshkimore

PS, statuti "djeg" kandidatët e pavarur dhe mbështetësit

Masa të lehta dhe të rënda ndëshkimore për "rebelët"

DARDAN MALAJ

Statuti i ndryshuar i Partisë Socialiste penalizon au tomatikisht anëtarët e këtij subjekti politik, që garojnë si të pavarur në sfidat elektorale. E dhënë kjo e mjaftueshme për t'i dhënë fund hamendjeve të drejtuesve të selisë rozë, nëse mund të përjashtojnë apo jo nga partia kandidatë që kanë dalë kundër marrëveshjes së opozitës së bashkuar. Përtej kësaj ka ende mëdyshje, për shkak se të pavarurit kanë së fundi mbështetjen e disa prej deputetëve socialistë. Në listën e deputetëve që rrisojnë nga statuti janë edhe "rebelët" Ylli Bufi, Kastriot Islami, Taulant Dedja.

Statuti

Në paragrafin 9.4 të statutit të Partisë Socialiste, parashikohen qartë masat që merren ndaj një anëtarit të thjeshtë të partisë, nëse ai shkel vendimet e forumeve të saj. Masa ndëshkimore statuti ka edhe për rastet kur anëtarit i partisë kandidon si i pavarur ose për forcat e tjera politike, ose kontribuon në favor të tyre në fushatat zgjedhore pa autorizim të forumeve përkatëse të partisë. E njëjta masë që parashikon ndëshkim është edhe në rastet kur anëtarit i partisë deklarohet publikisht qën-



PERJASHTIMI
Masa më e ashpër ndëshkimore është ajo e cregjistrimit nga personin që thyen rregullat



DEPUTETET
Deri më tani rezultoni se kanë dalë hapur tre deputetë në mbështetje të të pavarurëve, Bufi, Islami dhe Dedja



NDËSHKIMI
Kryesia e PS-së duket se ka zgjedhur të marrë një vendim lidhur me këtë pas zgjedhjeve për pushtetin lokal



R A M A
Para pak ditësh, në kryesinë e PS-së lëshjën u shkarkuan pesë anëtarë dhe kreu i PS-së së Fatosit

drimin kundër kandidatit përfaqësues të partisë. Nëse konstatohen raste të tilla, statuti i partisë, si dokumenti bazë i organizimit dhe funksionimit, parashikon masa disiplinore që variojnë nga shumë të ashpër në të lehta.

Këtu futet paralajmërimi me vërejtje, më pas heqja e të drejtës së votimit në proceset zgjedhore në parti deri në një vit. Masat e forta ndëshkimore kanë të bëjnë me shkarkimin nga organet e zgjedhura partiake, heqjen e

mbështetjes politike për mandatin e marrë ose ekstremja, cregjistrim nga partia. Vendimin parashikohet ta marrë organizata socialiste përkatëse, kryesia e partisë së rrethit ose kryesia e PSSH-së. Shkarkimin nga detyra

kandidojnë të pavarur Reshat Fraholli në Komunën Çerravë dhe në Urën Vajgurore Agim Bregu.

TELEVIZIONI



Që sot, risia me emrin "TopNews"

Që sot, në paketën televizive "DigitAlb" nis transmetimet kanali më i ri informativ, "TopNews". Ky kanal do të ketë në bazë të programacionit lajmin e parë dhe atë të përpunuar në informative, duke qenë dhe lajmet më të ndjekura në Shqipëri, ato të "Top Channel", "TopNews" do të ketë një specifikë akoma më informative, duke qenë dhe lajmet më të ndjekura në Shqipëri, ato të "Top Channel". Ky televizion i ri nuk ka gjatë të mos ndjekë shembullin e medias të tjera të kompanisë "Topmedia", të cilat janë në krye të tërheqjes së audiencës më të madhe në Shqipëri. Shumë shpejt është ideuar dhe projektuar që "TopNews" të kapë majat e shikueshmërisë, duke u zhvilluar në disa aspekte: në shpejtësinë e lajmit, në profesionalizmin e përcjelljes së tij në audiencë, si dhe në nivelin e lartë teknik të komponentëve audiovizivë. "TopNews" nuk do të ketë vakumin informativ të kushtëzuar nga oraret. 24 orë do të jetë jo thjesht në transmetim non stop, por dhe në lançimin e lajmit non stop në çdo orë të ditës dhe natës. Audiencia shqiptare me "TopNews" ka rastin dhe njehërinë të provojë klasin e lartë të profesionalizmit gazetarësh dhe jo vetëm të "Top media", e vërtetuar tashmë në vite dhe me media të tjera të kësaj kompanie, ku më e fundit ishte gazeta "Shqip".

rreziku

"Çdo vonesë apo neglizhencë në situatën ku ndodhemi do të ketë pasojë në zhvillimin normal të zgjedhjeve"

GNV

"Situatë e vështirë mbetet procesi i ngritjes së grupeve të numërimit të votave, kur do duhen shumë të tilla"

partitë

"Subjektet politike nuk janë ndërgjegjësuar ende për rolin e tyre në këtë proces dhe plotësimin e standardeve"

KZQV

"Kreu i KQZ-së deklaroi se ka një 'epidemi' ditët e fundit për zëvendësimin pa kriter të anëtarëve të KZQV-ve"

KQV

"Jo më vonë se dhjetë ditë nga mbajtja e zgjedhjeve, një pjesë e subjekteve politike nuk kanë sjellë emrat"

Vetëm një javë na ndan nga data 18 shkurt, data e mbajtjes së Zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore

"Trajnimi i këtyre komisionerëve përbën një prej standardeve të kërkuara, por shkon kot"



Gjata: Zgjedhjet përsëri në rrezik dështimi

Kreu i KQZ-së hedh alarmin. "Shumë probleme, partitë po pengojnë procesin"

DARDAN MALAJ

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve hedh alarmin për rrezikun e dështimit të zgjedhjeve. Shkak për këtë është mosngritja e Komisioneve të Qendrave të Votimit, ndonëse afat ligjor ka kaluar. Kryetari i Institucionit të menaxhimit të zgjedhjeve, Çlirim Gjata, u kërkoi partive politike që të marrin me seriozitet situatën. Kjo duke bashkëpunuar me KQZ-në për të mundësuar funksionimin normal të komisioneve zgjedhore.

Alarmi

Kryetari i KQZ-së u bëri thirrje kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore dhe partive të mos bëjnë më asnjë lëvizje të qendrave të votimit, ku zgjedhësit do të votojnë më 18 shkurt. Sipas tij, kryetarët e njësive vendore sjellin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve informacione të ndryshme, që lidhen me ndarje të qendrave të votimit apo bashkime të tyre. Këto lëvizje, vlerësoi Gjata, krijojnë probleme në përgatitjen e terrenit për procesin e ardhshëm. "U bëj thirrje kryetarëve të njësive vendore që të mos ndryshojnë qendrat e votimit në raport me materialin e sjellë në fillim, se do të mbesin qendra votimi kot, 'fantazmë', ose do të ketë qendra votimi për të cilat nuk do të ketë bazë materiale, pasi kjo e fundit është llogaritur mbi bazën e informacionit të parë", nënvizoi Gjata. Ai konstatoise kjo është e lidhur dhe me fletët e votimit, të cilat përlogariten sipas numrit të zgjedhësve të sjellë nga kryetari i njësive, i cili është kompetent për këtë çështje. Gjata nënvizoi se çdo vonesë apo neglizhencë në situatën në të cilën ndodhemi do të ketë pasojë në zhvillimin normal të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Problemet
Gjata nuk ka lënë pa komentuar as problemet e ditëve të fundit në komisionet zgjedhore dhe konkretisht në qytetin e Tiranës. Sipas tij, komisionerët duhet të ruajnë qetësinë, ndërkohë që për problemet e shfaqura KQZ-ja ka marrë masat përkatëse. "Çështja është që anëtarët e KZQV-ve të zbatojnë vendimet e KQZ-së, të Kolegjit Zgjedhor dhe të ligjit", kërkoi Gjata. Ai këmbënguli se nuk zgjidhen problemet me sherre, ata duhet ta ndajnë veten nëpunës të procesit zgjedhor, nëpunës të shtetit dhe jo si të urdhëruar nga partitë përkatëse. Në vlerësimin e kësaj të KQZ-së akoma më rëndë është situata në lidhje me ngritjen e Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV).



"Edhe pse ligji e përcakton qartë se këto komisione duhet të ngrihen jo më vonë se dhjetë ditë nga mbajtja e zgjedhjeve, një pjesë e subjekteve politike që kanë të drejtën për të pasur komisionerë

ende nuk kanë paraqitur propozimet e tyre", tha ai. Për Gjatën, kjo krijon vështirësi në procesin e trajnimit, i cili ka filluar nga data 10 shkurt dhe do të vazhdojë deri më 16 shkurt. Po kaq e vonuar

paraqitet situata dhe në lidhje me Grupet e Numërimit të Votave (GNV), kur dihet shumë mirë se në bashkitë e mëdha të vendit do të duhet të ngrihen shume grupe të tilla.

reagimi

Dade: Policia po përfshihet në fushatën zgjedhore

Partia Socialiste dënon përfshirjen e strukturave të policisë së shtetit në fushatën elektorale të Partisë Demokratike. Sekretarja për Marrëdhëniet Ndërkombëtare në selinë rozë, Arta Dade, theksoi se incidentet e fundit tregojnë që në strukturat e policisë ka elementë që nuk nisen në zbatim të ligjit. "Këto struktura del qartë se nuk nisen as me qëllimin që në mënyrë të veçantë të respektojnë Kodin Zgjedhor, por vijojnë të zbatojnë urdhrat e ministrit të padorëhequr, zotit Oll-dashi", nënvizoi Dade. Ajo gjeti rastin të përsërisë thirrjen që kryetari i opozitës dhe njëkohësisht kryetari i Partisë Socialiste i ka bërë Kryeministrit shqiptar. "Thirrje për të vënë para përgjegjësi ligjore të gjithë personat e inkriminuar", tha Dade. Duke pranuar se krejt ndryshe nga çfarë duhet të ndodhë, në realitet vazhdon të justifikohet dhuna në fushatën elektorale për pushtetin vendor.

Sekretarja për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Dade, falënderoi gjatë komunikimit të djeshëm me median faktorin ndërkombëtar të akredituar në Tiranë. "Ata po ndjekin fushatën zgjedhore dhe kanë raportuar incidentet e ndodhura gjatë përgatitjes për zgjedhjet vendore", u shpreh Dade. Ajo shprehu falënderime edhe për mbështetësit e Partisë Socialiste dhe të majtës së bashkuar. Ata, shtoi Dade, duhet të qëndrojnë larg, pasi janë shprehje e etikës për humbjen e madhe që PD-ja do të pësonte në zgjedhje. D.Malaj



NJOFTIM

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të kërkesave të Kodit Zgjedhor, duke filluar nga data 11 Shkurt deri më datë 16 Shkurt 2007, do të zhvillojë programin e trajnimit me të gjithë anëtarët e Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV).

Ju sjellim në vëmendje partive politike të cilët kanë propozuar anëtarët e tyre në Komisionin e Qendrës së Votimit, KZQV-ve përkatëse, të njoftoni anëtarët dhe sekretarët e KQV-ve të emëruar në këto komisione, për pjesëmarrje të plotë në programin e trajnimit e përcaktuar edhe si detyrim ligjor, në nenin 29, pika 6 dhe neni 45/3, pika 1, gërma "dh", e Kodit Zgjedhor.

Lutemi Prefektëve të Qarqeve që nëpërmjet strukturave përkatëse të vënë në dispozicion ambientet e caktuara për zhvillimin e programit të trajnimit me anëtarët e KQV-ve. sipas skemës së këtij programi.

Skemën e programimit të trajnimit për çdo KQV, sipas ditës, orës dhe vendit të zhvillimit të programit të trajnimit e disponojnë partitë politike, prefektët e qarqeve, si dhe çdo KZQV e njësive zgjedhore përkatëse.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
www.cec.org.al



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDRORE I ZGJEDHJEVE

Adresa:
Palati i Kongresit,
Bujar Borovina e Korçës,
Tirane
Tel./fax:
+355 (0) 22 53 52
website: www.cec.org.al
e-mail: info@cec.org.al



polemikat

Rregulli: Studentët votojnë në qytetet e lindjes

Studentët do të votojnë në qytetet e tyre të lindjes. Një nga debatet më të diskutuara të zgjedhjeve gjithmonë ka qenë edhe organizimi për zgjedhjet në radhët e studentëve, të cilët për shkak të studimeve nuk jetojnë në qytetet ku kanë lindur. Drejtori i Qytetit të Studentit në Tiranë, Bujar Borovina, tha: "Studentët gjatë pesë viteve kanë votuar në qytetet e tyre të lindjes". Edhe Komiteti i Helsinkit kishte kërkuar që në datën 18 shkurt universitetet të mos parashikonin asnjë provën, në mënyrë që të rinjtë të shkonin në shtëpi të qetë për të votuar në zonat e tyre zgjedhore. Sipas ligjit përkatës, studentët duhet të votojnë në qytetet ku janë të regjistruar. Megjithatë, kjo nuk mbetet zgjidhja e vetme. Në vitin 2005, studentët e Qytetit Studenti në Tiranë u regjistruan pranë Njësive bashkiake 2, minibashki kjo e cila u konsiderua si përfshirje e zonës së Qytetit Studentit. Edhe pse atëherë debati mes kandidatit për deputet të zonës, Ylli Pango dhe kryetarit të minibashkisë Përpam Bodinaku u bë mjaft i ashpër, përsëri një pjesë e studentëve votuan pranë kësaj njësie. E njëjta zgjidhje do të jetë e vlefshme edhe këtë vit, mjafton që studentët në rast se do të identifikohen me certifikatë, të jenë pajisur me të pas 1 nëntorit të vitit 2006. Në rast të kundërt, ata duhet të jenë pajisur me dokumente shtesë. Komiteti i Helsinkit, duke pasur parasysh ligjin për të drejtën e votimit, u kërkoi institucioneve arsimore që të mos planifikonin provime ditë ditë para dhe dy ditë pas zgjedhjeve, në mënyrë që të gjithë studentët që i kanë shtëpitë larg qyteteve ku banojnë të ushtrtojnë të drejtën e votës.

L.Mi ha

Kthehet në tragjedi tubimi i "Vetëvendosjes". Të lënduarit nga policia nuk arritën të jetojnë

Protesta në Prishtinë, vdesin tre persona

Irritohen qytetarët, ndërsa Ekipi i Unitetit fajëson Albin Kurtin

NGA PRISHTINA, ALMA LAMA

Ndërhyrja brutale e policisë së UNMIK-ut ndaj protestës së "Vetëvendosjes" ka shkakuar edhe viktimat e para. Të paktën dy persona nuk arritën t'u mbijetojnë plagëve të rënda të plumbave plastikë. Arben Xheladini, i ditëlindjes 1972, nga Tërnoci i Bujanovcit, i cili jetonte në Prishtinë dhe Man Balaj, i lindur në vitin 1976 në Besianë (Podujevë) janë personat që tashmë nuk jetojnë më. Ndërkohë, flitet edhe për një person të tretë se ka humbur jetën. Të paktën 5 prej të plagosurve kanë qenë në gjendje shumë të rënda dhe në rrezik serioz për jetën, thanë autoritetet spitalore. Trupat e viktimave tashmë janë dërguar në morgun e spitalit të Prishtinës dhe priten ekzaminime mjeko-ligjore. Edhe pse helikopterët e KFOR-it i morën të plagosurit

dhe i çuan në bazën e KFOR-it gjerman në Prizren, ata nuk kanë mundur të shpëtojnë.

Dorëheqje për komisarin e UNMIK-ut
Policia ka konfirmuar vdekjen e dy personave nëpërmjet një komunikate për shtyp, ndërsa emrat e tyre nuk i ka bërë të ditur. Komisar i policisë së UNMIK-ut, Stephan Kurtis, nëpërmjet një komunikate për shtyp, tha se "demonstruesit pranë ndërtesës së qeverisë i shtrënguan policët të ndërmerrnin metodë mbrojtëse për të vendosur rendin. Çdo vdekje është dëshpëruese dhe na pikëllon edhe ne". Por në orën 18:00 disa organizata civile ndezën qirin para ndërtesës kryesore të policisë, ku dhe kërkuan dorëheqjen e komisarit të policisë. Sipas Glauk Konjufcës, aktivist i lëvizjes "Vetëvendosjes", protestuesit nuk kanë pasur asnjë qëllim që të hynin në



ndërtesat qeveritare, por vetëm të protestonin përqark tyre, ashtu siç kanë bërë më 28 nëntor. SHPK-ja pati deklaruar pikërisht të kundërtën, duke e justifikuar kështu dhunën e ushtruar.

Qytetarët, të irrituar

Ngjarja ka irrituar në mënyrë të jashtëzakonshme qytetarët e Prishtinës. Askush nuk arrin të kuptojë se pse policia e UNMIK-ut reagoi në mënyrë kaq të dhunshme ndaj protestuesve të paarmatosur. Policët rumunë, polakë dhe ukrainas kanë zbrazur mbi turmën qindra fishekë plastikë dhe disa tonë gaz lotshëlës pa asnjë pikë mëshire. "Nëse dikush vdes nuk do ta kenë të lehtë", tha një 50-vjeçar në mëngjes, ku lajm për të vdekurit ende nuk ishte konfirmuar. Të tjerëve u ka sjellë në mendje kohën e Millosheviçit. "As sërëb nuk janë sjellë kështu", thotë Daut Thaçi, një qytetar nga Prishtina. Rreziku i kalimit të

dhunës në ditët e ardhshme po ndihet dhe kjo është frika më e madhe për procesin e negociatave.

Ekipi Negociator
fajëson Albin Kurtin

"Ekipi i Unitetit u mbledh urgjentisht për të analizuar gjendjen e krijuar me protestat e dhunshme të nxitura nga Albin Kurti dhe lëvizja 'Vetëvendosje', me ç'rast humbën jetën dy persona dhe u plagosën dhjetëra të tjerë, duke krijuar tensione të veçanta, të cilat shkojnë kundër stabilitetit dhe interesave të përgjithshme të Kosovës". Kjo është deklarata e pesëshes kosovare, asnjëri prej të cilëve nuk pati kurajon të dalë para kamerave për të dhënë deklaratat. Gazetarët u nxorën jashtë portës së presidencës. Ndërsa nëpërmjet një komunikate tha se "është distancuar fuqishëm nga nxitësit dhe urdhëruesit e dhunës që çuan deri në vdekje të qytetarëve".

Reportazh i "La Repubblica". Sërëbët përgatisin ikjen, shqiptarët frikësohen nga fundi i ndihmave ndërkombëtare

Kosova, drama e dy popujve

në buzë të një tragjedie të re

GIANNI PROLO VISETTI

Mensa e manastirit ortodoks të Deçanit në Kosovën Perëndimore, në kufirin mes Maqedonisë dhe Shqipërisë, është bosh. Prifti Sava dhe peshkopi Teodosio, pas takimit me ministrin e Jashtëm të Bashkimit Evropian, Javier Solana, nuk mund të flasin. Thonë që janë të padisponueshëm. Shkretëtira përreth kullave mesjetare të kishës dhe të kulturës serbe shtrihet për kilometra të tëra. Pothuajse 8 vjet që nga përfundimi i luftës, kërcënimet dhe atentatet shqiptare janë shuar ndjeshëm. 28 murgjtë serbë jetojnë të blinduar dhe nën rrethim. Për t'i mbrojtur është caktuar kontingjenti italian i forcave ndërkombëtare. Prift-ërinjtë, mjeshtërët e ikonave dhe të gdhendjeve, nuk mund të zbrerën as në fshatin e tyre të lindjes. Për furnizuar me ushqime duhet të kalojnë zonën e sigurisë dhe të dalin nga enklava. Duhet të bëjnë tre orë rrugë me makinë për të blerë bukën në Malin e Zi.

Mbzitëronë frika mes mijëra afreskeve të shenjtoreve dhe sovranëve të shpëtuar në kishën e themeluar nga mbreti Stefan. Vetëm murgu llallorin, piktor, pas një ore është autorizuar të na takojë. Ka frikë të përgjeshstrojë zyrtarët e Beogradit, që kanë nguritur zërin kundër planit të Ahtisariut dhe "pavarësisë së kushtëzuar" të Kosovës. "Premtimet dhe dokumentet - tregon - vlejné për politikanët. Por ajo që ka rëndësi është realiteti: askush nuk mund të garantojë sigurinë e Ballkanit, pas ndarjes së Kosovës nga Serbia". Vetmia e shqetësuar e Deçanit është pamja tjetër e Prishtinës, Beogradit, Vjenës, Luksemburgut dhe Nju-Jorkut. Liderët nacionalistë serbë dhe shqiptarë, ndërmjetësues të institucioneve ndërkombëtare "dhurojnë" përplasjen për pushtet duke i bërë apel vlerave universale. Në prag të tentativës së fundit për statusin e Kosovës, përpara vendimit të OKB-së, populli ka mbetur peng i hakmarrjes, ur-

PLANI
Më 2 shkurt, Marti Ahtisari prezantoi planin e OKB-së për Kosovën, i cili parashikon faktikisht pavarësinë e Kosovës. Mitrovica do të ndahet në dy komuna, një në mazorancë serbe dhe tjetra në mazorancë shqiptare



NEGOCIATAT
Pas kërkesës së Presidentit serb, Boris Tadić, OKB-ja ka pranuar të shtyjë tavolinën e negociatave për 21 shkurt. Sërëbët dhe shqiptarët do të takohen në Vjenë

rejtjes etnike, terrorit, intolerancës fetare, përgatitjes për luftë dhe eksodeve masive. Megjithatë është varferia dërrmuese, mjerimi, braktisja e qytetit dhe vendet e shkatërruara në vitin 1999 e 2004, të cilat shpjegojnë se përse pavarësia e Kosovës është sot realitet i pamundur, përveçse e domosdoshme. Rreth 80% e 2 milionë qytetarëve janë të papunë. Ata jetojnë me më pak se 2 euro në ditë.

Pothuajse 17 mijë ushtarë të misionit të OKB-së kontrollojnë rrugë sheshe, ura, vende të shenja, kudo ku janë vendosur 100 mijë sërëbët e fundit, të cilët u kanë shpëtuar spastrimeve të shqiptarëve. Në 8 vjet, për Prishtinën janë caktuar rreth 3 miliardë euro, ku 2 miliardë kanë qenë ndihma vetëm nga BE-ja. Brenda një viti, për Kosovën është shpenzuar më shumë sesa ndihmat për gjithë Afrikën. Por, pavarësisht kësaj, shërbimet kryesore lënë për të dëshiruar. Kudo sheh shkollë duke u shembur, rrugë të copëtuara, transport publik të rrënuar dhe spitale ku mungojnë ilaçet dhe nuk gjen më vend për t'u shtruar. Po ashtu, Kosova është një vend ku vdekshmëria foshnjore është rreth 3,5%, më e larta në Evropë. Investimet e premtuara nga të huajt nuk po shihen, ndërsa edhe ato pak ndërmarrje industriale që kanë mbetur po shkojnë drejt falimentimit dhe mbylljes. Tokat janë braktisur, ndërsa financimet për zhvillimin po "digjen" nga nevoja për të importuar gjërat emergjente. Sipas Bankës Botërore, misioni ndërko-

mbëtar "vlen" rreth 200 milionë euro në vit. Por, nëse do të hiqej Kosova do të rrënohej ekonomikisht brenda një javë. Është vërtet e vështirë të imagjinosh një vend me pak të pavarur se ky. "Më shumë se pavarësia - thotë Zivonj Rakoveci, drejtor i radios së pavarur KIM - duhet reflektuar për falimentimin e OKB-së dhe lidershipit serb e kosovar. Plan i Ahtisariut vendos baza konstitucionale, por objektivisht ilegale dhe sipas të drejtës ndërkombëtare është një zgjidhje leksikore e bazuar në mbrojtje imagjinare. Duhet të shpëtohet figura e elitës së korruptuar ballkanike dhe e tërheqjes së "lehtë" të Kombeve të Bashkuara nga vendi përpara se të rishpërthejë dhuna. Tragjedia vetëm është rishtyrë:

pavarësia, materialisht e papërbalueshme nga Prishtina dhe tërësisht e papranueshme nga Beogradit, paralajmëron një mbajtje të papërbalueshme të "status-quo"-së. Për këtë mjafton të flasësh me njerëzit në enklavat serbe të Graçanikut, Kraglavitës dhe Mitrovicës, apo në qytete të shqiptarizuara të Prizrenit, Peçit dhe Klinës, për të kuptuar dëmet e krijuara nga urretja e madhe etnike. Në rreth 800 mijë familje kosovare, 600 mijë prej tyre kanë në shtëpi pistoletë, pushkë apo automatikë. Një në tre persona qarkullojnë të armatosur. Çdo

ditë nëpër feramat e braktisura zbulohen rreth katër arsenalet me mina dhe ekspozitë. Postbloqet, në fakt kufitare me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, kalojnë lehtësisht nga trafikantët e drogës, qenieve njerëzore dhe armëve. Një shenjë e zjarrit final është gati të flakërojë. "Ekstremizmi shqiptar, atdhetarizmi serb, mafia dhe kriminaliteti i organizuar - thotë Nesa Ralović, përtëritësi i fundit malazez që ka mbetur në Caglavia - kanë mbetur një bashkë". Mite historike dhe radikalizma religjioze janë ko-

reografia e interesave private të një klase politike që ka zëvendësuar blofin e ideologjisë komuniste me retorikën e pavarur. Cilën Kosovë, së bashku me Serbinë është duke pritur Evropa në Bashkimin e Brukselit? Një komb pothuajse totalisht i islamizuar, i pari në BE, një fushëbeteje qetësisht e kufizuar nga kaskat blu, një kryqëzim trafiqesh të paligjshme apo në vend të vendosur për të ndërtuar një demokraci të kujdesshme nga tutela e minorancave. Pas të vjetës prokturatur nga OKB-ja dhe pak muaj nga zgjidhja në të cilën Pallati prej Xhami do të sanksionojë një pavarësi "de facto", askush nuk e di. Ashtu si askush nuk mund t'i përdihet pyetjes: çfarë do të ndodhë brenda verës, pas ven-

dosjes së divorcit mes Serbisë e Kosovës? "Plani Ahtisari - thotë presidenti i Asamblesë Parlamentare të Prishtinës, Kolë Berisha - ka mbështetjen tonë. Megjithatë është e qartë se asistencë civile ndërkombëtare, prezencë ushtarake, duhet të qëndrojnë në Ballkan akoma edhe për shumë kohë. Pa investime të huaja të fuqishme, pas pavarësisë, Kosova do të përfshihet në një 'falimentin financiar'. Përshtypja është se pas rënies së euforisë së ditëve të kaluara, Prishtina tani duhet t'i trembet arrijtes së momentit, kur i duhet të demonstrojë se është legjitime dhe se di të "ecë" vetë. Kryeministri Agim Çeku tregon se këtu "minorancat do të kenë kujdesin më të lartë në botë", por herë të parë paralajmëron se "koha duhet matur dhe hapat duhen bërë në momentin e duhur". Kështu, ekstremistët shqiptarë të lëvizjes "Vetëvendosje" të Albin Kurtit pushtuan këto ditë rrugën "Klinton" në Prishtinë për të kërkuar referendum dhe pavarësi të menjeshme. Ndërsa sërëbët, të privuar nga një vend mu mund të shkojnë, janë "përfshirë" nga varferia dhe mizeria në barakat e tyre në Osjojanë dhe Strepce, ku kanë vendosur mobiliet në furgon në pritje të arratisjes. "Nëse OKB-ja do të na 'dorëzojë' të shqiptarët - thotë Gorna Kovaceviç, një 32-vjeçar tregtar në Graçanikë - nuk kemi rrugë tjetër veçse t'ia mbathim drejt Evropës. Shumë grupe të organizuara vetëm për 1 mijë euro ofrojnë udhëtime klandestine dhe dokumente false". Pas-

qyra është në etninë e Mitrovicës, atje Berlioni i Ballkanit ndahet nga ura mbi Ibas. Në pjesën jugore shqiptare, në ish-restorantet, sërëbët e fundit që kanë mbijetuar në këto ditë shikojnë shtëpitë e tyre në pronësinë e shqiptarëve të rinj, që derdhi mbi tavolina valixhet me euro. Turma thërrret dhe kërcënon me xhestikulacione. Qindra "punë" më pas mbyllen për një cast, të shtyra nga litrat e rakisë së bërë vetë. Pak metra më në jug, në pjesën serbe, ushtarët dhe vetererët e luftës po përgatisin "mbrojtjen". Në kafenenë "Dolce vita" ("Jeta e ëmbël") është firmosur "pavarësia e Republikës së Mitrovicës". Po organizohet "ruajtja kombëtare", me ngarkimin e dje-gjes së "çdo etnie shqiptare dhe personat e përfshirë". "Po atë ditë që do të shpallet pavarësia në Prishtinë - shpjegon Dejan Mihajloviç, kryetar i forcave militante - do të shpallet edhe tonën. Do të jetë fillimi i një lufte për pavarësinë e qyteteve serbe në të gjithë Kosovën".

Brenda dy javësh, pas fillimit të Parlamentit të të ri Beogradit, delegacionet politike të serbëve dhe kosovarëve do të ulen rreth tavolinës me negociatarët e Vjenës. OKB-ja, SHBA-ja dhe BE-ja premtojnë se "në Ballkan zhvillimi dhe stabiliteti janë në pëllëmbë të dorës". Por këtë realitet është ndryshe. Njerëzit nuk besojnë më në mrekullitë dhe në mundësitë për një jetë normale. Nuk kanë besim të politika dhe i tremben luftës për pushtet, që do të "tronditë" klanet lokale pas hapjes së rrugës nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Akuzojnë komunitetin ndërkombëtar të reagojë tashmë për një "tërheqje strategjike". Askush nuk e kupton më se kush ofron më shumë mes Moskës dhe Uashingtonit. Kështu kërkon përforcime për trupat e huaj dhe po përgatitet për një tjetër luftë, për një tjetër eksod shekullor, të padrejtë dhe varfëri postherëse.

Përgatitën: Arbnoza Bardhi
Arlinda Balla

PRIFTI SERB
Pas ndarjes, askush nuk mund ta garantojë më sigurinë në Ballkan

KRYETARI I
PARLAMENTIT
Pa investime në rreziqim jo falimentin financiar për pak javë



ARDI HOTI

Antimitingjet janë rishfaqur sërish gjatë fushatës aktuale për zgjedhjet e pushtetit vendor, pas një mungese të gjatë në jetën politike shqiptare. Në Postribë të Shkodrës, militantët të Partisë Demokratike kanë tentuar të bllokojnë një takim elektorale të parashikuar nga PS-ja lokale, në të cilin merret pjesë edhe sekretari i Përgjithshëm i kësaj partie, Pandeli Majko. Situata është normalizuar vetëm nga ndërhyrja e policisë, e cila ka bërë të mundur evitimin e një përplasjeje të dhunshme midis përkatësve të të dy partive.

Është shënuar dje incidenti i parë i

fushatës elektorale në qytetin verior të Shkodrës, ku dhe kësaj radhe, ashtu si në zgjedhjet e kaluara, protagonistët kanë qenë disa banorë të Komunës së Postribës. Incidenti ka ndodhur në hyrje të fshatit Mes, ku militantët të PD-së kanë dalë në rrugë duke bllokuar rrugën nga ku do kalonte vargu i makinave të PS-së. Makinat e socialistëve, mes të cilave edhe ajo e zotit Majko dhe të deleguarit tjetër të kryesisë, Viktor Doda, ishin nën drejt fshatit Dragoc, ku do të prezantohej kandidati i koalicionit të majtë për kryetar komune të Postribës, Ibrahim

Ceka. Përkatësit e PD-së, me flamuj të kësaj partie dhe thirrjet "Poshtë socialistët", "Rroftë demokracia" etj., kanë arritur ta ndalin vargun e makinave të PS-së dhe nuk kanë pranuar t'i lejojnë ata të vazhdojnë rrugën më tej. Kjo gjendje ka vazhduar për pak kohë, ndërsa politikanët e majtë duket se nuk kanë reaguar, për të mos acaruar situatën. Është dashur ndërhyrja e policisë për të shpërndarë militantët blu dhe për të liruar rrugën.

Menjëherë pas kësaj, karvani i makinave që shoqëronin kandidatin e PS-

së ka vazhduar normalisht rrugën për në fshatin Dragoc. Ndërkohë që edhe për shkak të kësaj ngjarjeje, masa të shumta sigurie e kanë shoqëruar aktivitetin në Postribë, ku janë dërguar në terren dhe forca të ndërhyrjes së shpejtë. Gjithsesi aktiviteti ka vijuar krejt normalisht dhe drejtuesit socialistë të shoqëruar nga forca të shumta policie janë kthyer pa probleme në Shkodër.

Zona elektorale e Postribës njihet si bastion i Partisë Demokratike, ku për 16 vjet rresht ajo është drejtuar në nivel lokal nga përfaqësuesit e kësaj force politike. Edhe gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005, forcat e majta janë penguar të zhvillojnë normalisht aktivitetin e tyre elektorale.

Shkodër, makinat e Majkos dhe Dodës janë bllokuar rrugës teksa po udhëtonin për në Dragoc

Postribë, rishfaqen antimitingjet e PD-së

Kryeministri premton në Mallakastër ndërtimin e një seri TEC-esh në të gjithë vendin

Berisha: Shqipëria gjenerator energjie

Pollo i entuziazmuar për fitoren e kandidatit të PDR-së në Ballsh

M ATILDA TROKA

Do të ndërtojmë një seri TEC-esh në mbarë vendin. Shqipëria do të kthehet në një gjenerator të vërtetë energjie, jo vetëm për vetë atë, por edhe për rajonin". Ky është premtimi i bërë nga Kryeministri Berisha në qendër të Mallakastër, në Ballsh, ku ai ka qenë në mbështetje të kandidatit për kryetar bashkie Neim Begaj. Por në takimin elektorale të Ballshit kreu i qeverisë ka këmbëngulur edhe të çështja e armistit, duke e parë atë si prioritetin kryesor të zonës. "Do të ndërtojmë në Ballsh një konvikt modern, ku të rinjtë nga të katër anët e Mallakastër të kenë mundësi akomodimi për të vazhduar studimet në shkollat e mesme. Do të ndërtojmë gjithashtu shkollë të mesme tjetër, e cila është shumë e nevojshme, pasi e vetmja që ekziston në këtë qytet nuk përbush kërkesat e larta", ka thënë Berisha në Ballsh.

I shoqëruar nga ministrat Luftër Xhuveli dhe Genc Pollo, Berisha deklaroi fitues në zgjedhjet e 18 shkurtit kandidatin e PDR-së Neim Begaj, i cili mbështet nga "Koalicioni i Madh". Ai u premtoi mallakastritëve se do të realizonte të gjitha projektet që do të sillte pas 18 shkurtit kryetari i ri i bashkisë, Neim Begaj. "Qyteti i Ballshit dhe rrethinat pranë tij do të marrin një panje tjetër në qeverisjen tonë", tha Berisha duke theksuar: "1,4 miliardë euro më shumë se në pesë vitet e fundit do të shkojnë për infrastrukturën rrugore të vendit, ku dhe Mallakastra do të ketë pjesën e saj".

Kryetari i Partisë Demokratike të Re, Genc Pollo, u shpreh i entuziazmuar nga pjesëmarrja në takim. Ai nuk ka mundur ta përmbajë entuziazmin duke deklaruar: "Është hera e parë që nga viti 1992, që unë shoh kaq pjesëmarrje të gjerë në qytetin e Ballshit". Më tej, ministri i arsim-it nuk ka nguruar të sulmojë ashpër qeverisjen socialiste, e cila sipas tij nuk ka qenë e angazhuar për investime publike, madje akuzoi kreun e këshillit të qarkut, Ilir Dano, si bllokues të investimeve në fushën e arsimt.

Në takim e ka marrë fjalën edhe aleati tjetër i Berishës, ministri i Mjedisit, Lefter Xhuveli, i cili kërkoi mbështetjen e mallakastritëve për kandidatin e koalicionit të djathtë. Xhuveli dha garanci të plota: "Ky koalicion siguron fitoren në 18 shkurt". "Votoni kan-

didatin Neim Begaj, tha ai, pasi Ballshi nuk meriton në të ardhme të ketë një infrastrukturë të tillë, ai meriton më shumë në të gjitha fushat dhe këto realizohen me fitoren e kandidatit tonë të përbashkët".

Kandidati për kryetar bashkie, njekohësisht kryetar i PDR-së, Neim Begaj, aktualisht është drejtor i Drejtorisë Arsimore në Mallakastër. Edhe ky takim elektorale, ashtu si në qytetin e Patosit, një ditë më parë ishte konceptuar me pjesëmarrjen e këngëtarëve si: Silva Gulbardha, Rozana Radi etj., të cilat kënaqen pjesëmarrësit në pritje të krerëve të koalicionit të djathtë.



deklarata

Berisha premton ta bëjë Sarandën prefekturë

Kthimi i Sarandës në një prefekturë më vete ka qenë premtimi më i bujshëm që Kryeministri Berisha ka dhënë nga tribuna e mitingut elektorale të organizuar mesditën e djeshme në sheshin kryesor të këtij qyteti. "Saranda do të shndërrohet de facto në një prefekturë të re të vendit, në të cilën do të jenë të gjithë sektorët e administratës së saj, ku do të qeverisin qytetarët e saj, në mënyrë që ta çojnë përpara këtë qytet të mrekullueshëm", u ka thënë Berisha sarandjotëve. Kandidatin e të djathtës së bashkuar, kryebashkiakun ak-

tual Edmond Gjoka, që rikandidon për një mandat të dytë, Berisha e ka paraqitur si simbol të qeveritarrë vendor të suksesshëm, të vlerësuar për t'ij të përkushtuar, të ndershëm dhe vizionar. Në argumentim të kësaj, ka vlerësuar se Gjoka në 3 vitet e mandatit të parë ka garantuar investime dhe punë publike në Sarandë më shumë se nga viti 1992 deri në 2003, ndërkohë që sipas tij vitin që shkoj Saranda pati një turizëm rreth 30 për qind më shumë se më parë.

Th.Nika

TURI

JULI DHIMITRI

Fatos Nano ka dalë në mbështetje të kandidatit socialist për Bashkinë e Korçës, Niko Peleshi. Nano ka kujtuar se është vota arma më e mirë për të mposhtur të keqen dhe për të ndryshuar një regjim, duke deklaruar se që nga '97-ta PS ka arritur të përdorë votën në vend të kallashit për të rëzuar një regjim të mbrapshtë. I shoqëruar nga Ben Blushi, Taulant Balla dhe Frok Cupi, Nano ka thënë për socialistët e Korçës se ky qytet do të shkojë drejt rrugës evropiane vetëm në sajë të programit social-demokratik dhe vizionit të kandidatit socialist.

"Jemi sërish në udhën evropiane për të çrënjosur, për të dezinfektuar dhe për të shëruar shoqërinë, mjedisin, vetveten, politikën dhe administratën nga kon-taktet me botën e së kaluarës. E keqja mposhtet më mirë me votë

"Në Evropë të shkojmë me një armëpushim, siç ka ndodhur në epoka të mëdha"

Nano në Korçë mbështet kandidatin socialist



të lirë. S'ka armë më të mirë për të mposhtur të keqen se sa vota e lirë, pasi ajo është armë paqësore". Ish-lideri socialist i është rikthyer në analizë kohës kur qeveriste vendin: "Në regjimin e Nanos ne bënim humor dhe e

quanim FMN: Fatos-Malaj-Nano, për shkak të partneritetit, kontraktet që po nuk e zbatove, e ka një kosto. Porti tan regjimi i Nanos denoncon regjimin e Bodes. Ministria e Financave sot nuk mund të sillt me buxhetin me politika

klienteliste. Nuk mund të vazhdojë pa fund të ketë frymëmarrje të gjatë abuzimi të qeverisë së financave". Nano gjatë fjalës së tij ka hedhur idenë e frymës evropiane të lirisë politike, kur ka thënë se "ka ardhur koha që në Evropë të shkojmë me një armëpushim, ashtu siç ka ndodhur në shumë epoka dhe në kohëra të mëdha". Ai ka dalë përka kandidatit socialist për Bashkinë e Korçës, Niko Peleshi, duke e quajtur një zbulim të PS-së para tre vjetësh kur ai u vu në pozicionin e prefektit. Sipas Nanos, do të jetë vizioni dhe programi i tij që do të ndryshojë Korçën nga tri vitet e primitivitetit.

PREMTIMET



BERISHA

U premtoi mallakastritëve se do të realizonte të gjitha projektet që do të sillte pas 18 shkurtit kryetari i ri i bashkisë



POLLO

Ka sulmuar ashpër qeverisjen socialiste, e cila sipas tij nuk ka qenë e angazhuar për investime publike, veçanërisht në arësim



XHUVELI

Ka siguruar se "Ballshi nuk meriton në të ardhmen të ketë një infrastrukturë të tillë, ai meriton më shumë në të gjitha fushat"

BERAT




Meta: E majta, alternativa më e mirë

Kryetari i Lëvizjes Socialiste për Integritim, Ilir Meta, gjatë një ture që ka zhvilluar në Qarkun e Beratit, ka deklaruar se kandidatët dhe alternativat që ofron opozita e majtë janë më të mirat për zhvillimin e vendit. Pjesë e takimeve të liderit të LSI-së kanë qenë Polican, Mbrakulla, Skrevani, Pashallia, Vokopola dhe lagjia "Guri i Bardhë" në Urën Vajgurore. Në këtë takim, zoti Meta, pasi ka shprehur besimin për fitoren e kandidatëve të koalicionit të majtë "Bashkë për të Ardhmen", ka theksuar se gjatë kësaj jave të gjithë duhet të trokasnin shtëpi më shpejt dhe në çdo zemër për të bindur qytetarët që të votojnë alternativën e koalicionit të majtë, si alternativa më e mirë dhe me njëzëritë më të mirë, më të ndershëm dhe më të aftë profesionalisht. Meta ka theksuar se është shumë e nevojshme t'u tregohet njerëzve se kandidatët e pavarur, të dalë nga e majta, nuk bëjnë gjë tjetër veçse çojnë ujë në mullirin e Berishës. FI .Se.

KSAMIL

Refuzohen tre këshilltarë të PAA

Qazim Qendro, Kristaq Bushi dhe Fredi Gjika janë tri emra që nuk kanë mundur të përshihen në listën e kandidaturave që konkurrojnë për këshilltarë në Komunitet e Ksamilit. Ata thonë se kandidojnë për subjektin politik të PAA, por cuditërisht u është refuzuar regjistrimi. Sipas tyre, në KZZV-në e Ksamilit kryetari Pelumb Fata u ka thënë se pengesa nuk ka ardhur për t'ij, por prej strukturave zgjedhore të ngritura në prefekturën e Vlorës. Qazim Qendro tha për "Shqip" se është mohuar e drejta kushtetuese për t'u zgjedhur, edhe pse kanë paraqitur në kohë dokumentacionin. Qendro thotë se për refuzimin që u është bërë nga komisionet zgjedhore të dy niveleve, kandidatët janë ankuar në zyrat e OSBE në Gjirokastrë. Ata pohojnë se sot u është rezervuar një seancë degjimi nga përfaqësuesit të kësaj zyre dhe se do të jenë këmbëngulës derisa emrat e tyre të zënë vend në fletëvotimet e 18 shkurtit. Th.Nika



■ Pas Colit, i cili ka rrëfyer vrasjet në Durrës, një tjetër anëtar ka pranuar bashkëpunimin me drejtësinë

■ Konfliktet mes bandave të Durrësit në vitin 1998 fillimisht kanë lindur për rivalitetin në trafikun e drogës

prokuroria

Hetimi për Berisha-Dokle, drejt fundit

Prokuroria e Krimeve të Rënda është në përfundim të hetimeve për organizatat kriminale të Durrësit. Për disa ditë me radhë hetuesit e këtij dikasteri kanë ripyetur të gjithë dëshmitarët për të riformuluar akuzat. Sipas hetimeve, pasi janë zbardhur skemat e funksionimit të organizatës që në fillimet e saj, ndajen në dy banda dhe rivalitetin mes tyre, është urdhëruar ndalimi i gjithë krerëve dhe anëtarëve. Një prej të akuzuarve, si pjesëtar i bandës së kryesuar së fundmi nga Indrit Dokle, që ka bërë të mundur zbardhjen e disa ngjarjeve ka pohuar se i shih



premtuar 100 mijë euro për të ekzekutuar Lulzim Berishën dhe, pasi e plagosi kishte marrë 25 mijë. "Organizata kriminale e Klodian Salit, tashmë e kryesuar nga shtetasi Indrit Dokle, është përgjegjëse për vrasjen e Avni Gashit në kryeqytet, ku kufoma u hodh në fshatin Romanat të Durrësit. Gjithashtu, prokuroria e akuzon këtë bandë si përgjegjëse për vrasjen e Ilir Koldashit, të pub 'Fashion' në kryeqytet", deklaronte Ministria e Brendshme, pas goditjes së organizatës. Ndërkaq, prokuroria e akuzon bandën në fjalë edhe për tri vrasje të mbetura në tentativë ndaj Lulzim Berishës, rivalit të tyre.



I penduari, një tjetër shok tradhton Lul Berishën

Prokuroria: Tregoi trafikun e drogës Shqipëri-Itali

SOKOL ÇOBË

Një nga anëtarët e organizatave kriminale të Durrësit ka përfutur bashkëpunim me drejtësinë, duke treguar trafikun e drogës nga Lulzim Berisha dhe Indrit Dokle. Pas Adriatik Colit, i cili ka rrëfyer vrasjet në Durrës, një tjetër anëtar (emri i të cilit nuk bëhet i ditur për arsye hetimi), ka pranuar bashkëpunim, duke përfutur lehtësirat nga ligji shqiptar. Lajmi bëhet i ditur nga burime pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Sipas tyre, të penduarit kanë rrëfyer se vrasjet në Durrës filluan nga konflikti për rivalitetin e trafikeve të heroines.

Dëshmitë

Dëshmitë e siguruar ndaj dy bandave që vepronin në qytetin e Durrësit janë provat e reja, që forcojnë dyshimet se konfliktet e tyre kanë lindur si pasojë e rivalitetit në trafikun e lëndëve narkotike. Kjo, pasi organizatat e kësaj lloji të cilëve akuzohen Lulzim Berisha dhe nga Indrit Dokle (më parë e kryesuar nga Klodian Salit, i cili është vrarë), nuk u janë sekuestruar sasi droge në Shqipëri dhe as jashtë shtetit. Burimet tregojnë se vetëm në një rast, para disa vitesh, janë sekuestruar disa kilogramë heroinë një korrieri të drogës, që dyshohet se ishte pjesë e bandës së kryesuar nga Lul Berisha. Ndonëse banda e këtij të fundit dyshohet se trafikonte heroinë nga Turqia drejt Italisë dhe vendeve të tjera të Evropës Perëndimore, që nga viti 1994 nuk është arritur që ndaj tij të provohet akuzat në fjalë. Lulzim Berisha është akuzuar për trafik drogë edhe nga drejtësia gjermane e ajo italiane dhe, pasi ka kaluar pak kohë në burg, ka dalë si i pafajshëm. Burimet nga Prokuroria e Përgjithshme pohojnë se dëshmitë e siguruar nga të penduarit që kanë dijeni mbi vrasjet e ndodhura mes bandave kanë siguruar prova të reja për këtë trafik drogë.

Konfliktet

Prokuroria e Përgjithshme thotë se konfliktet mes bandave në vitin 1998 fillimisht kanë lindur për rivalitetin në trafikun e drogës. Ka qenë koha që Lul Berisha ndodhej në burg në Itali, kur një prej të akuzuarve si bashkëpunëtori më i ngushtë, Klodian Salit, ka devijuar duke krijuar bandën e tij. Pas dal-

jes nga burgu dhe mbërritjes në Shqipëri dyshohet se Lul Berisha kishte humbur terren në trafikun e drogës në qytetin bregdetar. Madje, burimet shtojnë se akuzat e kriminit të grupit të strukturuar kriminal, dy të akuzuarve si krerë të bandave, u është ngritur mbi bazën e provave të siguruar për trafikun e drogës, që dyshohet se kanë kryer për vite me radhë këto banda. Në dëshmitë e tyre, të pen-

duarit kanë pohuar se gjithçka mes bandave ka filluar pas një rivaliteti të fortë në trafikun e heroines drejt Italisë. Burimet shtojnë se në dëshmitë e të penduarve thuhet se ka qenë pikërisht ky shkak që ka nisur një serial vrasjesh në qytetin e Durrësit, deri dy vite më parë, ku u tentua tri herë ekzekutimi i Lul Berishës, që u plagos në një prej atentateve. Ndërkaq, sipas prokurorisë, pasi të sigurohen prova të tjera,

Dëshmitë e siguruar nga të penduarit që kanë dijeni mbi vrasjet e ndodhura mes bandave kanë siguruar prova të reja për këtë trafik drogë



▲ **LULZIM BERISHA**

Akuzohet nga drejtësia për krimin të organizatës kriminale, vrasje dhe trafik drogë



▲ **INDRIT DOKLE**

Akuzohet nga drejtësia për krimin të organizatës kriminale, vrasje dhe trafik drogë



▲ **KLODIAN SALIU**

Dyshohet se është ekzekutuar nga organizata e Lul Berishës në autostradën Tiranë-Durrës

TIRANË

Policia arreston tregtarin Alban Pojani: Hodhi në erë një dyqan me pajisje elektronike

Biznesmeni, eksploziv konkurrentit

Eksploziv biznesmenit për konkurrencë. Ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Tiranë, ndërkohë që uniformat blu kanë arrestuar autorin. Grupi hetimor deklaroi se Alban Pojani dyshohet se e ka kryer këtë atentat për motive të konkurrencës. Burimet zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Tiranës bëjnë të ditur se me t'u njoftuar kanë marrë të gjithë masat e duhura policore në drejtim të zbulimit dhe dokumentimit ligjor të kësaj ngjarjeje kriminale për dëmtim të pronës me lëndë plasëse. Sipas uniformave blu të kryeqytetit, pikërisht dje, rreth orës 03:00 të mëngjesit, është dëmtuar me lëndë plasëse dyqani me pajisje elektronike "Amerikan Shop", i cili ndodhet në Rugën e Kavajës, pranë "21 Djetorit". Burimet policie bëjnë të ditur se me të marrë njoftimin në lidhje me shpërthimin, nga ana e forcave policore të Komisarariatit Nr.2 është ngritur grupi hetimor për dokumentimin ligjor të ngjarjes dhe iden-



bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga ai, policia ka mundur të identifikojë autorin e kësaj ngjarjeje. Burimet zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Tiranës bëjnë të ditur se pas hetimeve paraprake ka rezultuar se autor i kësaj ngjarjeje është Alban Pojani, 36 vjeç, banues në Tiranë. Në ngarkim të këtij personi, oficerët e policisë gjyqësore të Komisarariatit Nr.2 morën masën e arrestit në flagrancë, për kryerjen e veprës penale të "shkatërrimit të pronës me eksploziv". Burimet nga grupi hetimor shpjeguan për "Shqip" se nga kryerja e veprimeve dhe konkluzioneve të njërta rezultojnë se ngjarja ka ndodhur për shkak të konkurrencës në treg. Sipas policisë, nga ana e grupit hetimor vazhdon puna për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes, si dhe identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje kriminale. Në lidhje me këtë, policia tha se ka shoqëruar edhe vëllain e të arrestuarit.

Bledi Gilaj

EKSPOZIVI

Shpërthimi ndodhi rreth orës 03:00 në dyqanin e Avjetan Demollarit



MOTIVI
Policia deklaroi se atentati është kryer për konkurrencë në tregti



Bedri Kalaja, pas plagosjes

Bedri Kalaja është qëlluar nga dy persona me motoçikletë Tiranë, hekur kokës të një 50-vjeçari

Një 50-vjeçar është plagosur në kokë me një shufër hekur nga dy persona të pidentifikuar. Ngjarja ka ndodhur mesditën e djeshme në Tiranë. Bedri Kalaja, 50 vjeç, po udhëtonte në Afërsi të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), kur është goditur nga dy persona që po udhëtonin me një motoçikletë. Lajmi bëhet i ditur nga burime zyrtare pranë policisë së Tiranës. Sipas tyre, 50-vjeçari ka marrë frakturë të rënda, ndërsa është dërguar me urgjencë në spital. Mësohet se gjendja e tij është shumë e rëndë dhe i është nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale. Nderkohë, në vendngjarje ka mbërritur grupi

Gjendja e tij është shumë e rëndë dhe i është nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale

hetimor, i cili ka marrë në pyetje dëshmitarët. Ata kanë treguar se Kalaja po udhëtonte më këmbë para ATSH-së kur dy persona e kanë goditur në kokë. Të dyshuarit udhëtonin me një motoçikletë. Oficerët e policisë thanë se dëshmitarët kanë treguar që 50-vjeçari është

goditur me një shufër hekur, e cila ngjasonet me një çelës për makina. Autorët dyshohet se janë të moshës rreth 30-35 vjeç. Policia thotë se ka ngritur disa postblloqe për arrestimin e tyre. Deri në orët e pasdites së djeshme autorët nuk janë arrestuar. Nga ana tjetër, inspektorët e policisë kanë marrë në pyetje familjarët e të plagosurit, për të saktësuar konfliktet e mundshme të Kalasë me ndonjë person. Nga të dhënat e para mësohet se ende nuk ka asnjë person të dyshuar për këtë ngjarje, e cila ka shkakuar panik të kalimtarëve. Në kohën kur ka ndodhur plagosja, në afërsi të ATSH-së, kishte shumë kalimtare.

Dy gjykata lënë në burg katër personat e arrestuar me 17 kg lëndë narkotike në Tiranë dhe Han të Hotit

“Unë, korrieri i drogës për në Malin e Zi”

Ramadan Balaj tregon linjën e trafikut: Kokainë dhe mora në Shkodër; do e çoja në Tuz

SOKOL ÇOBO

Ramadan Balaj, i arrestuar në flagrancë katër ditë më parë tek kalonte nga Shqipëria në Mal të Zi, ka treguar linjën e trafikut para Gjykatës së Krimeve të Rënda. Ka pranuar se ka trafikuar kokainë, ndërsa ka deklaruar se ka qenë vetëm një korrier droge. Sipas tij, drogën e kishte marrë në qytetin e Shkodrës dhe do e transportonte për në Tuz të Malit të Zi. Dje në mesditë është zhvilluar masa e sigurisë ndaj Balajt në gjykatë. Pas kërkesës së prokurorisë dhe pretendimeve të mbrojtjes, gjykata vendosi masën "burg pa afat". Sipas vendimit, "47-vjeçari Balaj ka konsumuar veprën penale të 'trafik të lëndëve narkotike' në bashkëpunim", pasi rezultoi se më datë 8 shkurt ka marrë porositë prej 1.2 kg kokainë nga një shtetas i pidentifikuar në qendër të Shkodrës, për ta dërguar në qytetin e Tuzit në Mal të Zi. I arrestuari deklaroi para gjykatës se është arrestuar nga policia dhe nuk ka pasur asnjë detaj për të shtuar. Avokata kërkoj që ndaj klientit të saj të jetë menjëherë e sigurisë "arrest në shtëpi". Kërkesa nuk u pranua nga gjykata, e cila vendosi që 47-vjeçari të mbetet në burg deri në përfundim të hetimeve. Ramadan Balaj, 47-vjeç, me banim në Shkodër, u arrestua katër ditë më parë nga strukturat e Policisë së Shtetit në pikë kalimim kufitar të Hanit të Hotit, me 1.2 kg lëndë narkotike të llojit kokainë të fshehur në trup. Pas arrestimit ai nuk ka preferuar të japë emra të tjerë të bashkëpunësorëve. Sipas prokurorisë, Balaj mund të ketë qenë thjesht një "korrier" i drogës kundrejt një pagese.

Po dje, në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë, është zhvilluar masa e sigurisë për tri persona, të cilët janë arrestuar katër ditë më parë. Në përfundim gjykata vendosi "arrest me burg" për të dyshuarit, të cilët janë arrestuar në rrugën "Muhamet Gjollës" në kryeqytet, me rreth 9.8 kg lëndë narkotike të llojit heroinë dhe rreth 4.5 kg përzierës. Gjyqtarja Regleta Panajoti vendosi pranimin e kërkesës së akuzës që shtetasi Artan Aliaj, Devis Koleci dhe Myrteza Bejo të qëndrojnë në dhomat e paraburgimit deri në përfundim të hetimeve. Aliaj, Koleci dhe Bejo, nëpërmjet avokatit, kanë deklaruar se gjithçka ka qenë një trill i policisë dhe nuk kanë pasur asnjë lidhje me heroinën e kapur. Sipas prokurorisë, Artan Aliaj, Devis Koleci dhe Myrteza Bejo dyshohet se kanë konsumuar veprën penale të "prodhimit dhe shitjes të lëndëve



Durrës
Vetëvritet
babai i 3 fëmijëve

Babai i tre fëmijëve vret veten pak muaj pas ardhjes nga Italia. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në një nga lagjet në qendër të qytetit bregdetar. Konfliktet brenda familjes dhe rënia në depresion e kanë çuar drejt vendimit fatal 42-vjeçarin Besmir Hasanaj. Prej disa vitesh Hasanaj ishte emigrant në Itali dhe ishte kthyer pranë familjes katër muaj më parë. Kthimi nuk ka qenë shumë i këndshëm për të, për shkak të konflikteve familjare. Besmir Hasanaj është gjetur i vetëvarur në një kasolë pranë shtëpisë së tij. Lagjja 11 është një nga lagjet e vjetra të qytetit të Durrësit me shtëpi të ulëta. Në njërin prej tyre jetonte dhe Hasanaj, i martuar me tre fëmijë. Ai ishte me origjinë nga Dibra dhe banor i kësaj lagjeje. Pas marrjes së njëtimtë paraprak për një person të vdekur, grupi hetimor që shkoi në vendin e ngjarjes konstatoi se vdekja i ka ardhur si pasojë e varjes në litar. Nga hetimet e para ka rezultuar se viktima ishte zhytur në një depresion të thellë për shkak të konflikteve familjare. Të njohur të familjes thonë se 42-vjeçari muajt e fundit ishte mbyllur në vetvete, derisa ka ndërmarrë aktin final ndaj jetës. Për këtë vit kjo është vetvarja e dytë në Durrës.

V. Qyryfi

narkotike" në bashkëpunim. Katër ditë më parë, pas një survejimi disaditor, policia e kryeqytetit arrestoi Aliaj me 9 kg e 759 gramë lëndë narkotike heroinë të fshehur brenda një televizori me ekran të thyer në automjetin e tij tip "Audi A3", me targë BR9897A. Gjatë kontrollit të ushtruar në këtë automjet, u gjet dhe sekuestrua nga policia edhe një sasi prej 4 kg e 960 gramë pluhur i dyshuar përzierës i lëndës narkotike. Disa minuta më pas policia arrestoi edhe dy të dyshuarit e tjerë si bashkëpunësorë të shtetasit Artan Aliaj, konkretisht: Devis Koleci 27-vjeç nga Çorovoda dhe Myrteza Bejo, 49-vjeç, nga Tirana.

POGRADEÇ

Kishte shndërruar apartamentin në zdrukthëtar

Digjet 57-vjeçari, hyri të shpëtonte punishten

Flakët e zjarrit kanë përfshirë katin e katërt të një pallati

Një 57-vjeçar nga qyteti i Pogradecit është djegur dhe ka mbetur i demtuar rëndë teksa ka ndërhyrë për të shuar zjarrin që ka përfshirë banesën e tij. Rreth orës 12:00 flakët e zjarrit kanë përfshirë katin e katërt të një pallati. Naum Kumbulla, teksa ka parë rënien e zjarrit, ka hyrë menjëherë brenda në banesë dhe në përpjekje për shuar zjarrin ka mbetur i djegur, ndërsa sipas burimeve nga spitali, ai ka arritur me djegie të shkallës së tretë dhe gjendja e tij shëndetësore është kritike për jetën. Të njëjtat burime thanë se krahas djegieve të rënda në trup, viktima ka pasur edhe mungesë oksigjenimi.

Në vendngjarje kanë shkuar edhe forca të shumta policore dhe mjete zjarrfikëse, por nuk kanë mundur të shpëtojnë në kohë 57-vjeçarin e ndodhur në brendësi të banesës. Sipas policisë lokale, apartamenti që mori flakë shfrytëzohet nga Kumbulla si punishte dru. Kjo ka ngritur dyshimet se zjarrin mund të ketë qenë i qëllimshëm, pasi nga aktiviteti i ditor i kësaj punishteje bëhet zhurmë që shqetësonte edhe banorët e tjerë. Por nuk përjashtohet edhe mundësia që zjarrin të ketë ardhur si pasojë e ndonjë shkëndije elektrike që u ka dhënë flakë lëndëve drusore të cilat ndodheshin në brendësi të apartamentit. J. Dhimitri

PIER

Shkëndija elektrike shkruan mobilierinë

Një zjarr i fuqishëm ka rënë mungësin e së dielës në një fabrikë drurit ku prodhoheshin mobilie në qytetin e Fierit, pronë e këngëtarit Ilir Veliaj. Demet, sipas policisë lokale, janë të konsiderueshme, ndërkohë që flakët kanë rrezikuar seriozisht të gjithë fabrikën, si dhe godinat rreth saj në zonën industriale të qytetit. Rreth orës 07:45 të mëngjesit të së dielës është lajmëruar për një zjarr të rëndë në mobilierinë "MISSMOBIL". Sipas policisë së Fierit, shkak për rënien e zjarrit ka qenë një shkëndijë elektrike e ardhur prej sharrës. Kjo konfirmohet edhe nga një prej punonjësve të mobilierisë, i cili ka deklaruar për policinë se për sharrës së korrentit është dalluar shenja e parë e zjarrit. Ma.Tro.



ELKOS
TIRANA

OFERTE PUNESIMI

ELKOS-group Shqipëri me seli në Tiranë Distributor ekskluziv i shumë produkteve ushqimore është i interesuar për të punësuar:

Manaxher Shitje:

Durrës	2 manaxher shitje
Vlorë	1 Manaxher shitje
Shkodër	1 Manaxher shitje

Kandidatët për punë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:


- Përhën avantazh arsimsi i lartë
- Të ketë eksperiencë në shitje (eksperiencia në pozicion të ngjashëm përbën avantazh)
- Të jetë i aftë të menaxhojë njerëz
- Të dijë të kuptojë problemet, të japë zgjidhjet dhe të propozojë konkretisht ide për përmirësimin e biznesit
- Të dijë të përdorë kompjuterin në programet MS OFFICE
- Mosha 25 – 35 vjeç
- Leje për drejtim automjeti
- Aftësi të mira komunikimi, negocimi dhe menaxhimi

Kompania ofron kushte të mira pune, makinë në përdorim, pagë stimuluese si dhe mundësi karriere. Kandidati i përzgjedhur do të mbulojë rajonin në fjalë dhe do të ketë përgjegjësi për zhvillimin e biznesit në rajonin në fjalë.

Të interesuarit janë të lutur të dërgojnë një CV dhe nga një foto me detajet e mëposhtme të kontaktit:
E-mail: am@elkosgroup.com
Fax: ++35548300853
Tel : ++35548300854
Mob: 0692066627


Ose dorazi në adresën:
Elkos-group Tiranë
Autostrada Tiranë – Durrës në Bërxull
Pranë Emigrimit dhe Autosalonit Ford

Intervista Ditën e mërkurë ora 13:00 datë 14.02.2007 në lokalet tona



50% Ulje SMS

Dërgo një mesazh, dikush po pret.

 AMC për festën e Shën Valentinit ofron për të gjithë abonentët e saj me kontratë dhe ALBAKARTA, 50% ulje për çdo SMS të dërguar brenda rrjetit AMC. Nga e hëna 12/02/07 ora 00:00 deri të dielën 18/02/07 ora 23:59.



Është mirë
të jesh i pari

E VETMJA **REVISTË SHQIP** QË MUND
TA GJENI NË SHQIPËRI, KOSOVË,
MAQEDONI DHE NË GJITHË
EVROPËN

SHQIP

Aurela Gaçe
Nga Amerika me dashuri

Pas pesë vitesh të gjata largimi, rikthimi i Aurelës Gaçe në Shqipëri vërtet për amëzë dhe këmbejë shqiptarë. Në këtë numër "Shqip" momentet jetësore dhe artistike të këtyre viteve të saj në New York, si dhe mallin për vendlindjen dhe publikun artadashës shqiptar.

• DY GERMANËT E FORTË TË TIRANËS • KRUGËTINI I DYTË I NERKAT DACT • TEK MEHARËTE LAJE
• KOSTANTINI I MADH, HISTORIA NËNDRON FAÇE • TIRANA MES SHENJESH ENTRODASTË

Vetëm 200 lekë

www.shqip.al

ProCredit Bank

ProPartner
Kredi për ndërmarrjet e vogla

Kredi Deri në
3,000,000 Lekë
Ose 25,000 Euro

Hipoteka nuk është
kusht i domosdoshëm

Procedura deri në 5 ditë

www.procreditbank.com.al

WATSA



Lulja e Kafesë është e bardhë dhe shumë aromatike. Grupohet me 2 - 12 lule dhe kërcelli i saj është rreth 10 - 20 mm gjatësi me ngjyrë jeshile. Kurora e lules ka formën e një tubi të gjatë i cili mbaron duke u hapur në 5 petale rreth 6 - 12 mm të gjata. Ajo ka 5 thekë të futura në grykën e tubit të kurorës së lules, që alternohen me petalet e saj.

Periudha e lulëzimit është e shkurtër dhe shoqërohet nga një aromë e këndshme e cila të kujton aromën e lules së Jaseminit. Ajo lulëzon gjatë orëve të para të mëngjesit dhe qëndron e hapur gjatë gjithë kësaj dite. Ditën e dytë ajo fillon të thahet, ndërsa ditën e tretë kurora e lules shpëputet sëbashku me thekët dhe më pas, nga kjo del fruti, kokrra e kafesë.

BALLAFAQIMET TELEVIZIVE DHE MUNGESA E MODELEVE

MUSTAFA NANO

Të gjitha fushatat elektorale të zhvilluara në Shqipëri në postkomuniste janë dominuar nga kacakfytet e partive dhe të kandidatëve, të cilat kanë prodhuar pa fund akuzat, sharsh, fyerje, denigrime në adresë të sho-shoqit, e deri dhunë midis ushtrive të militantëve të të dy krahëve. E megjithatë, në gjithë këtë sherrmajë gjigante, që vijon për dreq edhe në periudhat midis fushatave, nuk kanë munguar edhe do shembuj të mirë. Ka pasur pra tek-tuk ndonjë kandidat, i cili ka bërë çmos të mos bëhet pjesë e kontekstit rrugësor elektorale. Por këta shembuj kanë qenë sporadikë e kanë mbetur të izoluar. C'është më e keqja, pjesëmarrës të tillë në garat elektorale ose kanë mbetur të pashpërblyer me mbështetje nga ana e zgjedhësve, ose nuk kanë mundur të garojnë për së dyti, ngaqë partia e tyre ka parë tek ata ca personazhe të sjaqur e të dobët. Dhe kështu janë zëvendësuar nga aspirantë të tjerë për deputetë apo për kryetarë bashkish e komunash, të cilët kanë qenë e janë më afër modelit rutinor, që prodhon e përqendron politikë shqiptare: kandidati që ka mundësi të mbledhë parë, që ka mundësi të bëjë për vete banda të zhurmshme militantësh e merce-narësh, e që nuk ka skrupuj, kur vjen puna për ta kryeqëzuar rivalin e tij me të gjitha mënyrat e mjetet e mundshme.

Fushata e këtyre ditëve po nxjerr në dritë pikërisht këtë model kandidati e këtë lloj qasjeje elektorale. Egërsia e garës në terren nuk mungon të spektakolarizohet edhe nëpërmjet debatare të organizuara nga më shumë se sa një televizion, ku nuk bie në sy vetëm tërbimi e urrëjtja që kandidatët e demonstrojnë hapur ndaj njëri-tjetrit, por edhe statura e tyre e vogël politike e profesionale. Kur qëllon që rreken të bëjnë veshjen programore apo ideologjike të çalltisjes së tyre elektorale, gjithçka reduktohet në një ligjërim i mjerë prej belbacukësh e në një retorikë e mbushur me demagogji. Kjo dukuri e fundit edhe mund të gëlltitet, pasi askush nuk pret që person-

azhe politikë që banojnë e jetojnë larg metropolit të shfaqen si përfaqësues të një mentaliteti e fryme të re në politikën shqiptare. Mund të gëlltitet, jo ngaqë larg metropolit nuk mund të gjenden njerëz, që kërkojnë e ndjekin modernitetin, por ngaqë rëndom politika e Tiranës nuk është e prire për t'i gjuajtur kandidatët të kjo kategori njerëzish.

Ajo që nuk mund të gëlltitet është gatishmëria e kandidatëve për të vulgarizuar goftë paraqitjen e tyre individuale, goftë ballafaqimin e komunikimin me tjetrin. Dhe nuk dinë të ndalen as përpara kamerave televizive. Mund të ndodhë që kandidatët t'i kenë të gjitha kartat në rregull, d.m.th. të jenë të bredhur e të kënduar, të jenë diplomuar jashtë vendit, të dallohen për ndonjë arritje profesionale, të kenë një origjinë të hijshme familjare, e prapë se prapë me t'u vënë përballë njëri-tjetrit, ata nuk dëshmojnë asnjë çikë vetëpërmbytjeje e klas. E kur i sheh të zbrisin plot qejf në këto nivele, nuk merret vesh se ç'kuptim kanë ato CV-të e mbushura me përvoja universitare, akademike dhe me vetëm-burje demodë të llojit "unë njoh gjuhë të huaja" apo "unë rrjedh nga një familje tradicionalisht qytetare".

Ç'kuptim ka të "rrjedhësh nga një familje tradicionalisht qytetare" e të jesh diplomuar në Perëndim, kur në rastin më të parë të një ballafaqimi publik, me njerëz që janë të ndryshëm nga ty, ti nuk di të bësh gjë tjetër veçse të

Kur qëllon që rreken të bëjnë veshjen programore apo ideologjike të çalltisjes së tyre elektorale, gjithçka reduktohet te një ligjërim i mjerë prej belbacukësh e te një retorikë e mbushur me demagogji. Kjo dukuri e fundit edhe mund të gëlltitet, pasi askush nuk pret që personazhe politikë që banojnë e jetojnë larg metropolit të shfaqen si përfaqësues të një mentaliteti e fryme të re në politikën shqiptare

dëshmosh se je shumë larg frymës qytetare e qasjes perëndimore. Çfarë dreqin ke mësuar në Perëndim apo çfarë dreqin ke trashëguar nga origjina qytetare e familjes, kur në një kohë që të tjerët presin të marrin vesh ofertën tënde elektorale-politike, ti u ofron atyre "ndryshetë e zullumet" e bëra nga kundërshtari yt? Kjo gjë ndodhi edhe me debatin midis përfaqësuesve të Korçës, këtij qyteti që ndriçon, jo vetëm në historinë e Shqipërisë, por edhe sot e gjithë ditën. Korça është nga të pakat qytete të Shqipërisë, ku gjen në çdo hap qibër e klas në sjelljet e manierat e njerëzve. Duhet të jetë edhe për këtë arsye, që përfaqësuesit politikë të këtij qyteti, në mos kanë fakultetin, duhet të ndiejnë detyrimin për ta rrezatuar këtë qibër e këtë klas në vepërmëritë e tyre politike e publike. Por kandidatët për kryetar bashkie të Korçës, Papa e Peleshi, respektivisht të PD-së e të PS-së, nuk arrijnë të demonstrojnë që ishin përfaqësues të kësaj Korçe. Duket që ata kishin brumë në planin politik e profesional, duke qenë atyre nuk u mungonte aftësia për të artikuluar ide e projekte në funksion të administrimit të punëve të bashkisë, por një dreq e di se pse ishin të vendosur për ta shndërruar këtë ballafaqim televiziv në një duel të egër e të pamëshirshëm, duke mos ngurruar të shtinë punë mjetet të huazuara nga një kallëp tjetër njerëzish.

E ndoqa me kujdes atë debat, tek-tuk të copëtuar

dhunshëm nga tifozllëku i të rinjve e të reja ve të fuar si spektaktorë (Fevziu ka bërë një gjetje të gabuar. Ata spektatorë-tifozë nga njëra anë janë shumë të bezdisshëm për shikuesit televizivë, nga ana tjetër u bëjnë një frymëzim të lig kandidatëve, të cilët në këto rrethana nuk e kanë për gjë të adoptojnë qasje gladiatorësh). Tonet e egra, shkreptimet e urrjetjes për sho-shoqin, që u lexoheshin në veshtrimet e tyre, zhibrilimi me zell voyeurist në jetën private të kundërshtarit, transferimi i garës në planin e dëftësive të shkollës së mesme, vetëmburja me çikërrima të llojllojshme, batutat e pashijshme, të cilat hidheshin nga pozitat pretencioze të një pundit-i, përbuzja e zhvëlftësimi i tjetrit nëpërmjet fyerjes e qëndrimesh mospërfillëse, të gjitha këto pra, tok me faktin që mungonte fara ndeshja e programeve dhe e projekteve të zhvillimit, ishin provë e një show bezdisës e të pavlerë.

Kjo gjë po ndodh kudo nëpër Shqipëri. Madje, ballafaqimet elektorale në qytete të tjera janë edhe më të shëmtuara, ngaqë së pari mungon ajo trysia qytetare nga poshtë (gjë që në Korçë, edhe pse mund të mos perceptohet, është e pranishme sidqoftë), e ngaqë së dyti kandidatët kanë një statut politik, profesional, civile, intelektual e kulturorë më të shfrytë se sa statura e Papës e Peleshit. Gjithçka ka lidhje me tonet elektorale të inspiruara nga Tiranë? Nuk duket se është kështu. Edhe herë të tjera ka pasur frymëzime të tilla nga këdo, por nuk kanë munguar megjithatë modele të ndryshëm kandidatësh, të cilët kanë refuzuar ndjekjen e këtyre frymëzimeve. Spartak Ngjela në Tiranë, Adrian Turku e Hyzen Domi në Elbasan, e ndonjë tjetër gjetikë, kanë qenë shembuj i një fryme të ndryshme në ballafaqimet elektorale. Është për të ardhur keq, që modelet të tilla i mungojnë kësaj fushate elektorale. Është e rastësishme kjo gjë? Ndoshta, por nuk do të ishte mëkat të mendohet se politika e Tiranës ka zënë ose mos i preferojë, ose t'u trembet modeleve të tilla. Ka gjasë që të jetë kjo e fundit, pasi modelet të tilla nxjerrin zbuluar mjerimin e establishment-it politik të kryeqytetit.

MATRAPAZET E DEMOKRACISE

MENTOR KIKIA

Nëpër lagjet e fshatit ditën mund të futesh lirshëm fare, pasi qentë janë të gjithë në gjumë të thellë, sepse gjithë natën fshati gjëmon nga të lehurat e tyre. Janë korrierët, korrierët e kandidatëve që futen natën nëpër shtëpitë e fshatarëve dhe bëjnë fushatë".

Po çfarë thonë, si e bëjnë fushatën natën?

-E ç'të na thonë? Diku premtojnë miell, diku 20 apo 30 mijë lekë (të vjetra) për familje. Kështu është bërë tani. Këtu kryetari i komunës kandidon për PS-në, shefi i urbanistikës së komunës për PDK-në. Ai është me PD-në në fakt, por s'vijet kaloi me demokristianët, meqë e morën ata zonën. Kanë vite që punojnë bashkë, bëjnë sikur ndeshen dhe në fund drejtojnë bashkë, kushdo që të fitojë, mbajnë njëri-tjetrin.

Ai që na tregon këtë histori qenish është një banor i komunës Papër në Elbasan. Ai e thotë këtë si një gjë normale, i fut një të qeshur dhe largohet, duke lënë pas një dëshirë të fortë për këtë realitet të hidhur. Ndërsa në Gjinjar, një tjetër komunë në Qarkun e Elbasanit, kandidati i të djathtës, që i përket PBDNJ-së, për gjashtë vjet ka qenë kryetar i këshillit të komunës dhe ka përfaqësuar Partinë Socialiste. Meqë partia e tij nuk e kandidoi, një mëngjes të bukur ai u bë demokrat dhe, kur zona iu dha PBDNJ-së, ai iu bashkua kësaj partie. Në një komunë në Durrës për pak u futën në punë pistolatat, pasi zona iu dha PDK-së nga koalicioni i djathtë dhe kandidati i PD-së, që është kryetar aktual, brenda natës ishte bërë demokristian dhe kërcënohet demokristianin "safi" që të tërhiqej, derisa më në fund e "bindi".

Na u desh të udhëtonim në disa fshatra për të parë, degjuar dhe për të ulerisur, pasi mësuam realitetin ndryshe të fushatës elektorale për zgjedhjet vendore. Jashtë skenave entuziaste, me flamuj dhe banderola që ofrohen në ekrane, të cilët mundësojnë që edhe një miting me 30 veta të duket si madhështor, realiteti në bazë është vërtet një gjellë qenish. Historitë që dëgjon për mënyrën se si janë përgjzdhur kandidatë të bëjnë që të marrësh arratinë, por po aq të bëjnë edhe të përpiqesh për ta denoncuar këtë maskaradë. Kryetarët e degëve të partive në rrethe janë shndërruar në shefa mar-



ketingu. Kryesisht në komuna e bashki të vogla, kandidatët kanë paguar para për t'u regjistruar. Ndoshta shkon nga 10 deri në 15 mijë euro për komunat dhe deri në 20 mijë euro për bashkitë e vogla.

Një mekanizëm që lindi në mënyrë ilegale pak vite më parë, s'vijet është shndërruar në procedurë legale, duke vënë në kusht konkurrencën e lirë në politikë. Të pakët kështu thotë thashethemi popullor, që ka për informacion kandidatit hajvan që krenohet se është në garë, sepse pagoi kryetarin e vetë. Por që konfirmohet gjithashtu edhe nga fakti se si ka mundësi që një parti të pranojë si kandidat një eksponent të një partie tjetër, që konfirmohet gjithashtu edhe nga fakti që shumë kandidatë janë vënë në listë në momentet e fundit, duke spostuar ata që ishin përgjzdhur më parë. Diku tjetër nuk është

Zgjedhjet vendore do të mbyllen dhe bashkë me to edhe historitë e kandidatëve. Ndërsa qentë më në fund nuk do të kenë kaq shumë punë dhe do të mund të flenë nga pak edhe natën. Por jo për shumë kohë. Do të vijin zgjedhjet parlamentare dhe ata do të zgjohen për të ulëritur edhe më shumë

të e nevojshme të paguash, pasi dëgjon se "ai" është zgjedhur pasi e ka sigur fitoren, sepse ka qenë me FNSH-në (Forcat e Ndërhjës së Shepjetë) dhe se çunat e xhaxhait të tij janë të gjithë të hurit e të litarit.

Të bërit fushatë është një tragjedi shoqërore më vete. Në fshatra ulëriten qentë nga korrierët që shpërdajnë para e premtojnë miell, në qytete kandidatët vetë, në mënyrë demonstrative, grisin defetërit e borxheve që votuesit kanë në dyqanin e ushqimeve. Pas 17 vjetësh, demokracia shqiptare po rëshqet drejt një regresi fatal. Elementet e ndeshjes politike në publik, rivaliteti i ideve, projekteve dhe platformave janë zëvendësuar me matrapazllëkun që vegjton për shkak të korrupsionit, injorancës dhe varfërisë. Vota e lirë nuk është më e tillë, por një mall që shitet

dhe blihet. Në periferitë e përbaltura të qyteteve dëgjon që një kandidat u premtonte 15 të rinjve se do t'i bëjë shofër të makinës së tij zyrtare, 20 grave se do t'i bëjë nëpunëse të të vetmes zyrë të shërbimit të gjendjes civile. Dëgjon dikë të thotë se do të votojë për X kandidat, pasi ai i ka premtuar se do t'i fusë të bëjnë në këshillin e komunës, edhe pse ajo është 16 vjeçe dhe as votohet e as voton. Dëgjon të kërcënohen njerëz se do të pushohen nga puna, nëse nuk bëjnë gjë të mirë në këshillin të votojë kandidatit e partisë në pushtet.

Dëgjon të ketë frikë nga kryetari i komunës një njeri, i cili shtëpinë, bukën dhe ushqimin e ka siguruar vetëm nga puna në Greqi dhe nuk i ka asnjë detyrim as komunës e as qeverisë. Përfundim të përbaltura nuk ka më librar, salla kulturore apo diç tjetër të këtij lloji. Injoranca e shtruar vendqë në zonat rurale ka krijuar një shtrat të favorshëm për vegjetimin e matrapazëve të politikës. Nga ana tjetër, vetë partitë politike, të shtrura nga elementët intelektualë, po ftojnë në skenë të fortë dhe të korruptuara që blejnë vota. Igjithë kjo ruralizëm politik e ka kthyer nivelin e klasës politike shumë vite prapa, më poshtë se në kohën kur drejtuesi emërohej dhe përgjzdhje mbi bazën e biografisë politike.

Korrupsioni masiv i klasës politike dhe veçanërisht elementëve drejtues, në të gjitha nivelet, instinktivisht ka tërhequr në gjirin e saj biznesin e zi, njerëz ka kontribut shoqëror e intelektual. Hidhlin një sy Parlamentit. Më shumë se gjysma e tyre janë krejtësisht anonimë dhe nuk kanë thurur dot një herë një diskutim. Disa syresh kujtohen vetëm kur hedhin ndonjë voto apo shkatërron një ndonjë karrige. Pjesa dërkompulsive e tyre janë biznesmenë dhe nën-petkun e politikës i hapin udhë biznesave të tyre. Ky mjedis ka shpërbërë edhe inteligjencën që iu bashkua politikës në vitet e idealizmit të madh. "U futu në politikë - na tha një ditë një mjek - sepse dëket të ulja pak dozën e lumit". Por, mesa duket kjo dozë është kaq e madhe sa shkatërron çdo antikorp që mund t'i injektosh. Zgjedhjet vendore do të mbyllen dhe bashkë me to edhe historitë e kandidatëve. Ndërsa qentë më në fund nuk do të kenë kaq shumë punë dhe do të mund të flenë nga pak edhe natën. Por jo për shumë kohë. Do të vijin zgjedhjet parlamentare dhe ata do të zgjohen për të ulëritur edhe më shumë.

SHQIPNI TAVOLINASH

ARTAN LAME

lameartan@yahoo.com

METAMORFOZA

Që të mos mbash të gjitha premtimet që bënë në fushatë, është gjë normale ngado. Që të ndërrosh mendje për çështje të caktuara për shkak të ndryshimit të situatave, të njohjes më të thellë të problemeve kur je në qeverisje edhe kjo habet (nuk është shumë normale, por sidoqoftë habet). Por t'u biesh hasha të gjitha atyre ç'ka ke thënë në fushatë, është pak si shumë. Shiheni tabelën që ju sjell këtu dhe zori të më gjeni ndonjë pasaktësi në të. Sipas rregullave të kohëve që jetojmë, njerëzit votojnë dhe zgjedhin për një program të caktuar dhe për një varg gjërash të premtuara. Por, po që se të gjitha ato që ke premtuar dalin se i ke thënë gabim apo u bie hasha pa të keq, do goxha kurajo në bark dhe cipë të trashë në faqe që të rrish në karrige e të mos japësh dorëheqje.

DENSITETI I MARREZIVE

Densitetin maksimal të marrëzive për javën që shkoi e mban ministri i Kulturës Leskaj, me një në çdo 48 orë.

Të hënën firmosi një marrëveshje me Ministrinë e Brendshme për moslejimin e shfrytëzimit të fëmijëve në turizëm. Meqenëse nga kronika nuk që e qartë nëse bëhej fjalë për shfrytëzim të të miturve për punë në hoteleri apo për shfrytëzim seksual të të miturve, të nesërmen mora në telefon në ministri për t'u sqaruar. Natyrisht që as ata nuk e kishin të qartë: "Shefo, se dim mir po se ç'u bo i konferencë për këtë pun jasht shtetit dhe ministri deshi ta bote edhe ai ktu".

Në një vend ku i gjithë bregdeti po mbushet me beton pa leje; ku ka qindra hotele pa licencë; ku nuk ekziston më një sistem licencimi a shkollimi profesional; në vendin e vetëm në Evropë ku nuk ka më as sistemin të vlerësimit të hoteleve me hyje dhe ku numri i yjeve për-caktohet nga hapësira e lirë në tabelën e hotelit; ku edhe hoteli i ministrit i ka vjet pa leje; në vendin ku nuk ka as regjistrat të punësuarish; ku shumica e hoteleve janë mbi bazë punësimi familjar; në këtë vend pra, të për-caktohet si prioritar për zhvillimin e turizmit moslejimin e të miturve për të punuar në hotele, është gjeniale. E vetmja i mitur në atë ceremoni ishte Iva Zajmi, zëvendësiministrja e Brendshme, e cila dukej që po firmosiste një gjë që nuk i hynë në punë as direktori. Dreqit jo, por Leskaj për të dalë në televizor po.

Kalojnë 48 orë dhe ministri ulet para kamerave të firmosë një tjetër marrëveshje. Këtë radhë me italianët e INTERREG-3 për zhvillimin e turizmit nënujor në Shqipëri. Opo me të tallin legenin këta? Po moratoriumi e skafve ku e la ministri? Se mirë që italianin nuk

“Po që se të gjitha ato që ke premtuar dalin se i ke thënë gabim apo u bie hasha pa të keq, do goxha kurajo në bark dhe cipë të trashë në faqe që të rrish në karrige e të mos japësh dorëheqje”

DJE	SOT
Nuk do të lejojmë të ndërtohet TEC-i në Vlorë, se shkatërron mjedisin.	TEC-i i Vlorës do të ndërtohet, se do të zgjidhë çështjen energjetike!!! Kalojnë edhe 6 muaj: Do të ndërtojmë nga një TEC në çdo qytet.
Nuk do të ndërtohet Parku Energjetik i Vlorës, se atje janë pronat e vjedhura të socialistëve.	Duhet të ndërtojmë Parqe Energjetike në Vlorë dhe në qytete të tjera, se janë shpëtimi i biznesit.
Shitja e ALBTELEKOM-it do të anulohet, se është vjedhje ndaj shqiptarëve.	Kontrata e shitjes së ALBTELEKOM-it është e vlefshme dhe do të realizohet.
Kakomeja është vjedhja e hapur e pronarëve të ligjshëm nga hajdutët e Nanos.	Kakomeja do të ndërtohet, se është investim i ligjshëm dhe shembull i futjes së biznesit të huaj në Shqipëri.
Kazinoja në qendër të Tiranës do të mbyllet.	Kazinoja është biznes i ligjshëm dhe unë nuk mund të ndërhyj.
Ne do t'ua japim naftën fermerëve edhe më lirë sesa thonë socialistët.	Nuk do ta japim fare naftën për fermerët, se nuk funksionon.
Do të bëjmë një inventar të të gjitha pronave të lira shtetërore për t'ua kthyer ish-pronarëve.	Do të bëhet një inventar i saktë i pronave të lira shtetërore, për t'ua dhënë të huajve për një euro.
Do t'ju jap më shumë fonde bashkive socialiste, sesa merrnin nga qeveritë socialiste.	Nuk u jap asnjë lek bashkive socialiste, se ato i vjedhin!!!
Unë zbatoj vetëm Kushtetutën.	Spartak Ngjellës: "Nuk pyes për Kushtetutën unë".
Do ta ndryshojmë KKRT-në, se ka shumë anëtarë.	Do të krijohet një KKRT të re, me më shumë anëtarë se më parë.
Tenderat e KESH-it, që bëhen me prokurim të drejtpërdrejtë, janë vjedhje e socialistëve.	Të gjithë tenderat e KESH-it do të bëhen me prokurim të drejtpërdrejtë, për të mos e lënë vendin pa energji!!!!
25% e EFT-së (fituese e tenderit të energjisë) është pronë e Fatos Nanos.	Energjia do të blihet me tender të drejtpërdrejtë nga EFT 30% më shtrenjtë.
Nuk i çoj në prokurori dosjet e socialistëve se prokuroria është e kapur nga krimi.	Për dosjen e ALBATROS-it: Nuk veprojmë kundër drejtorit, se ia kam lënë Prokurorisë që asht e specializuar.
Studimi i Qendrës së Tiranës është kriminal, se është shitur me euro për metër katror nga kryetari i bashkisë.	Studimi i Qendrës së Tiranës është shumë serioz.
Nuk do lejoj që taksapaguesit më të varfër të Evropës të detyrohen të marrin kredi 60 milionë USD për të ndërtuar fabrikën e cimentos të kompanisë private të Nanos.	Inaigurimi i fabrikës më moderne të cimentos në kontinent është një ngjarje e madhe për Fushë-Krujën dhe për gjithë Shqipërinë.
Kreshendoja e Kryeprokurorit: Para një viti: fshehës i dosjeve të krimit. Para 6 muajsh: mbrojtës i krimit. Para 3 muajsh: mbështetës i krimit. Sot: shtyllë e krimit.	Kreshendoja e Xhuvellit: Para një viti: Regjisor i ansambllit "Babëzia". Sot: Ministër i suksesshëm.

e di atë punën e moratoriumit (madje edhe po t'ia thonë, duhet të bëjnë be, se përndryshe nuk do ta besojë për të vërtetë), po ministri me të tijtë, që e dinë shumë mirë që moratoriumi më mënyrë taksative e ndalon këtë punë për shqiptarët? Aq sa edhe i ziu Xhemal Mato, që kishte një shoqatë zhytësish shqiptarë, e ka nxjerrë varkën në tako dhe pret të hiqet moratoriumi pa ta shohë edhe një herë detin dhe nëndetin me sy.

Kalojnë edhe 48 orë. Kryeministri firmos marrëveshjen për fillimin e ndërtimit të TEC-it në Vlorë, të cilin e kishte mallkuar për dy vjet rresht. Madje, thelë mbi bisht, premtoi që do të ndërtohet nga një TEC në çdo qytet. Budallallëqe, po neise. Unë dua t'u kujtoj këtu njerëzve që Bujar Leskaj para një viti doli përpara gjithë Vlorës dhe deklaroi se "po të ndërtohet TEC-i në Vlorë, unë do të jap menjëherë dorëheqjen". Bujar, jepe dorëheqjen, që të më lesh mua pa fjalë dhe që njerëzit të më thonë: He, e sheh që ta futi Bujari, e dha dorëheqjen dhe ti s'ke ç' t' thu!

SHKALLNURI I LIBRAZHIT

Dy vjet rresht Berisha ia mbajti këngë Nanos aksidentin e Shkallnurit. Një ngjarje fatkeqe që nuk i hyj dot në ëshë a jo e vërtetë, por që sidoqoftë nuk mund të përdoret radhë pas radhë sa herë Berishës i duhet si argument shtesë kundër socialistëve, demok aq të liq janë, sa as makinës nuk dinë t'i japin e shtypin njerëz. Sikletë të tilla, në çdo vend normal mbahen sa të jetë e mundur të rezervuara, më së paku për të respektuar dhimbjen e familjarëve, pastaj për të respektuar ndjenjat e atij që e ka kryer, i cili edhe ai ka ngarkesën e vet emocionale dhe më së shumti sepse mund t'i ndodhin kujtdo. Por asgjë nga këto nuk u respektua dhe të gjithë dëgjimin Berishën që një e dy në mes parlamentit na kujtonte të vdekurit dhe fliste për kriminelët e Shkallnurit. Por ja që bota u rrotullua dhe i erdhi radha që fatkeqësia (falë Zotit, më e lehtë) t'i ndodhë Berishës në Librazhd.

Djema, dymijë e kusur vjet të shkuara të urrejt shkruanin Librat e Shenjtja që qysh prej atëherë i shërbejnë njerëzisë për të nxjerrë mësim. Kur përipiemi të imagjinuim punën e tyre, ndonjëherë na duket sikur atëherë-motit të urrejt zgjoheshin në mëngjes, uleshin mbi ndonjë gur me kartë e penë, dhe nga hici shkruanin. Jo, nuk është kështu. Në ato faqe që na kanë lënë, ata përmbledhojnë dijet, ngjohurit, rezultatet, idetë, thelbin e mijëra e mijëra të ngjarave që kishin ndodhur. Dhe për sa i takon kësaj ndodhëse sonë, tekta kish ngjarje shumë e shumë herë mes tribunës të atyre kohëve që, pasi të kishin bërë një të keqe, të ndryshojë radha dhe e keqja t'u binte mbi kokë, të urrejt e përmbledhën mësimin e dalë në një varg të vetëm: "Mos i bëj tjerit atë që nuk do që të ta bëjnë ty". Lexoju o i paudhë Li-brat e Shenjtë të turqve e kauërve, se të dy palët, secili në gjuhë të vet, e kanë këtë varg.

Kujt i shërben protesta në Kosovë?

ARBEN VATA

Në orët e vona të ditës së shtunë, një kryetar i një partie periferike në Maqedoni e që shu mikën e kohës e kalon në Shqipëri, u çoi një sms gazetarëve në Tiranë, duke thënë se një prej të lënduarve të protestës së "Vetëvendosjes" vdiq që dhe ai është tashmë dëshmorin më i ri i kombit... Sms që nuk tronditi botën mediatike jo vetëm për shkak të vërtetësisë së pa provuar të lajmit, por edhe të pasojave që mund të kishte për vijimësinë e fazës përmblylëse të negociatave për Kosovën, erdhi në të njëjtën kohë kur për fat të keq pamjet e protestës së organizuar nga "Vetëvendosja" po bënin xhirim në televizionet më prestigjioze të botës. Duke e vënë sërish Kosovën dhe shqiptarët si lajm të parë, por sigurisht në sensin negativ, atë të paqëndrueshmërisë dhe destabilitetit. Ka pasur gjithmonë dhe të ketë debate lidhur me atë nëse Kosova duhet ta kishte krijuar pavarësinë e vet nëpërmjet rrugës gande, sic bëri i ndjeri i ish-presidenti Rugova, apo nëpërmjet grykës së pushtës, sic bëri në fillim heroji Adem Jashari dhe pa më mirëra djem e vajza në të gjithë Kosovën. Debatet ndoshta vazhdojnë edhe sot e kësaj dite kur Kosova është në metrat e fundit të maratonës për të arritur në finishin e pavarësisë, por sot nuk mund të thuhet se jemi në të njëjtat rrethana siç ishim 8 apo 9 vjet më parë kur dhimbja kishte arritur

deri në palcë, kur veç rrëmbimit të armëve shqiptarëve të Kosovës nuk u kishte mbetur rrugë tjetër pa provuar për fituar pavarësinë si të gjithë popujt e tjerë të botës. Ndaj dhe nisja e luftës prej tyre u mbështet fuqishëm nga NATO dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pa ndihmën e të cilëve sigurisht që nuk do të ishte bërë i mundur çlirimi i Kosovës nga zgjedhja serbe. Duam apo nuk duam ta pranojmë, pa ndërkombëtarët, pa ushritë e huaja, pa diplomacinë ndërkombëtare, Kosova nuk do të mund të arrinte asgjë vetë. Ndaj edhe për këtë fakt, për këtë të vërtetë të pamohueshme historike, me hir apo me pahir, do të jemi të detyruar që të pranojmë rrugën, mënyrën dhe kohën e nevojshme që na propozojnë të huajt për të shkruar deri te pavarësia. Edhe paketa e Ahtisarit, sado që nuk e thotë në mënyrë eksplicite këtë term, aq të dëshiruar prej shqiptarëve, përkisist këtë nënkupton, një pavarësi të ngadaltshme, por të sigurt dhe copëtimin përfundimtar të Serbisë, sigurisht pa pasur pjesë të saj Kosovën. Sigurisht që propozimet e Ahtisarit nuk janë më të pëlqyeshmet të mundshmet për shqiptarët, por për momentin ato janë shumë racionale dhe kënaqin aspiratat e shumicës së shqiptarëve në trojet e tyre në Kosovë. Sigurisht që pritej edhe një reagim ndoshta edhe i madh popullor, që i nxirrte jo vetëm nga organizatat jo qeveritare, por edhe nga ndonjë lider politik, prisin shpalljen e menjëhershme të pavarësisë. Në një vend demokratik, siç pre-

Nëse deri në përfundimin e bisedimeve dhe caktimin e statusit përfundimtar të Kosovës do të ketë "dëshmorë", faji sigurisht nuk do të jetë i dëshirës popullore për ta parë vendin të pavarur, por i politikës dhe ndikimeve shoqërore që nuk është e tepërt të thuhet se vazhdon të sponsorizohet nga qarqe serbe për të mbajtur Kosovën gjithnjë si një tokë të trazuar dhe për faj të shqiptarëve, që siç edhe kësaj here do të na thuhet "nuk dinë të qeverisin"

tendon që të jetë edhe Kosova, është normale që të organizohen protesta dhe të ketë kundërsht, por kjo nuk mund të shpëtojë nga shfaqja e dhunë dhe përlëshje të protestuesve me policinë, vendase apo ndërkombëtare. Në momentet kur bisedimet për statusin e Kosovës janë shtrë pak ditë me insistimin e serbëve dhe grupeve lobuese pro tyre në diplomacinë ndërkombëtare, një protestë e de-gjeneruar në dhunë, në të vdekur apo të plagosur, është realisht shërbimi më i mirë që shqiptarët, me apo pa dashje, mund t'u bëjnë serbëve. Pamje të tilla që pamë në fundjavë në protestën e "Vetëvendosjes" janë një argument i mirë dhe ndoshta shumë efikas për t'u përdorur nga serbët dhe aleatët e tyre në dem të shqiptarëve si më 21 shkurt, kur dy palët do të takohen në Vjenë, ashtu edhe më vonë pas pak javësh në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, që do të vendosë përfundimisht për statusin e Kosovës. Një pjesë e popullsisë mund të mos jetë dakord me një vendim që merr politika vendase apo për më tepër diplomacinë ndërkombëtare për fatin e kufijve dhe kompetencave të vendit tonë. Por kur kjo gjë arrihet dhe pranohet me konsensusin e plotë të partive kryesore politike në vend, por edhe të faktorit tjetër mbarëshqiptar, të ngrihet dhe protestosh me dhunë ndaj të ardhmës së brishtë të vendit tënd ndoshta me qëllimin e vetëm për t'u faktorizuar, nuk është as më shumë dhe as më pak, por të minosh prospektin e vendit tënd.

Do të thotë t'u shërbejë edhe falas qëllimeve të armiqve të tu historikë dhe të kthes mbapa për dy orë vite të tëra luftë, përplekje diplomatike dhe vite prove të qeverisjes kosovare. Kur bota kërkon më shumë se kurrë një Kosovë multietnike, të qetë dhe të sigurt edhe për pakicën, të krijosh situata dhunë në protestat e shqiptarëve është sinjali më i keq sesi politika e Kosovës mund të sillet në një rast të mundshëm ndaj një proteste të ligjshme të pakicës serbe apo dikujt tjetër. Gjithmonë që Kosova pritet të kalojë situatat të paqëndrueshme, gjithmonë gjendet një sebash që shqiptarët atje të tregojnë urrejt, trazim dhe nacionalizëm të theksuar, por që realisht përdoret si argument më shumë nga serbët për të mos lëshuar Kosovën, apo më e pakta për të mbajtur pjesë të saj, ose siguruar protektorat të përhershëm apo sa më të gjatë ndërkombëtar në disa rajone të saj të pasura. Nëse deri në përfundimin e bisedimeve dhe caktimin e statusit përfundimtar të Kosovës do të ketë "dëshmorë" të tjerë të pavarësisë, faji sigurisht nuk do të jetë i dëshirës popullore për ta parë vendin të pavarur, por i politikës dhe ndikimeve shoqërore që nuk është e tepërt të thuhet se vazhdon të sponsorizohet nga qarqe serbe për të mbajtur Kosovën gjithnjë si një tokë të trazuar dhe për faj të shqiptarëve, që siç edhe kësaj here do të na thuhet "nuk dinë të qeverisin, të administrojnë pa të mbajne të frenaara ndjenjat e tyre kundër popujve të tjerë fqinj me ta".

**ZGJEDHJE
VENDORE
2007**
✓vota Juaj Vullneti Juaj



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

www.cec.org.al

18 SHKURT 2007 zhvillohen zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore.
Me votën tuaj ju do të zgjidhni përfaqësuesit
tuaj në Organet e Pushtetit Vendor.




Votohet nga ora

07:00

deri

18:00



NDALOHET rreptësisht
votimi në **grup**
dhe votimi **familjar**



Respektoni rradhën dhe rregullat e votimit

✓vota Juaj Vullneti Juaj



"Letra nga Iwo Jima", rishfaqja e suksesshme artistike e VIP-it Clint Eastwood si regjisor. Armiqësia japonezo-amerikane e 1945 në Festivalin e Filmit të Berlinit

NE FAQEN 20



Shqip NDRYSH E



Si ka hyrë termi lugat në gurrën popullore shqiptare dhe diferencat e traditat gojore të fqinjëve grekë e sllavë?

Mitologjia shqiptare në arkivat e Vatikanit

Petrus Thomas dhe roli i legatëve papnorë në Shqipërinë mesjetare

Antropologjia historike, e cila ndryshe nga historia e mirë fillit që studion ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën, studion fenomenet që megjithëse kanë ndodhur në të kaluarën janë prezente edhe në të tashmen, është një disiplinë e cila vazhdon të mbetet fare pak e hulumtuar në historiografinë mbarëshqiptare. Gurra popullore shqiptare, si në leksik ashtu edhe në folklor, e mitologji është një burim i jashtëzakonshëm historik që me pasurinë e saj mund ta shpjerë studiuesin deri thellë në kohërat e errëta të mesjetës e madje të lashtësisë, duke ndriçuar kështu aspekte historike që janë pak të evidentueshme me dokumente të shkruara. Ajo mund të shërbejë gjithashtu edhe si një mbështetje e pakontestueshme për dokumentet e shkruara që mund të japin vetëm fragmente nga e kaluara historike dhe që në pamje të parë japin përshtypjen se këto fragmente janë thjesht aksidentale dhe jo të rëndësishme apo gjurmëlënëse në historinë dhe kulturën e një komuniteti të caktuar njerëzor. Kemi prekur në shkrime të tjera faktin që autoriteti papnor ka luajtur një rol jo të vogël në territoret etnike shqiptare gjatë mesjetës, autoritet ky që paraqitet bindshëm në burimet e shkruara dokumentare që kryesisht gjenden në Arkivin Sekret të Vatikanit, por edhe gjetë. Megjithatë, ky autoritet papnor mund të dëshmojë edhe me anë të gurrës popullore, siç do të paraqesim në këtë shkrim duke analizuar disa fjalë të leksikut shqiptar që çuditërisht nuk janë me rrënjë shqiptare dhe nuk gjenden as në leksikun grek apo sllav. Këto fjalë pra nuk janë të huazuara, por janë të krijuara...

NE FAQET 14-15



Beteja e Fushë-Kosovës, qershor 1389, pikturë në vaj

Ç'rol luan në politikën e sotme serbe historia e 600 vjetëve më parë dhe synimet ruse në Ballkan

Beteja e Fushë-Kosovës dhe statusi

Politika serbe ndaj Kosovës rreh tash më në tri drejtime bazë: në eposin e ngritur, sigurisht, jo thjesht dhe vetëm nga Millosheviçi, i cili lidhet me një përplasje të armatosur me origjinë nga Mesjeta; bindja se i referohen të drejtës së popujve për mbrojtjen e tërësisë territoriale, si

dhe përpjekjes jo gjithmonë të suksesshme për të ndjekur një "real-politikë", ku cmohet dhe ftohtësia e mundësitë që të jep momenti. Mund të duket me fundamentale që të merremi me kapërcimin e menduar në histori të konfliktit të Kosovës. Ajo çka ndodhi në një ditë qershori të vitit 1389 në

Fushë-Kosovë është për vlerësimin e situatës së sotme jo lehtësisht e shmangshme. Dhe aspak për t'u neglizhuar e për t'u zhvendosur në plan të dytë është edhe ajo çka ndodhi pas betejës së serbëve nën udhëheqjen e princit të tyre Lazar...

NE FAQEN 18

TRENDI



Dashuritë online që nuk njohin moshë

R Fortune3", marinari zeshkan dhe me sy lajthi kërkon një shoqe me të cilën të mund të kalojë jetën. Ka një rrogë 50000 deri në 75000 dollarë në vit, nga pikëpamjet politike është me të djathtë dhe preferon femrat që merren me vrap. Është 62 vjeç dhe nuk kërkon vajza të vogla: shpirtin e tij binjak e dëshiron rreth moshës 45 deri në 55 vjeç. Ndërsa "Clayper27", është budist, një romantik i stilit të vjetër, ku dëshiron të shijojë gjithmonë darka nën dritat e qirinjve. Është pothuajse rreth të 54-ave, për femrën e tij ideale nuk ka shumë preferenca race, krahine apo besimi, por pika e tij e dobët janë flokët e gjata. Moshë e preferuar: edhe poshtë të 40-ave. Mirëerdhëti në universin e ri të dashurisë online. Çfarë surprize, nuk është më panorama ekskluzive e adoleshentëve, studentëve apo profesionistëve të rinj, por është hapur një publiku të përkur. I pari që e kuptoi ishte giganti "Match.com", sajti amerikan i takimeve...

NE FAQEN 19



Il caffè... per passione

Histori & gjuhësi

Mitologjia e traditës popullore sipas burimeve dokumentare

DR. ETLEVA LALA
Vatikan

Antropologjia historike, e cila ndryshe nga historia e mirëfilltë që studion ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën, studion fenomenet që megjithëse kanë ndodhur në të kaluarën janë prezente edhe në të tashmen, është një disiplinë e cila vazhdon të mbetet fare pak e hulumtuar në historiografinë mbarëshqiptare. Gurra popullore shqiptare, si në leksik ashtu edhe në folklor, e mitologji është një burim i jashtëzakonshëm historik që me pasurinë e saj mund ta shpjegjë studiuesin deri thellë në kohërat e errëta të mesjetës e madje të lashtësisë, duke ndriçuar këstu aspekte historike që janë pak të evidentueshme me dokumente të shkruara. Ajo mund të shërbejë gjithashtu edhe si një mbështetje e pakontestueshme për dokumentet e shkruara që mund të japin vetëm fragmente nga e kaluara historike dhe që në pamje të parë japin përshtypjen se këto fragmente janë thjesht aksidentale dhe jo të rëndësishme apo gjurmëlënëse në historinë dhe kulturën e një komuniteti të caktuar njerëzor.

Kemi prekur në shkrime të tjera faktin që autoriteti papnor ka luajtur një rol jo të vogël në territoret etnike shqiptare gjatë mesjetës, autoriteti që që paraqitet shpesh në burimet e shkruara dokumentare që kryesisht gjenden në Arkivin Sekret të Vatikanit, por edhe gjetë. Megjithatë, ky autoritet papnor mund të dëshmojë edhe me anë të gurrës popullore, siç do të paraqesim në këtë shkrim duke analizuar disa fjalë të leksikut shqiptar që çuditërisht nuk janë me rëndësi shqiptare dhe nuk gjenden as në leksikun grek apo sllav. Këto fjalë pra nuk janë të huazuara, por janë të krijuara në truallin shqiptar si refleksim i fenomeneve të caktuara historike. Janë fenomenet historike ato që kanë diktuar edhe kuptimin e këtyre fjalëve, pavarësisht se me kalimin e kohës këto kuptime kanë devijuar paksa nga origjinali i tyre. Në këtë shkrim nuk do të merremi me fjalë paralele të ngjashme si bajloz, katallan etj. që përkatësisht vijnë nga bailus dhe catallan dhe janë pasqyrim i pushtimeve të ndryshme të territoreve shqiptare, por konkretisht me fjalët që dëshmojnë për autoritetin papnor dhe për rrënjët e katolicizmit në këto territore dhe konkretisht me fjalët lugat e lëngatë.

Lugati, sipas besëtytnive popullore është një fantazmë që tri kryesisht mbi varret [R. Elsie, Leksiku i Kulturës Popullore Shqiptare, 2005, f. 125-126]. Shfaqja e tij, po sipas besëtytnive, shoqërohet puthasjë gjithmonë me një flakë mbi varnën ose me rrallë edhe ditën. Sytë të vdekurit duhen mbyllur se ndryshe i vdekurit bëhet lugat - kështillojllë pleqët. Duket pak a shumë si një histori me vampirë, kaq shumë si të reklamuar në të përhapura kohët e fundit në kinematografi.

Fjala lugat është një fjalë që nuk ekziston në gjuhët e vendeve fqinje, si p.sh., as të sllavëve dhe as të grekëve. Është një fjalë që gjithmonë e më tepër në zhdukje gjendet vetëm në gjuhën shqipe. Por, si ka hyrë termi lugat në gurrën popullore shqiptare? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje duhet të hedhim sytë në mesjetën e popullit shqiptar dhe konkretisht në gjysmën e dytë të shekullit të katërmëdhjetë, kur në territoret shqiptare po vepronin legatët papnorë.

Prof. Dr. Bardhyl Demiraj na ka ndihmuar që të bëjmë lidhjen fonetiko-etimologjike të fjalëve lugat e legat, dhe arsyetimi është si vijon:

Sipas rregullave etimologjike të gjuhës shqipe, zanorja [e] e patheksuar dobësohet në [i], sidomos kur kjo ndodhet në rrokje nistore. Duke qenë se [g] është bashkëtingëllore velare, zanorja [e] e formuar para saj velarizohet dhe jep zanore [u]. Me fjalë të tjera format latine legatus, legati, legato, ku zanorja e parë është e patheksuar fillimisht duhet të jetë marrë në shqipe si legat, por që [e] shpejt është velarizuar në [u] duke na dhënë fjalën lugat.

Duhet pasur parasysh që fjalë lugat, ashtu si fjalë shkallë, shkiet (për serbët), është me shumë e përhapur në ato zona që kanë qenë në kontakt me të shpeshtë apo të drejtpërdrejtë me serbët, siç ishin zonat verilindore.

Dihet tashmë që në mesin e shekullit të katërmëdhjetë, mbretëria serbe kishte pushtuar shumë territore shqiptare. Lufta kishte edhe karakter fetar, duke qenë se serbët ishin të rritit lindor, d.m.th., ortodoks dhe shqiptarët, sidomos shqiptarët me të cilët serbët ishin në kontakt të drejtpërdrejtë, ishin të rritit perëndimor, katolik.

Në një situatë të tillë, papati, i cili në shekullin e katërmëdhjetë nuk ishte i interesuar më që të ndërhynte me dhunë mbi skizmatikët, kryesisht për shkak të daljes në skenë të turqve që ishin bërë një kërcënim serioz ushtarak, ila mënjane kryeqëzatat dhe zgjedhjet rugën e diplomacisë. Me anë të mjetëve diplomatike që kishte në dispozicion, Selia e Shenjtë dëshironte jo vetëm të mbështeste shqiptarët/katolikët në konfliktet e tyre me serbët, por mundësisht edhe të fitonte serbët për fenë katolike, gjë për të cilën serbët i kishin premtuar disa herë papatit. Me aktivitet diplomatik të papatit merreshin legatët.

Legatët papnorë, përcues dhe zbatues të autoritetit papnor në shkallë lokale

Që prej shek. XI, për interesat e tyre jashtë Romës, papët dërgonin me mision legatët. Legati ishte më i lartë se ipeshkvi lokal dhe ishte i parë në sinodet vendore, gjatë kohës ipeshkvi, bënte vizita kontroluese dhe kujdeset për reformat kishare, duke ndihmuar kështu shumë për zbatimin në shkallë lokale të rregullave të vendosura nga papati. Ai përfaqësonte papatin edhe kur përkahte një aktivitet diplomatik (njohja e zgjedhjeve mbretërore, traktateve të paqes etj.). Megjithëse një ndër detyrat më të rëndësishme të legatëve ishte përgatitja dhe udhëheqja e kryqëzatave, herë-herë, gjatë skizmave ata bënin propagandë për këtë apo atë papë, nisur nga kush ishin dërguar. Si legatë dërgoheshin jo vetëm ipeshkëvë, ose kapelanë të papës, por edhe kardinalë. Këta të fundit quheshin "legati a latere" (d.m.th. të dërguar "nga ana e" papës), ndërkohë që të tjerët që ishin më poshtë në rang, quheshin "legati missi".

Pushteti i legatëve papnorë ishte i gjerë. Duke përfshirë në të gjithë autoritetet kishare, legatët përqendruan autoritetet të konsiderueshme në duart e

Fjala lugat është një fjalë që nuk ekziston në gjuhët e vendeve fqinje, si p.sh., as të sllavëve dhe as të grekëve. Është një fjalë që gjithmonë e më tepër në zhdukje gjendet vetëm në gjuhën shqipe. Por, si ka hyrë termi lugat në gurrën popullore shqiptare?



Edhe në territoret e Shqipërisë kemi pasur shpesh legatë papnorë, duke filluar që nga kohërat më të hershme. Kur serbët filluan të ishin shumë të dhunshëm ndaj shqiptarëve katolikë, papati ndërhyri në mënyrë të veçantë për të ndryshuar situatën, duke dërguar grupe legatësh. Në 1351, Papa Klement VI, dërgoi si legatë për trojet etnike shqiptare, Antonin, kryepeshkvin e Durrësit, Helian kryepeshkvin e Ragusës dhe Bartolomeut, ipeshkvin e Trogirit.

tyre. Cdo legat konsiderohej në shumë aspekte si papë lokal, prandaj aktivitetet ceremoniale dhe administrative për mirëpritjen e tyre, veçanërisht të legatëve a latere, ishin të njëjta sikur të ishin për Papën vetë. Për shkak të pushtetit që gëzonin, princërit dhe mbretërit gëzoreshin që t'i mikpritnin ata dhe përgatiteshin në mënyrë ceremoniale për këtë gjë. Në rast se ata kundërshtoheshin në ndonjë mënyrë, dënimi ishte shkikshërim i menjëhershëm i fajtortit.

Deri në shek. XIV, legatët ishin agjentët kryesorë për realizimin e objektivave papnore politike dhe shpirtërore në lokalitete të caktuara përkatësisht në territoret për të cilat ata ishin të pajisur me autoritet apostolik. Hapësira e aktivitetit të legatit ndryshonte shumë, varësisht nga qëllimet individuale të secilit mision. Shumë legatë ishin përfshirë në aktivitetet politike, sidomos ata në Angli. Pasi filluan lëvizjet e kryqëzatave, legatët papnorë u përfshinë në mënyrë intime me udhëheqjen dhe drejtimin e këtyre aktivitetëve, gjithmonë si mëkëmbës të Papës. Kështu p.sh., Adhemar of Monteil, ipeshkvi i Le Puy (1098) ishte emëruar legat në kryqëzatën e parë nga koncili i Clermontit në vitin 1095 shumë kohë para se të fillonte fushata kryqtare. Aktivitetet të tilla vazhduan edhe më vonë, si në kryqëzatat për në Tokën e Shenjtë, ashtu edhe në ato që u zhvilluan sidomos në shekullin e trembëdhjetë dhe në shekullin e katërmëdhjetë kundër heretikëve Albigenianë në Francën e Jugut dhe në Itali. Pozita e legatëve papnorë natyrisht që nuk qëndronte statike. Në shek. XIV dhe XV, kategoria e ashtuquajtur legat missi u zhduk për arsye të paqarta dhe roli i tyre u mor përsipër nga nuncios, pushteti i të cilëve u rrit në mënyrë korresponduese.

Edhe në territoret e Shqipërisë kemi pasur shpesh legatë papnorë, duke filluar që nga kohërat më të hershme. Kur serbët filluan të ishin shumë të dhunshëm ndaj shqiptarëve katolikë, papati ndërhyri në mënyrë të veçantë për të ndryshuar situatën, duke dërguar grupe legatësh. Në vitin 1351, Papa Klement VI, dërgoi si legatë për trojet etnike shqiptare, Antonin, kryepeshkvin e Durrësit, Helian kryepeshkvin e Ragusës dhe Bartolomeut, ipeshkvin e Trogirit.

Nuk kemi të dhëna për ndonjë sukses të këtyre legatëve dhe me siguri për këtë shkak në grupin e dytë të legatëve të dërguar në vitet 1353-1354, në këto territore, ad Serviae, Rassiae et Albaniae regna et terras praefatis regis subiectas, bënë pjesë njëri ndër personalitetet më të fuqishme të gjysmës së dytë të shekullit të katërmëdhjetë, Petrus Thomas (ASV, Reg. Vat.




227, ff. 4r-5v, ep. 10-15) i cili pas vdekjes do të shpallej edhe shenjtor, por shkak të veprave të tij.

Petrus Thomas ishte një ndër ata burra të shekullit të 14-të, i cili me personalitetin dhe me influencën e tij dominuese, kontribui jashtëzakonisht shumë në propagandimin e kryqëzatave të shekullit të 14-të, kryqëzata këto të organizuara kundër skizmatikëve sllavë, kundër heretikëve dhe kundër turqve pushtues.

I lindur në një familje të varfër në fshatin Salagnac de Thomas, në luginën e Dordogne në jugperëndim të Francës, nga fundi i shekullit XIII, i mbaroi studimet duke jetuar me lëmoshë, por me gjeninë e tij e impresionoi kaq shumë priorin e konventit të Sainte-Marie-du-Carmel, sa që u pranua menjëherë në vëllazërinë e Ur-dhrit Karmelitan. Murgjit ia shpërblyen zellin për të mësuar duke e dërguar së pari në Bordeaux për një vit dhe pastaj në Paris. Pas kësaj, ai u emërua për të dhënë leksione në Cahors, kur filloi të krijonte një reputacion shumë të mirë për elokucien, aftësi dhe mëshirë. Në Paris u kthye për t'u graduar në teologji dhe njohja me kardinalin e Perigord-it jo vetëm që e shpëtoi nga problemet financiare për studimin, por në sajë të ndihmës së tij financiare mundi të vazhdojë thellimin e studimeve të tij edhe më tej dhe të merrte titullin doktor in sacra pagina. Fama dhe popullariteti i tij u përhap me një shpejtësi të rrufeshme. Njerëzit ishin kaq të prekur nga predikimet e tij, sa që një predikim shpërbëhej me dhuratat materiale deri në 1000 florinta ar në konventin e Avignonit. [Vita, 612-13; Jorga 134.]

Papët dhe prelatët e kuptuan menjëherë që Peter Thomas ishte një instrument shumë premtes për politikën e jashtme të Kurisë Papnore. Papa Klementi VI (1342-1352) e ngriti atë në postin e ipeshkvi të Badajozit në Spanjë, e Papa Inocentius VI (1352-1362) e dërgoi Pjetrin me mision shumë të rëndësishme dhe shumë delikate në oborrin e Mbretit Ludvik të



Harta politike e Evropës në vitet 1300

Pulias, në oborin e mbretërshës Xhoana, të perandorit skizmatik të Serbisë dhe në oborin e perandorit Karl IV, duke e emëruar ndërkohe ipeshkëv të Patit dhe të Liparit në Sicili. Udhëtoi nëpër të gjitha këto vende, madje edhe në Tokën e Shenjtë dhe këto udhëtime të mbushura plot me rrezikje për jetën e tij ja rritën jashtëzakonisht reputacionin, kur në vitin 1360 u kthye pa pësuar asnjë. Për shkak të kura- së së madhe, Papa Inocent e emëroi në fillim ipeshkëv të Koronës në More (1359), pastaj kryeipeshkëv të Kretës (1361) dhe së fundi i dha postin më të rëndësishëm dhe më të rezikshëm të mundshëm atë të patriarkut latin të Kostandinopojës në vitin 1362.

Për shkak të përvojës dhe oratorisë, Papa Inocent VI i besoi misionin e vështirë dhe delikat të konvertimit të grekëve në katolicizëm. Perandori bizantin i asaj kohe, Jan V Paleologu (1341-1391) ishte nën presionin e turqve nga të gjitha anët dhe për këtë shkak ishte i gatshëm që t'i nënshtrohej autoritetit të Romës me shpresën që të merrte ndihmë. Nën ndikimin e Peter Thomasit, perandori ishte pothuajse gati që të shkakonte të gjithë patriarkët armiq dhe skizmatikë dhe në vend të tyre të emëronte ipeshkëv katolikë, por ky mision i tij dështoi. Megjithatë, fama e Peter Thomasit ishte përhapur shumë. Papa Inocent VI e ngriti atë akoma më lart në përgjegjësi trefishe: të predikonte dhe të propagandonte kryqëzatën kundër të pabesëve, të konvertonte skizmatikët në fenë katolike dhe të zhdukte herezisë nga Kreta. Kështu, Peter Thomasi vajti në Kretë dhe Qipro për të konvertuar atje grekët në katolikë.

Në Kretë, lufta e Peter Thomasit kundër herezisë shkaktoi shumë viktima, madje edhe nga radhët e fshikëve dhe të aërme të familjes mbretërore. (Aziz Suryal Atiya, The Crusade in the Later Middle Ages. London: Methuen and Co.

LTD, 1938, f. 133.) Ata, që nuk dëshironin të konvertoheshin në ritin latin nga legatit, kërcënoheshin me turren e druve dhe faktikisht një person u dogi i gjallë, gjë që shkaktoi shumë panik. Joachim Smet, The life of Saint Peter Thomas by Philippe de Mézières. (Rome, Institutum Carmelitatum, 1954), 212) Në Qipro, legatit u përpoq në të njëjtën mënyrë që të bindë autoritetet civile që të torturonin banorët ortodoksë derisa ata të konvertoheshin në katolikë, por mbretëri i Qipros, pasi shpigoji që banorët ortodoksë ishin më të shumtë në numër se katolikët, nuk e pranoi metodën brutale të Pjetër Thomasit. Ky episod ndodhi në dhjetor të vitit 1359. (Vita 620. Mas Latre, Histoire de Chypre, II, 253, 281; Smet, f. 209) Në vitet 1359-1362, Kronisti grek, Leontios Machairas, tregon për një grindjetë të tij me grekët e Qipros, ku thotë

KONVERTIMI

Konotacioni negativ i fjalës legat-lugat është rritur me siguri me konvertimin e shqiptarëve në islamizëm, të cilin legatit Peter Thomas e kishte konsideruar si një ndër armiqte kryesorë. Në kryqëzatën kundër myslimanëve, ai përdori të gjitha aftësitë e tij diplomatike dhe elokucenë e tij të njohur, për të frymëzuar entuziazëm për luftën e shenjtë

KONTAKTI

Duhet pasur parasysh që fjala lugat, ashtu si fjala shkau, shkiet (për serbët), është më shumë e përhapur në ato zona që kanë qenë në kontakt më të shpeshtë apo të drejtpërdrejtë me serbët, siç ishin zonat verilindore.



Pikturë mesjetare që paraqet figura të mitologjisë sllave

[maj 1359, ASV, Reg. Avin. 140, f. 54r-55r; Reg. Vat. 234, f. 2r-2v; Wadding, Vita, 144-150.] Deri në vdekjen e tij, Peter Thomasi mbeti njeriu i zgjedhur i papatit për të promovuar shumicën e kryqëzatatave të asaj kohe. Vdiq nga një sëmundje më 6 janar të vitit 1366.

Duhet të ketë qenë fundi i shekullit XIV, kur fjala legat - nga popullsia vendase e receptuar si lugat - është prezantuar për herë të parë në territoret shqiptare dhe sidomos shekullit XV e më vonë kur ajo është përhapur gjerësisht në këto territore. Kuptimin e saj negativ duhet ta ketë marrë jo vetëm sepse reputacioni i shenjtoreve përhapje me shpejtësi të rrufeshme, por edhe sepse Peter Thomasi, i cili në vitet 1353-1354 ishte dërguar si legat (përfqësues, ambasador) papnor në këto territore, duhet të ketë luftuar me shumë brutalizëm herezisë dhe shtrembërimet dogmatike të rritit katolik, gjë që duhet të ketë bërë një përshpikje shumë të madhe të popullsisë vendase tolerante ndaj formave të ndryshme të besimeve. Riti katolik në këto territore shtrembërohej jo vetëm nga përzierja me ritin bizantin-grek, dhe nga përzierja me ritin bizantin-sllav, por edhe nga format pagane të besimit, e kryesisht nga përzierja me herezitë e ndryshme ku kryesonte bogomilizmi. Toleranca e njohur e shqiptarëve në çështjet shpirtërore, gjithmonë u ka bërë vend edhe të dëbuarve nga vendet e tyre për shkak të besimit të tyre, qoftë ky edhe "i gabuar" siç konsiderohej ai zyrtarisht nga kisha katolike,

kështu që lufta e Peter Thomasit duhet të ketë qenë shumë e ashpër ndaj një pjese të madhe të popullsisë. Konotacioni negativ i fjalës legat-lugat është rritur me siguri me konvertimin e shqiptarëve në islamizëm, të cilin legatit Peter Thomas e kishte konsideruar si një ndër armiqte kryesorë. Në kryqëzatën kundër myslimanëve, ai përdori të gjitha aftësitë e tij diplomatike dhe elokucenë e tij të njohur, për të frymëzuar entuziazëm për luftën e shenjtë.

Pas vdekjes ai u njoh menjëherë si shenjtor në Qipro dhe u nderua madje edhe nga armiqte grekë që e urrenin atë për sa kohë që ishte gjallë. Tradita filloi që t'i njihje mrekulli që ndodhin në varri të tij dhe në ishull ai u mbajti mend për shumë kohë si nga katolikët, skizmatikët, judenjtë dhe saracenët, dhe jo dhe atë për të kështu që ishte shkaktuar, sa për përplekjet e tij të patrembura për të shëruar ata që ishin sëmure nga murtaja e zezë. [Vita, 622-3; Hackett, 133; Jorga, 128-9; Atiya, p. 136.] Reputacioni për aftësi të tilla shëruese të legatit papnor Peter Thomas ishte i njohur edhe ndër shqiptarë, kështu që lidhja e legatit shenjtor me konceptin e lëngatës, mund të bëhet në bazë të mrekullive që i atribuohen atij si gjatë jetës së tij ashtu edhe pas vdekjes. Shenjtori Peter Thomas ishte i njohur nga besimtarët e tij veçanërisht për shërimin e etheve, aktivitet ky të cilin me siguri ai e kishte zhvilluar gjatë murtajës, ose vdekjes së zezë, që në shekullin e XIV-të shfaqosi një të tretën e popullsisë së Evropës dhe sigurisht që nuk kurseu as shqiptarët. Pas vdekjes së Shën Peter Thomasit, u konstatua që një numër i madh i mrekullive të tij ishte pikërisht në fushën e shërimit nga ethet.

Nëse fjala lugat është më shumë e përhapur në ato zona që kanë qenë në kontakt më të shpeshtë apo më të drejtpërdrejtë me serbët, siç ishin zonat verilindore, fjala lëngatë (lëngatë nga legat) është më e përhapur në zonën jugore të Shqipërisë. Kjo me siguri vjen nga fakti që zonat e ulëta të Shqipërisë ishin më të prekura nga murtaja e zezë, sesa zonat malore dhe në kërkim të rrugëve e të shpresave për shpëtim kultit i Peter Thomasit si shenjtor shërues nga kjo sëmundje që shoqërohej me ethe të forta është përhapur me një shpejtësi shumë më të madhe sesa reputacioni i tij si armik i herezive, pra si lugat.

Sigurisht që imagjinata popullore ka bërë që fjalët lugat e lëngatë në kuptimin e tyre të mos i qëndrojnë më besnike strikte të vërtetës historike, por sidoqoftë, thelbi i tyre mbetet përsëri i lidhur me aktivitetin dhe me reputacionin e fenomenit historik, legatit Peter Thomas.



politikë & analizë

Transplantimi i mitit të betejës së Fushë-Kosovës akoma nuk shkulet nga kokat e politikanëve serbë. Por kur statusi të zgjidhet, a do të kërkojë Serbia lidhje më të ngushta me Rusinë, si një ngushëllim për humbjen e Kosovës?



Beteja e Fushë-Kosovës, qershor 1389, pikturë në vaj

MITI I FUSHË-KOSOVËS

Miti i Fushë-Kosovës është përdorur shpesh me sukses për të ndikuar në politikën e brendshme dhe të jashtme serbe. Së fundmi kjo ndodhi në tetor të vitit të shkuar, kur Kryeministri serb Kostunica e cilësoi Kosovën si shkak për të sjellë në podiumin e parlamentit serb draftin për kush-tetutën e re serbe

JUDA I SERBIË

Asnjë serb, në asnjë rast, nuk i jep mundësinë një kundërshtari të vet ta diskreditojë atë duke e cilësuar si Branković (domethënë si një "Jude"). E veç një të riu dhe disa dishepujve të reformatit të vrarë Zoran Gjinjiç, asnjë politikan i njohur në Beograd nuk ka arritur të shkëputet publikisht nga konsensusi fatal se Serbia nuk duhet ta lëshojë kurrë Kosovën

Miti serb i Kosovës dhe çështja e statusit

NGA MICHAEL MARTENS*

Politika serbe ndaj Kosovës rreh tashmë në tri drejtime bazë: në episin e ngritur, sigurisht, jo theksit dhe vetëm nga Millosheviçi, i cili lidhet me një përplasje të armatosur me origjinë nga Mesjeta; bindja se i referohen të drejtës së popujve për mbrojtjen e tërësisë territoriale, si dhe përpjekjes jo gjithmonë të suksesshme për të ndjekur një "real-politikë", ku cmohet dhe fitohetja e mundësitë që të jep momentin.

Mund të duket më fundamentale që të merremi me kapërcimin e menduar në histori të konfliktit të Kosovës. Ajo që ndodhi në një ditë qershori të vitit 1389 në Fushë-Kosovë është për vlerësimin e situatës së sotme jo lehtësisht e shmangshme. Dhe aspak për t'u neglizhuar e për t'u zhvendosur në plan të dytë është edhe ajo që ndodhi pas betejës së serbëve nën udhëheqjen e princit të tyre Lllazar, kundër trupave të Sulltan Muratit I.

Në shekujt pasardhës, miti i Fushë-Kosovës është përdorur shpesh me sukses, për të ndikuar në politikën e brendshme dhe të jashtme serbe. Së fundmi kjo ndodhi në tetor të vitit të shkuar, kur Kryeministri serb Kostunica e cilësoi Kosovën si shkak për të sjellë në podiumin e parlamentit serb draftin për kush-tetutën e re serbe.

Se sa praktik është ky "mit i Kosovës", këtë e pati pranuar në mënyrë indirekte edhe Millosheviçi kur pohonte se për të ishte më se e vështirë të bënte dallimin mes legjendës e historisë mbi këtë betejë. Atij i erdhi në ndihmë tradita gojore mbi humbjen serbe gjashtë shekuj më parë, për ta përdorur gjashtë shekuj më pas si një instrument për të fshirë kohërat. Një e shkuar mitike u transplantua në të tashmen dhe u bë politikë e ditës. Beteja kundër turqve nuk ishte më një zhurmë nga kohët e mëdha e të

errëta. Kosova ishte "e djeshmja".

Kjo u tregua edhe në 1999 në luftën e NATO-s kundër "Jugosllavisë". Në propagandën serbe për luftën e Kosovës, historia paraqitet në formën e simbolikës së përsëritur, ku aleanca perëndimore krahasohej apo personifikohej në paralelet historike me rolin që kishin luajtur osmanët.

Korniza e gatshme legjendare përshtatej plotësisht për këtë arsye me synimet politike, pasi njëri ndër elementet e saj kryesorë është dhe historia me tradhtarët, domethënë me "Judein serb" Vuk Branković, që mban kësaj edhe damkën e fajit për "varrosjen e serbëve", ngaqë ai e la në baltë në momentin e fundit princin Lllazar.

Asnjë serb, në asnjë rast, nuk i jep mundësinë një kundërshtari të vet ta diskreditojë atë duke e cilësuar si Branković (domethënë si një "Jude"). E veç një të riu dhe disa dishepujve të reformatit të vrarë Zoran Gjinjiç, asnjë politikan i njohur në Beograd nuk ka arritur të shkëputet publikisht nga konsensusi fatal se Serbia nuk duhet ta lëshojë kurrë Kosovën.

Ngaqë as Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe as i dërguari i posaçëm i OKB-së për çështjen e statusit, Ahtisaari, nuk i kanë vënë në themel të punës së tyre ndikimet e kasaphanave mesjetare, Serbia i drejtohet kësaj aspektit të saj të dytë në paraqitjen e problemit të saj në botë: atë të së drejtës ndërkombëtare të popujve për të mbrojtur territor-

in e tyre.

Ka disa argumente në anën e vet, pasi në vetvete, Kombet e Bashkuara si një bashkim i vendeve sovranë, udhëhiqen nga parimi për të mos mbështetur lëvizjet separatiste. Gjithnjë e më shumë qeveria në Beograd paralajmëron se nga Kosova do të krijim një precedent negativ, që nëse ndodh do të bënte që Serbia të linte jashtë saj një të pestën e territorit të vet. Sidomos Kombet e Bashkuara pretendojnë si përgjigje shpesh se në rastin e Kosovës bëhet fjalë për një rast të veçantë, që nuk do të shërbejë si precedent për raste të tjera në botë. Por, me gjithë ndryshimet në detaj: faktikisht nuk është rasti i Kosovës "sui generis", por pretendimi se ai është i tillë.


Çeqenët, kurdët, uigurët dhe pakicët e tjera në shumë vende të botës, mund të pretendojnë ashtu sikurse dhe shqiptarët e Kosovës, se një qëndrim në shtetë e tyre aktuale, duke u nisur nga eksperiencat e së shkuarës nuk mund të jetë më i pranueshëm.

Ata, në kundërshtim me shqiptarët e Kosovës, mund ta bëjnë këtë me mjete të arsyeshme, pasi irritimi i tyre e ka bazën tek e shkuara, se Serbia sot është, me gjithë mangësitë e problematik, një shtet demokratik.

Shtylla e tretë e politikës serbe nuk bazohet as në të drejtën e as në fuqinë e së shkuarës. Fondamentet e saj këtë radhë janë më solide: Beogradi kalkulon me pushtetin e së tashmes dhe beson e

përpiqet shumë që të përfitojë nga një veto ruse kundër një plani për pavarësinë e Kosovës. Por duket e mundshme që Rusia ta lidhë Serbinë me shumë pas vete, nëse pavarësia e Kosovës nuk pengohet, duke toleruar edhe në mënyrë të heshtur e të fshehtë disi ndarjen e saj me ndihmën e Perëndimit – çka ajo tek e fundit edhe do të ndodhë. Nën Presidentin Putin, që u injektoi bashkadhëtarëve të vet sërish besimin e humbur gjatë viteve nëntëdhjetë për shtetin, duke e përqendruar atë mjet me doza të forta, Rusia po përpiqet në të njëjtën kohë të fitojë sërish ndikimin e humbur rus në Ballkan. Ashtu sikurse edhe në vende të tjera të botës, politikët energjetikë janë për këtë synim edhe mjet më i përshtatshëm. Nga synimet më primare të Rusisë në Ballkan, renditet ndërtimi i një naftësjeleje nga Porti bulgar i Burgasit në Det të Zi, deri në Alexandroupolis, në brigjet e Egjeut. Por për sa i përket Bullgarisë, ish-vasalit më të sigurt të Rusisë në rajon, pas anëtarësimit të saj në BE nuk mund të pritet shumë e nuk mund të kihet besim, megjithëse lidhjet e vjetra ruso-bullgare, si në sferën e bashkëpunimit ushtarak, ashtu dhe në atë të shërbimeve të fshehta, akoma kanë mbetur më këmbë. Rruga e Serbisë në BE duket, përkundrazi, për momentin për një kohë të papërcaktuar e paqartë. Një Serbi e armiqësuar me Perëndimin do të bënte të kërkohejshin rrugë të tjera lidhesh me të ngushta me Rusinë, të cilat po i kërkon në Hagë prej kohësh edhe i dyshuari për krime lufte, lideri i radikalëve serbë, Vojislav Sheshelj. Paralelizmi do të viente gjithsesi vetëm nëse pas pavarësisë së Kosovës jeta e brendshme politike serbe do të radikalizohej. Kjo edhe mund të ndodhte sipas të gjitha gjasave. Por në plan afatmesëm mund të pritet e kundërta.

*Marrë nga "Frankfurter Allgemeine Zeitung"



SERBIA DHE PERENDIMI

Një Serbi e armiqësuar me Perëndimin, do të bënte të kërkohejshin rrugë të tjera lidhesh me të ngushta me Rusinë, të cilat po i kërkon në Hagë prej kohësh edhe i dyshuari për krime lufte, lideri i radikalëve serbë Vojislav Sheshelj. Paralelizmi do të viente gjithsesi, vetëm nëse pas pavarësisë së Kosovës jeta e brendshme politike serbe do të radikalizohej. Kjo edhe mund të ndodhte sipas të gjitha gjasave, por në plan afatmesëm mund të pritet e kundërta



SHTYLLA E TRETË

Shtylla e tretë e politikës serbe nuk bazohet as në të drejtën e as në fuqinë e së shkuarës. Fondamentet e saj këtë radhë janë më solide: Beogradi kalkulon me pushtetin e së tashmes dhe beson e përpiqet shumë që të përfitojë nga një veto ruse kundër një plani për pavarësinë e Kosovës. Por duket e mundshme që Rusia ta lidhë Serbinë me shumë pas vete, nëse pavarësia e Kosovës nuk pengohet, duke toleruar edhe në mënyrë të heshtur e të fshehtë disi ndarjen e saj me ndihmën e Perëndimit – çka ajo tek e fundit edhe do të ndodhë

Kërkoj shpirtin binjak, dashuritë online s'kanë moshë



Bum për përdoruesit e "rritur", të cilët "gjuajnë" shokët e jetës në internet. Rriten sajtet që ofrojnë shërbime "ad-hoc" dhe kanë një numër të madh përdoruesish

UASHINGTON - "RFortune3", marinari zeshkan dhe me sylajthi kërkon një shoqe me të cilën të mund të kalojë jetën. Ka një rrogë 50000 deri në 75000 dollarë në vit, nga pikëpamjet politike është me të djathtë dhe preferon femrat që merren me vrap. Është 62 vjeç dhe nuk kërkon vajza të vogla: shpirtin e tij binjak e dëshiron rreth moshës 45 deri në 55 vjeç. Ndërsa "Clayperry27", është budist, një romantik i stilit të vjetër, ku dëshiron të shijojë gjithmonë darka nën dritat e qirinjve.

Është pothuajse rreth të 54-ave, për femrën e tij ideale nuk ka shumë preferenca race, krahine apo besimi, por pika e tij e dobët janë flokët e gjata. Moshë e preferuar: edhe poshtë të 40-ave.

Mirëserdhet në universin e ri të dashurisë online. Çfarë surprize, nuk është më panorama ekskluzive e adoleshentëve, studentëve apo profesionistëve të rinj, por i është hapur një publiku të pjekur. I pari që e kuptoi ishte giganti "Match.com", sajti amerikan i takimeve virtuale, që siç referon "Wall Street Journal" në një kërkim të gjatë, që kur është fiksuar në këtë pamje të re të tregut - nga "babyboomer" dhe lart, ato deri të 40-ait, për t'u kuptuar - ka pasur një impenjim vizitash të paparashikuara dhe disa fitime të vogla.

Për dashuri nuk është asnjëherë vonë dhe pasja e saj si intuitë e ka bërë sajtin të pasur. I cili shumë shpejt është bërë numri një në Shtetet e Bashkuara të Amerikës mes shërbimeve online, të cilat funksionojnë mbi abonimet, me një milion e treqind mijë përdorues të regjistruar. Për t'u klasifikuar nga rivalët si "Yahoo! Personals", "True" ose "Singlesnet", "Match" ka bërë fushatë publicitare të specifikuar për beqarët jo shumë të rinj, të divorcuar, banues në zonat periferike, të cilët janë në kërkim të një historie të vërtetë. Përdoruesit e këtij sajti nuk janë me doemos ekspertë e internetit, por ato besnikë, të cilët regjistrohen pa shumë vështirësi dhe janë të gatshëm të paguajnë abonime për periudha të gjata kohore në krahasim me adoleshentët.

Për të tërhequr këtë pjesë të re dhe të rëndësishme të tregut, e cila ka shumë para për të shpenzuar dhe shumë kurozitet, Barry Diller, pronari i këtij shërbimi, i është futur punës: në radhë të parë duke ofruar shërbime "hoc", një hundrim të thjeshtëzuar dhe një sërë rrugësh dalëse të lehta nga situata, të cilat mund të perceptohen si situata të vështira: një buton i thjeshtë "Jo faleminderit", lejon rikthimin e pretendentëve të padëshiruar, pa qenë e nevojshme të identifikohet personi.

Kjo metodë ka funksionuar. Në dy vitet e fundit, shërbimi ka vënë re që numri i përdoruesve është rritur dhe pagesa 3-fish më shumë. Dhe 23% e përdoruesve janë mbi moshën 50-vjeçare, shifra 2-fish më të larta në krahasim me vitin 2005.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të kërkuar dashurinë në internet tashmë është një tendencë e konsoliduar: një hetim "Pew relativa" në vitin 2005 ka treguar që 15% e amerikanëve të maturuar, pra 30 milionë persona, njohin dikë që e ka njohur shokun e jetës nëpërmjet internetit. Dhe 30%, më shumë se 60 milionë, thonë që e kanë provuar të kërkojnë shpirtin binjak nëpërmjet internetit. Gjëja e fundit që do të ndodhë është vetëm tabuja e moshës dhe beqarët, nga flokët gri në internet fillojnë të luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm.

Mbi "Match" për 35 dollarë në muaj - që sipas drejtuesve nëse bëhet një abonim gjashtëmujor - mund të konsultohen profilet e përdoruesve të regjistruar, me foto, zakone, shije, niveli i përdorimit dhe shumë informacione të tjera personale. Bëhen kërkime specifike mbi bazën e dëshirave dhe kontaktohen kandidatët e përzgjedhur, duke zgjedhur ndoshta avokatë të pjekur, profesorë, të cilët kanë dalë në pension, ish-modele të viteve "50" ku trupi ka filluar të shkrihet, po motori është në gjendje të mirë.

E gjitha kjo është në një ambient të rehatshëm, ku në ndihmë të vijnë këshillat e një psikologu të mirë, se çfarë mund të presësh nga një histori që të mund të funksionojë.

Në garën për të fituar klikimet e çmuara të jo më të rinjve, "Match" nuk është vetëm. Aktiviteti rritet me shumë shpejtësi, edhe pse deri tani "Match" duket se ka përpitë modelin fitues, të paktën në shtëpi. Në Perëndim, ku shërbimi është gati për të shpërthyer, duhet t'i bëjë llogaritë ndër të tjera me Francën, ku ajo ka zaptuar 80% të merkatos. Por me një emër totalisht të ndryshëm: Iri, i paparagjykuar, seksi dhe më shumë në kërkim të një takimi me zjarrin dhe jo me historinë e një jete.



KINEMA



Në festivalin e Berlinit dhe në kinematë evropiane, që nga 16 shkurti, filmi "Letra nga Iwo Jima" ku regjisori Eastwood tregon për armiqët e vitit 1945



FILMI
"Letra nga Iwo Jima" e Clint Eastwood është kandidat për çmimet "Oskar"

Ora e mëshirës për japonezët e mundur

Nuk mendoj se është e nevojshme të kesh parë filmin "Flamujt e etërve tanë" për t'u pasionuar dhe zhytur akoma më shumë në perfekcionin e binjakut të kundërt të tij "Letra nga Iwo Jima". Por nuk kishte se si të ndodhte ndryshe. Regjisori i të dyve është një nga gjigantët e kinemasë, Clint Eastwood. Edhe pse është 76 vjeç, duket se moshë nuk ka ndërmend ta ndalë nëse ai vendos të marrë përsipër për të bërë diçka të bukur. Kështu, të dy filmat "Flamujt e etërve tanë" dhe "Letra nga Iwo Jima" tregojnë të njëjtin episod ndoshta atë më të përgjakshin dhe më të dhimbshmin e ndërhyrjes amerikane në Paqësor në fund të Luftës së Dytë Botërore; marrjen e Iwo Jima, një ishull rreth 65-70 mijë nga Tokio, një pikë strategjike për t'i dhënë goditjen përfundimtare perandorisë aziatike. "Flamujt e etërve tanë" është tragjedia e mitizuar nga fituesit amerikanë, ndërsa "Letra nga Iwo Jima" është i njëjti subjekt i treguar nga japonezët e mundur. Për këtë arsye, regjisori Clint Eastwood dhe skenaristi Paul Haggis u frymëzuan nga një libër japonez, ku përshkruhet me hollësi mbledhja e letrave dhe sendeve të tjera që ushtarët u dërgonin grave dhe fëmijëve nga ishulli i famshëm dhe plot hollësi e detaje mbi një nga betejat më të famshme të historisë. Përreth 140 minuta, filmi tregon me njëshpirtëri për ditët e fundit të 21 mijë ushtarëve japonezë, të strehuar në galeritë e errëta, të "goditur" nga dizenteria dhe të mbetur pa ujë, ushqime dhe municione u fshiheshin në prapitë të sulmit armik përmasë detit. Të gjithë janë të ndërgjegjshëm se nuk do të kthehen më në shtëpi, megjithatë vendosin të luftojnë dhe të rezis-

"Flags of our fathers"

FILMI TJETER
Është e njëjta betejë e zhvilluar në Paqësor, e parë me sytë e amerikanëve



tojnë sa më shumë të jetë e mundur për të vdekur me nder, ndoshta edhe duke u vetëvraar, sepse kështu ka "dektuar" zoti perandor. Gjithçka në film vërtet rreth gjeneralit elegant, Kuribayashi (Ken Watanabe), që ka jetuar në Shtetet e Bashkuara, është shkolluar në Kanada e sillel në mënyrë të kulturuar me ushtarët e ndëshkuar padrejtësisht. Kuribayashi e di mirë se lufta është e humbur, por gjithsesi, dëshiron t'i qëndroj besnik vendit të tij. Edhe personazhi tjetër, Baron Nishi, një kalorës shumë i zoti dhe pjesëmarrës në Olimpiadën e vitit 1932 në Los Anxhelos, i bindet disiplinës së pamëshirshme ushtarake. Ushitari i vogël, Saigo, nuk është edhe aq i sigurt se është më mirë të vdesësh për atdheun sesa të njohësh vajzën e vogël të porsalindur. Kur del nga galeria e qelbur për të boshatisur oturakun e përbashkët i shfaqet një vizion i real, magjik: një

numër i madh anijesh amerikane të vendosura me rregull njëra pas tjetrës që përparojnë në mënyrë të heshtur drejt detit, me fatin e vdekjes, drejt ishullit të vogël vulkanik. Ka shumë mënyra për të qenë ose jo heroj në rrethana jonjerëzore dhe amerikanët e mbijetuar në filmin "Flamujt e etërve tanë" edhe japonezët e "Letra nga Iwo Jima" janë heronj. Vërtet mund të quhen të tillë, pasi për nder arrijnë të shpërthejnë një granatë si mite, por nëse situatave plot ankth ndonjëherë edhe të frikshme dhe pa shpresë Clint Eastwood arrin të na bëjë për vete dhe të na prekë dhe kaosin dhe historitë e trishtia individuale në film duke evituar retorikën standarde të filmave me luftë hollivudian duke u vendosur nga ana e armiqve dhe sakrificës së tyre, në shërbim të një çështjeje që spektatorët përëndimorë janë mësuar ta quajnë të

gabuar. Është një moment shumë i "ëmbël" kur një djalos amerikan i plagosur kapet rob dhe gjenerali Kuribayashi urdhëron, mes zemërimit t'ia qetësojë dhimbjet duke i bërë morfinë. Gjenerali "zemërmirë" shkëmben, me djalosin e gjorë, që rënkonte nga dhimbjet, disa fjalë në anglisht, sikur të mos ishin armiq, sikur në atë ishull të mallkuar, kishte ndodhur e kundërta, ishte vendosur paqja. Djaloshi vdes dhe gjenerali vendos të lexojë letërën që shtrëngonte në duar, "biri im, bëj vetëm gjëra të drejta, të presim në shtëpi". Armiqët e tij kanë të njëjtin moshë, më pak se 20 vjeç dhe heshtin përpara këtij komunikimi të dhimbshëm, nëna që i pret dhe nuk do t'i shohë më. Pas javëve të tëra bombardime, amerikanët zbarkuan në Iwo Jima më 19 shkurt të vitit 1945. Thuhet 100 mijë marins dhe ushtarë e kishin për detyrë që ta pushtonin ishullin brenda pesë ditëve për ta bërë bazën ajrore më të afërt me Japoninë. Rezistenca e 21 mijë japonezëve, në të vërtetë zgjati 36 ditë dhe i gjithë ishulli u pushtua në prill. Ish-të ajo rezistencë e kotë dhe e përgjakshme, thonë historianët, që i bindi Shtetet e Bashkuara të Amerikës që t'i jepnin fund gjithë kësaj, duke hedhur bombën atomike në Hiroshimë më 6 gusht. Në Iwo Jima, amerikanët e vdekur ishin thuhet 7 mijë, të plagosurit 20 mijë, ndërsa nga 21 mijë japonezët shpëtuat vetëm 1063. "Letra nga Iwo Jima" po kont me shumë sukses në Japoni se në Amerikë, ku megjithatë, ka fituar "Golden Glob" (si filmi më i mirë i huaj) dhe është kandidat për katër "Oskar" që do të ndahen në 25 shkurt në Los Anxhelos. Mes nominimeve është edhe ajo për filmin dhe regjinë më të mirë.

Përgatiti: Arlinda Balla

Thuhet 100 mijë marins dhe ushtarë e kishin për detyrë që ta pushtonin ishullin brenda pesë ditëve

simboli

Fotoja e flamurit nga Iwo Jima

Ishite 23 shkurti i 1945-ës dhe kishte rreth pesë javë që 30000 marins luftonin kundër ushtarëve japonezë për të marrë Iwo Jima-n, një ishull të Paqësorit. Një betejë e përgjakshme dhe e fortë në të cilën amerikanët kishin lënë në fushë 6900 kufoma (japonezët 20000), por që në atë mëngjes dimri po shkonte drejt fundit, me ushtarët e Mikados tashmë në pikë të fundit dhe marinsat që ishin gati për sulmin final për të marrë malin Suribachi, që ishte në majë të ishullit. Joe Rosenthal nuk ishte një marins: ai thjesht bënte fotografi. Në shkurt të 1945-ës u dërgua në Paqësor nga "Associated Press" së bashku me një trup amerikanësh. Ai mëngjes mbeti i pashpërguar; qarkullonin zëra se Suribachi ishte i sapomarrë dhe se një sërë marinsash kishin rrezikuar jetën e tyre duke vënë flamurin, që ishte shërbente si një mesazh për të kuptuar se lufta tashmë kishte përfunduar. Ishite e vërtetë dhe instinkti i tij si fotoreporter e bindi Rosenthalin që të tentonte për shkrepien e rezistencës. Për këtë nuk do të pendohej asnjëherë.

Mposhti frikën dhe arriti në kohën kur 6 marinsat e "Easy Company" ishin duke vënë një flamur shumë të madh amerikan në majën e malit. Rosenthal inkudroi skenën me objektivin e aparatit të tij të rëndë Speed Graphic. E pozicionoi lentin dhe me një shpejtësi të hatashme e shkrepi. Në momentin e shkrepijes së fotografisë nuk e dinte se ajo foto bardhezi do të bëhej një imazh historik, një nga fotot më të famshme në të gjithë botën dhe sigurisht më e famshme në Amerikë. Një foto që merr çmimin "Pulitzer" në 1945 dhe bëhet fotoja më e famshme deri atëherë e realizuar nga fotoreporterët e luftës. Ai imazh u bë simboli i fuqisë dhe i patriotizmit amerikan, u stampua dhe vazhdon që të stampohet nëpër mijëra postera; imazhi i kapur nga një djalos amerikan, që do të bëhej frymëzimi i fotografëve dhe artistëve.



Pas javëve të tëra bombardime, amerikanët zbarkuan në Iwo Jima më 19 shkurt të vitit 1945

Statistikat nga Ministria e Punës dhe INSTAT-i vërtetojnë pabarazinë gjinore në tregun e punës

Administrata shtetërore, “streha” më e sigurt për gratë

“Të arsimuara njëlloj si meshkujt, por jo në poste drejtuese”

Zyrat e administratës publike duket se janë “streha” më e sigurt për punësimin e femrave. Sipas statistikave më të fundit të Ministrisë së Punës, bëhet e ditur se 56 për qind e të punësuarave femra janë kryesisht në institucione shtetërore. Por, pavarësisht kësaj shufre, të dhënat tregojnë se femrat shpesh nuk janë në poste drejtuese. Niveli i përgjithshëm i punësimit të tyre ka të bëjë me pozicionet të tilla si specialiste apo nëpunëse të thjeshta. Nga ana tjetër, shifrat statistikore të INSTAT-it tregojnë se femrat në pushtetin qendror zënë një vend më të madh me rreth 40 për qind të të punësuarave. Kjo shifër është më e ulët në administratën vendore, me vetëm 30 për qind të numrit total të të punësuarave. E ndërsa në institucione shtetërore pabarazia mes dy gjinive duket sikur është më e kontrolluar, e kundërta vërehet në sektorin privat. Kjo, sidomos në nivelin e menaxhimit të biznesit. Në sektorin privat, duke ju referuar të dhënave të INSTAT-it, rezultati se numri i femrave të punësuarave është shumë më i ulët se ai i meshkujve. Ndërsa në pozicionet e menaxherëve janë një numër edhe më i vogël, vetëm 17 për qind. Në një nivel më të pranueshëm është punësimi i femrave në sektorin e shërbimeve, ku ato zënë një përqindje punësi-



përqindja

Femrat e punësuarave në pushtetin qendror zënë rreth 40 për qind të të punësuarave dhe 30 për qind numërohen në pushtetin vendor



punësimi

Sipas statistikave rezultoni se niveli i punësimit të femrave është vetëm 38,8 për qind krahasuar me 60 për qind për burrat

mi me rreth një të katërtën e meshkujve. Më të preferuara ato janë në sektorin e hotelierit-turizmit, bare dhe restorante, atë të shpërblimit, si dhe në prodhimin e konfeksioneve. Në sektorin e transportit, punësimi i grave zë një shifër mjaft të ulët, vetëm 2 për qind. E tillë mbetet kjo përqindje edhe në biznesin jobujqësor. Ministria e Punës ka ndërmarrë një plan veprimi për barazimin gjinor, si dhe ka hartuar një strategji që i kushtohet zhdukjes së kufijve gjinorë në tregun e punës. Por ky in-

stitucion, pas sondazheve dhe monitorimeve të realizuara në sektorë të ndryshëm, ka vërtetuar se shifrat e ulëta të punësimit të femrave, në periudhën tranzitive, janë një provë e pakundërshtueshme e pabarazisë gjinore në tregun aktual të punës. Aksesit i gruas në punësim shënon 46 për qind të forcës aktive, edhe pse vlerësohet fakti se arsimimi i pjesës më të madhe të femrave rezultoi në nivele të barabarta me meshkujt. Kjo, pavarësisht fenomenit që vihet re vitet e fundit të

braktisjes së shkollës nga një numër i madh vajzash që detyrohen të nënshtrihen mentalitetit të vjetër, sidomos në zonat rurale. Duke ju referuar statistikave të fundit nga INSTAT-i për vitin 2005, rezultati se niveli i punësimit të femrave është vetëm 38,8 për qind krahasuar me 60 për qind për burrat. Këto të dhëna raportohen në një kohë kur shifrat e papunësisë në shkallë kombëtare janë 14,4 për qind. Ku sërish më shumë të papunë numërohen mes grave.

A. Rr.

Tiranë

U prematuan apartamente dhe shembën banesat që prisnin legalizimin

Mashtrimi, 13 familje në grevë urie. Mbesin pa shtëpi

Për 13 familje në Tiranë kanë hyrë në grevë urie, pasi kanë rënë pre e mashtërimit të dy personave. Të prezantuar si investitorë, ata janë shfaqur të këta familjarë, kryesisht nga Peshkopia, të cilët kishin ndërtuar në zonë informale, pasi e kishin blerë truallin nga pronari i tokës. Pasi kanë nënshkruar akt-marrëveshjet e noterizuara për sipërfaqet që do të përfitonin, në pallatin që do të ndërtohej nga firma “Santara”, banorët kanë pranuar t’u shembeshin shtëpitë, që prisnin t’i legalizonin. Më pas ata janë strehuar në shtëpi me qira, të paguara po nga këta dy persona, në pritje të përfundimit të pallatit. Por, tani që pallati është në përfundim, presidenti i firmës “Santara”, Asllan Sula, u ka thënë banorëve se nuk kanë apartamente në këtë objekt. Pasi ishte ndërtuar pallati, dy personat Mehmet Kurti dhe Lutfi Shtrezi, të cilët kanë lidhur akt-marrëveshjet me banorët, u kanë deklaruar banorëve se tokës i ka dalë pronari i ligjshëm dhe përqindjet do t’i marrë ai. Duke përfutur nga pozita që kanë pasur, ata i kanë paditur në gjykatë banorët, duke shpresuar se do të hiqnin dorë nga pretendimi për përfitimim e apartamenteve në pallatin që po ndërtohej. Por, më pas, e kanë tërhequr padinë. Përfundimisht, pallati është ndërtuar dhe banorët që mbeten pa shtëpi nuk mund të marrin apartamente. Presidenti i firmës “Santara” u ka thënë atyre se nuk mund të marrin asnjë metër katror sipërfaqe. I kontaktuar në telefon, ai shpjegon se ka kontratë vetëm me dy personat Mehmet Kurtin dhe Lutfi Shtrezin, të cilët ia kanë ofruar këtë shesh ndërtimi si të tyrin, madje duke e ndihmuar firmën të marrë edhe lejen e ndërtimit. Në bazë të kontratës, Sula shpjegon se u ka paguar këtyre dy personave 16 milionë lekë të reja dhe 26% të objektit, thënë ndryshe 42 apartamente, 6 dyqane dhe 9 parkime. Përballë kësaj mashtrimi banorët nuk kanë parë zgjidhje tjetër veçse një reagim të dhunshëm. Ata kanë pushtuar pallatin dhe thonë se nuk do të largohen që aty.

Përballë mashtërimit banorët s’kanë parë zgjidhje tjetër veçse të pushtojnë pallatin duke thënë se nuk do të largohen që aty

ARSIM

Pollo dhe Çelik vendosin pikat për bashkëpunimin shkencor

Turqi-Shqipëri, marrëveshje për “shkëmbime” shkencëtarësh

Shqipëria dhe Turqia nuk kanë të përbashkët vetëm mënyrën e gatimit. Tani këto dy vende do të kenë të përbashkëta edhe në kërkimin shkencor. Madje, këto dy vende do të kenë edhe shkëmbime të njëlloshme në substancë, por të ndryshme në përmbajtje. Ministri i Arsimit, Genc Pollo, dhe homologu i tij turk, Huseyin Çelik, firmosën marrëveshjen më të fundit të bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën e kërkimit shkencor dhe teknologjik. Një nga pikat më interesante të marrëveshjes është edhe shkëmbimi i shkencëtarëve mes vendeve, ose bashkëpunimi i tyre në projekte të caktuara. Konkretisht, pikat për të cilat kanë rënë dakord dy ministrat e shkencës janë realizimi i kërkimeve të përbashkëta dhe projekteve të zhvillimit, duke përfshirë shkëmbimin e rezultateve kërkimore dhe të shkencëtarëve, specialistëve e kërkuesve. “Shkëmbimin e shkencëtarëve dhe ekspertëve të veçantë për realizimin e punëve kërkimore, shkëmbimin e informacionit për veprimtaritë kërkimore, zbatimin e metodave të reja shkencore”, është një pikë e rëndësishme e marrëveshjes. Po ashtu, shkencëtarët apo ekspertët turq dhe ata shqiptarë do të mbajnë leksione, do të vendosin kontakte të reja shkencore për projekte të përbashkëta



Shkencëtarët turq dhe shqiptarë do të mbajnë leksione, do të vendosin kontakte të reja shkencore për projekte të përbashkëta

Shkencëtarët turq dhe shqiptarë do të mbajnë leksione, do të vendosin kontakte të reja shkencore për projekte të përbashkëta. Por, edhe nëse palet do të kenë nevojë për dokumentacionin përkatës të dy shteteve, atëherë ata do të shkëmbejnë atë. Edhe kjo është një nga pikat e parashtruara në marrëveshje. Sipas Ministrisë shqiptare të Arsimit, ekspertët tanë dhe ata turq do të kujdesen për organizimin dhe pjesëmarrjen në takime, konferenca, simpoziume dhe ërkshope të përbashkëta shkencore. Pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, të dyja palët do të ngrënë një komitet të përbashkët, i cili do të përcaktojë fushat prioritare të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik. Ky komitet do të shërbejë për miratimin e programeve të përbashkëta. Gjate takimit bashkëbiseduesit kanë diskutuar për reformat arsimore që po zhvillohen në Turqi e në Shqipëri dhe në nevojën për zbatimin e tyre me vendosmëri e sipas standardeve ndërkombëtare. Kjo, sipas tyre, në dobi të një integriteti të shpejtë dhe të natyrisht të dyja vendeve tona në Evropë.

Lo. Mi.

SHENDETESI

Barnat për pacientët me AIDS

Ministria: Nuk na ka ardhur asnjë kërkesë

Kërkesa për rimbursimin e 13 barnave që u nevojiten të sëmurëve me HIV/AIDS nuk ka mbërritur ende në Ministrinë e Shëndetësisë. Sipas kreut të Drejtorisë së Farmaceutikës në këtë institucion, Nazmi Alibali, deri tani nuk ka mbërritur asnjë kërkesë për barna nga shoqata e të sëmurëve me HIV/AIDS. Megjithatë, sipas Alibalit derisa një medikament bëhet pjesë e listës së barnave me rimbursim duhet të kalojë disa barrierë. Ndërkohë që, deri tani pacientëve të prekur nga sëmundja e shokullit, shteti u rimbursonte vetëm pjesën e medikamenteve, të cilat konsiderohen të shtrënjta dhe të papërbalueshme nga kjo kategori. Pavarësisht kësaj, shoqata e të sëmurëve me HIV/AIDS ka deklaruar se kërkesa për rimbursimin e 13 medikamenteve ka mbërritur prej kohësh në ministri. Pacientët e prekur nga kjo sëmundje kanë mbetur të pakënaqur nga neglizhenca e shtetit ndaj sugjerimit të tyre për rimbursimin e barnave, që shërbejnë për trajtimin e problemeve anësore që jep sëmundja. Madje, sipas shoqatës, një kërkesë e tillë i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë para dy vjetësh. Ish-ministri i Shëndetësisë i premtoi kësaj kategorie se 13 barnat do të ishin pjesë e listës dhe tërheqja e tyre do të bëhej në spitalin “Nënë Tereza”. Ndërkaj, shoqata e të sëmurëve me HIV/AIDS dhe prindërit e fëmijëve talasemikë që u infektuan nga transfuzioni i gjakut do ta çojnë këtë çështje në gjykatë.

Lo. Mi.

CAPITAL

INSTITUTI PRIVAT I PENSIONEVE

PROGRAMI I PERFITIMEVE:

- PENSIONE PLEQERIE
- PENSIONE TE PARAKOHSHME
- PENSIONE FAMILJARE DHE INVALIDITETI

... bëjmë diferencën në pensione...

Rr. “Dervish Hima”, nr. 2/1, Tiranë, Shqipëri
 tel: +355 4 348 000 • tel/fax: +355 4 363 003
 e-mail: contact@capital.com.al
<http://www.capital.com.al>

GRAFIKA: ILI KOÇIU



Përmet

■ Nga 127
kërkesa për
vizë, konsullata
refuzoi 125

■ Viza greke iu
refuzua edhe
kryeplakut të
fshatit

Greqia dënon fshatin e zhvarrimeve

Konsullata nuk pajis më me viza as ortodoksët e komunitetit çoban të Kosinës

KAMBER VELAJ

Kisha e kuqe mesjetare nuk i shkon shumë për shtat pamjes së rrënuar të fshatit të vogël të Kosinës. Është kisha e "Shën Mërisë", e ndërtuar në shekullin XII, por që në tetë shekuj nuk



DESHMIA
Sipas njërit prej varmihësve, në 69 varret e Kosinës nuk u gjet asnjë medaljon ushtari

arriti kurrë të kishte atë famë që i dhanë brendajavës një prift, një minoritar grek dhe disa varmihës. Në mars të vitit të shkuar, disa burra trazuan dhe-un në oborrin e vjetër të kishës dhe nxorën prej andej dhjetëra

marrëveshjeve ndërkufitare. Tani, thonë se po të jesh nga Kosina është e vështirë të pajisesh me vizë, edhe sikur të plotësojë të gjitha dokumentet që plotësojnë qytetarët "e zakonshëm" shqiptarë. Një fshatar i Kosinës, që na takoi në Përmet, tha se "në janar, dy çobanë

ESHTRAT
Edhe pse varret janë mbyllur në prill, në pjesën e pasme të kishës së "Shën Mërisë" në Kosinë gjen më shumë kocka njerëzish se sa gurë. Fëmijët që luajnë aty thonë se kockat janë më të dukshme e të shumta në numër pas shirave

u angazhuan në mbledhjen e firmave të anëtarëve të komunitetit të tyre, për të njerëzish vizë greke. Por, nga 127 kërkesa për vizë vetëm dy u aprovuan. Por në lokalit e fshatit, për vizat është e vështirë të flitet, po aq sa edhe për kockat e kishës. Kur bie fjala për këto tema, të duket sikur ke përpara personazhet e dramës së famshme "Sh-trigat e Salemit". Burrat shohin njëri-tjetrin në sy, si për t'u siguruar se askush nuk ka për të thënë asnjë fjalë më tepër nga ajo për të cilën të gjithë kanë rënë dakord në heshtje. Nuk duan të flasin shumë, duke shpresuar se me kalimin e kohës gjërat do të kthehen si më parë dhe shqiptarët do harrojnë inatin me çobanët që nuk respekton varret dhe grekët, me ata që nuk dijnë të ruajnë sekretin.



BESIMET

Kosina është e ndarë thuajse përgjysmë mes myslimanëve dhe ortodoksëve që janë çobanë



EKONOMIA

Emigracioni është baza e ekonomisë, ndërsa në fshat mbajnë shumë lopë, si dhe bëjnë raki e verë



Kryeplaku

Spiro Zharka, njeriu që dha së pari lejen për hapjen e varreve në kishën e fshatit të tij, nuk është më i bindur sot, se në ato varre kishte vërtet kocka të ushtarëve grekë. Ai thotë se ato varre mund të kenë qenë aty prej qindra vjetësh



Viktima

Njeriu që denoncoi skandalin mundohet të qëndrojë larg fshatit

Altin Ballabani: Vetëm unë nuk përfitova nga zhvarrimet

Altin Ballabanin nuk mund ta takojmë në Kosinë, edhe pse shtëpia e tij ndodhet aty, jo shumë larg kishës së fshatit. 34-vjeçar me dy fëmijë ulet rrallë në kafenet e fshatit, sepse e di që sot të gjithë fajtojnë atë për problemet që patën me policinë, me prokurorinë dhe me konsullatën greke. Por Altin Ballabani, nga ana e tij, thotë se fajtorë janë të gjithë të tjerët që përfituan duke shitur eshtra njerëzish. Altini vetë nuk kërkon vizë greke, sepse në vendin fqinj është person i padëshiruar dhe ka vuajtur një dënim prej dy vitesh burg për një krim ordinar. Ai është bërë pishman që foli atëherë dhe denoncoi priftin Thomollari, sepse që nga ajo ditë përveç përbuzjes së bashkëfshatarëve nuk ka përfituar gjë tjetër. "Kam edhe frikë se mos më bëjnë gjë. Jo fshatarët e mi, sepse ata i njoh, por në këtë mes nuk janë futur vetëm fshatarët. Ka luajtur para e madhe për ato varre dhe nuk ta falin kollaj", thotë Altini, i cili na takon në dalje të Kosinës dhe udhëtojmë 3-4 kilometra deri në Piskovë, për të pirë kafe pa u

"Kam denoncuar një skandal, ndaj Kryeministrit të më shpërblejë duke më mbrojtur"



shqetësuar nga njeri. Altini thotë se grekët kishin përcaktuar një çmim prej katërmijë eurosh për çdo skelet njeriu që do t'ju jepej dhe, sipas tij, paratë i administronte prifti Vasil Thomollari dhe minoritari nga Jorgucat, Alqi Kosta. Duke menduar se të dy njerëzit e cenuar nga deklaratat e tij

në media mund të hakmerren, Ballabani i ka kërkuar ndihmë Kryeministrit Berisha. "I kam shkruar tri letra, por kam marrë vetëm një përgjigje, që në fakt nuk jepte sqarime për asnjë kërkesë. Unë e di që Kryeministri ka premtuar shpërblime për të gjithë ata që denoncojnë rastet e korrupsionit, ndaj i jam drejtuar atij. Ai që unë denoncova, rast korrupsioni ishte, por unë nuk dua para. Dua vetëm të më sigurojnë familjen. Të më nxjerrin viza që të mund të lëviz që këtu, se kam dy fëmijë dhe nuk ndihem i sigurt", thotë Altin Ballabani. Ai ishte njeriu që denoncoi i pari publikisht skandalin e Kosinës. Ballabani ishte vetë një ndër varmihës të pajtuar nga prifti Thomollari, por, sipas tij, këtë punë e kishte marrë përsipër pa e ditur se çfarë loje po lubej. "Prifti na tha se do bëheshin punime në oborrin e kishës, ndaj duhet të nxirrnim kockat për t'i rrvatorosur në një vend tjetër, aty afër", tregon Ballabani, i cili nuk e fshesh se u rebelua për shkak të një medaljoni të artë që gjeti në një varr e që nuk donte t'ia dorëzonte priftit.



HETIMI

Prokurorja e Përmetit përgatitet t'ua kalojë përgjegjësinë eprorëve në Tiranë

Dosja e Kosinës, në dorë të Prokurorisë së Përgjithshme

KAMBER VELAJ

Dosja e zhvarrimeve të Kosinës me të akuzuar një prift dhe një aktivist të shoqatave të minoritetit grek, pritet që në fund të muajit të mos jetë më objekt pune i Prokurorisë së Përmetit.

Prokurorja e këtij rrethi, Silvana Pani, tha për gazetën "Shqip", se afati i hetimeve për këtë dosje mbaron më 26 shkurt dhe deri në këtë datë ajo do të vendosë nëse do të kërkojë mendimin e Prokurorisë së Përgjithshme, apo do ta kalojë krejt dosjen për shqyrtim në këtë prokurori. "Çështja është ende jo krejtësisht e qartësuar. Nuk mund të themi ende nëse janë konsumuar elementet e veprës penale, ndaj edhe kemi kërkuar dy herë shtyrjen e afateve të hetimit për të rimarrë në pyetje disa dëshmitarë", tha prokurorja Pani.

Por, edhe pse ditët po kalojnë, Pani thotë se nuk është e informuar nëse oficeri i policisë gjyqësore, që e ka zyrën përballë saj, i ka marrë apo jo në pyetje dëshmitarët. Një nga njerëzit që do të rimerret në pyetje, sipas prokurores, është kryepalaku i fshatit Kosinë, Spiro Zharka. Por vetë Zharka nuk është njoftuar nga askush për t'u marrë në pyetje.

Afati i hetimit përfundon më 26 shkurt, por prokurorja ka të drejtë ta shtyjë sërish



HETIMET
Prokurorja e Përmetit nisi hetimet për zhvarrimet e Kosinës më 27 maj 2006



AKUZAT
At Vasil Thomollari dhe Alqi Kosta u akuzuan nga kryetari i Komunës Kosinë



AFATET
Prokurorja ka shtyrë dy herë afatet e hetimit, që përfundon më 26 shkurt

dosje. Është ndoshta një nga ato dosje që asnjë prokuror nuk do t'ia uronte vetes ta kishte në dorë, sidomos në një qytet të vogël si Përmeti, ku njerëzit janë të lidhur me një mijë fije me njëri-tjetrin. Oficeri i policisë gjyqësore, që ka për detyrë të mbledhë prova për të vërtetuar dyshimet mbi priftin, shkon çdo ditë në kishën e vetme të qytetit dhe është

të detyruar të përballet me personin nën hetim. Por, në Përmet thonë se edhe prokurorja Pani ka rrethana që çdo njeri normal do ta bënin të stepeshin përpara një dosjeje ku mund të preken interesat e kishës dhe shtetit grek.


Edhe për një prokurorë, refuzimi i vizave greke mund të rëndojë shumë, sepse në shtetin fqinj nuk shkohet vetëm për punë apo për qejf, por edhe për spital.

Ndoshta më shumë për shkak të këtyre rrethanave se sa për shkak të "paqartësisë së çështjes", prokurorja Pani ka menduar ta heqë nga vetja barrën e rëndë të dosjes së eshturve, për t'ia kaluar Prokurorisë së Përgjithshme.

Nga ana tjetër, At Thomollari vazhdon i qetë punën e tij në kishën e sajuar në pallatin e kulturës të qytetit. Ai e shpreh hapur bezdinë prej gazetareve, madje nuk ngurron të kërcënojë fotoreporterin kur ai tenton t'i bëjë një foto.

Njësoj si në maj të vitit të shkuar, kur u mor nën hetim, prifti thotë se është krejtësisht i pajajshëm dhe se i vetmi rol i tij në zhvarrimet e Kosinës ka qenë tria-thaia. Ai thotë se tashmë ka mbledhur edhe firmat e gjithë familjeve të krishtera të Kosinës, që deklarojnë se varret e hapura në oborrin e kishës së "Shën Mërisë" nuk janë të të afërmeve të tyre. Tani që ka në dorë edhe këto deklarata, prifti thotë se nuk është aspak shqetësuar për hetimin. Madje, duke folur për zhvarrimet, ai deklaron se nuk e mban mend fare se për sa skelete bëhej fjalë.

Tani gjithçka ka rënë në qetësi në Përmet. Njerëzit janë përqendruar shumë të zgjedhjet për pushetë vendor, madje edhe duke pezulluar çdo veprim, deri sa këto zgjedhje të mbarojnë.



HISTORIA

Zhvarrimet u ndërprejnë kur njëri nga varrmihësit denoncoi priftin

Si u nxorën eshtrat e vjetra për të shtuar ushtarët

Historia nisi përpara pash këve të vitit 2006. Prifti i Përmetit, Vasil Thomollari, i shoqëruar nga një ish-ushtarak minoritar me emrin Alqi Kosta dhe disa të tjerë që flisnin greqisht, takuan kryetarin e fshatit Kosinë, Spiro Zharka. I thanë se do të bënin disa zhvarrime në oborrin e kishës së vjetër të Shën Mërisë. Thanë se kërkonin eshtra ushtarësh grekë, të rënë në këtë zonë gjatë luftës italo-greke. Alqi Kosta ishte kryetar i shoqatës së ish-ushtarakëve minoritarë, që është angazhuar të gjejë, të zhvarrosë dhe të rrvarrosojë me nderime ushtarët grekë të rënë në tokën shqiptare. Sipas dëshmitë të të dyja palëve, kryepalaku i Kosinës foli me familjet ortodokse të fshatit dhe pas

dy ditësh i la dorë të lirë priftit. Në varrezat e kishës nuk ishte varrosur më njëri që nga viti 1945 dhe fshatarët për një vitish nuk kujdeseshin më për këto varreza, as sa nuk e dinin me saktësi se ku ishin varrosur gjyshërit e stërgjyshërit, por thjesht dinin se ata ishin diku aty mes bashkëfshatarëve të tjerë. Me të marrë aprovimin e kryepalut, prifti gjeti

disa punëtorë në fshat dhe me të shpejtë ka nisur puna. Deri në fund të muajit maj një grup punëtorësh zhvarrosë çdo ditë eshtra nga varrezat e vjetra. Ata dëshmuar se paguheshin me nga 100 euro për çdo varr të hapur. Çdo ditë prifti ngarkonte në një fuoristradë skeletet e futura në qese plastike dhe i çonte në fshatin fqinj, Kutal, në

Kishën e Kryeëngjëjve. Aty skeletet laheshin me verë. Për këtë paguheshin fshatarë me 50 euro për çdo skelet. Gjithçka shkonte fllorë, deri në fund të majit, kur Alin Ballabani, i vetmi ortodoks në varrmihësit, denoncoi në "TV Aot" priftin Vasil dhe Alqin nga Gjirokastra. "Po marin eshtra grash dhe fëmijësh. Nuk janë ushtarë ata që po zhvarrosen". Të nesërmen lajmi mori dhenë. Më 27 maj kryetari i komunës u nis për në prokurori: "Na kanë dhunuar varrezat publike. At Vasil Thomollari dhe Alqi Kosta janë marrë me këtë punë". Në prokurori shkon edhe Alin Ballabani, varrmihësi. Eshtrat bllokohen dhe ekzaminohen brenda pak ditësh dhe zbulohet se mes skeleteve kishte pleq të vjetër dhe gra.



Kryepalaku i Kosinës foli me familjet ortodokse dhe pas dy ditësh i la dorë të lirë priftit

Dosja e Kosinës është barrë shumë e rëndë për prokurorinë e një qyteti të vogël si Përmeti

Edhe një prokuror mund të dëmtohet nëse prek interesat e kishës apo Greqisë

QYTETI
Në Përmet gjithçka ka ngrirë në pritje të zgjedhjeve vendore

Gazetari



Xhani: Si e zbulova skandalin

Arjan Xhani, pronari i televizionit "Aos" të Përmetit ishte njëri që publikoi për herë të parë pamjet rrëqethëse nga Kosina, ku fëmijët mbledhin kocka njerëzish në oborrin e kishës së fshatit. Xhani tregon se ishte njoftuar nga miqtë për çka po ndodhte në Kosinë dhe i ishte dashur të shkonte shpejt në fshat për të sqaruar gjithë ngjarjen. "Pas disa ditësh arrita të zbuloja gjithë skemën, por nuk mund ta bëja lajm, sepse nuk mund t'u shkëpusja asnjë prononcim banorëve", thotë Xhani. Ai tregon se iu desh të prishte derisa në mesin e atyre që po merreshin me zhvarrimet të krijoheshin çorë-dhe-kjo ndodhi, kur Alin Ballabani u grind me priftin. "Ishte me rrezik, por për gazetarin është një rast që nuk vjen përditë", thotë Xhani, që tani punon edhe për "Top-Channel".

Në varrezat pranë kishës së "Shën Mërisë" nuk ishte varrosur më njëri që nga viti 1945

Gjigandi Italian i shpërndarjes ushqimore



nga 14 SHKURTI
ora 17.30



edhe në Durrës.
Cilësi dhe Leverdi.
Gjithçka italiane.

Tek Qendra tregtare Galaktik



... dalloni ndryshimin!

NJOFTIM PER VEND TE LIRE PUNE

Opportunity Albania - Partneri Shqiptar në Mikro kredi (OA - PSHM) është partneri shqiptar i Opportunity International (OI) Network. OI është një organizatë mikrofinanciare e njohur në të gjithë botën e cila punon në mbi 30 vende që prej 35 vjetësh.

OA - PSHM aktualisht kërkon të punësojë:

SPECIALISTË KLIENTI

për të punuar në

DURRËS, BERAT, KAVAJE

Qellimi i punes:

Ky pozicion do të ketë përgjegjësi kryesore Promovimin e kredive tek një grup i caktuar sipërmarresish, analizen financiare, ekonomike dhe ligjore të njësive socio-ekonomike (aktiviteti dhe standarti i jetesës), propozimin para Komitetit të Kredite të kredive (kushtet dhe termat e tyre), monitorimin e portofolit të kredive

Ju lutem dërgoni aplikimin tuaj i cili përbehet nga Kërkesa, CV dhe forma e aplikimit (e cila mund të terhiqet pranë çdo zyre të OA - PSHM) brenda datës 20 Shkurt 2007 në adresat e mëposhtme:

Per pozicionet ne Durres dhe

Kavaje:

Opportunity Albania - PSHM

L.12, Rruga Deshmorëve, Nr 151, Durres, Shqiperi

Per pozicionet ne Berat:

Opportunity Albania - PSHM

L."Xhevdet Nepravishta",

Bulevardi Kryesor, pranë stadiumit, Lushnje, Shqiperi

OA - PSHM i filloi operacionet në 1999 nëpërmjet një mbështetjeje financiare të USAID. OA - PSHM është institucion financiar i qëndrueshëm duke siguruar mundësi financiare për bizneset shqiptare edhe në të ardhmen. Vizioni i OA - PSHM është: Një Shqiptar ku të gjithë Shqiptarët kanë mundësinë të thyjnë vargënjtë e varfërisë dhe të transformojnë jetën e tyre.

Vlerat thelbësore në të cilat OA - PSHM beson janë Respekti, Përkushtimi, Integriteti, Përkujdesja dhe Profesionalizmi.

OA - PSHM i ofron klienteve kredi biznesi për aktivitete si tregti, shërbim, prodhim dhe biznese bujqesore. Kjo krijon qëndrueshmëri në aktivitetet dhe jetën e klienteve duke i hapur rrugën mundësive të transformimit social dhe ekonomik. OA - PSHM i jep mundësi të barabarta për financim të gjitha bizneseve që kërkojnë të rriten pavarësisht përkatësisë së tyre politike, etnike apo fetare.

• Durrës: L. 12, Rr. E Deshmorëve, Nr. 151, ☎: 052 30343 • Elbasan: Bul. "Qemal Stafa", pranë kinema Milenium, pallati i ri; ☎: 054 54130; • Fier: Rr. "Ramis Aranitasi", (Pranë shkollës Industriale "Petro Sota") ☎: 034 23256 • Gjirokastrë: L. "18 Shkurt", Përballe Drejtorisë së Policisë ☎: 0846 8580 • Kallmet: Qendër Kallmet, tek Kryezimi Kallmet, përballe Kallmet ☎: 04 20081 • Korçë: Bul. "Fan Noli", Pallati i ri, (përballe Bashkisë) ☎: 082 42870 • Fushë-Krujë: L. "Kastrioti", qendër ☎: 056 32462 • Kukës: Bulevardi Kryesor, pranë Hotel Gjallës ☎: 024 22150 • Lushnjë: L. Xhevdet Nepravishta, Bul. Kryesor, pranë stadiumit ☎: 035 20416 • Peshkopi: Bulevardi Kryesor, përballe Bashkisë ☎: 0218 5528 • Sarandë: L. 1, Rr. e Deshmorëve, Hotel "Palma e Artë", kati i parë ☎: 085 26184 • Shkoder: pranë Hotel "ROZAFI" ☎: 022 40539 • Tiranë 1 / Zyrë Qendrore: Rr. "Gjin Bue Shpota", Nr. 7/1 ☎: 04 246267 / 8 • Tiranë 2: Rr. Terit Xhaxho, pranë ish restorant Durrës ☎: 04 235767; ☎: 04 235783 • Vlorë: L. Muradie, Rr. "Justin Godard", pranë BKT-së ☎: 033 23279

UNË JU DËRGOJ NDIHMË

WESTERN UNION

Transferta parash në të gjithë botën:
të shpejta, të sigurta.

CSC number:
+355 4 23 49 79



E ardhmja në dorën tuaj!

AMC ofron një mundësi të shkëlqyer për të gjithë ata individë të kualifikuar dhe energjikë të cilët kërkojnë të bëhen pjesë e një mjedisi dinamik dhe shpërblyes. Ne jemi një kompani që rritet me ritme të shpejta që i stimulon punonjësit me ambicie profesionale nëpërmjet benefiteve të shumta dhe mundësive për karrierë! Paga e pozicionit bazohet në eksperiencën dhe aftësitë tuaja!

Ne kërkojmë SPECIALIST PLANIFIKIMI DHE RAPORTIMI NSS/BSS

QELIMI I POZICIONIT: Specialist i Departamentit të Core Network & VAS Engineering, Sektori i NSS dhe BSS është përgjegjës për planifikimin dhe dimensionimin e rrjetit Core, implementimin dhe ndjekjen e projekteve, përgatitjen e raporteve mbi performancën dhe cilësinë e rrjetit.

DETAT KRYESORE TË POZICIONIT:

- Monitorimi i treguesve të cilësive së rrjetit NSS / BSS
- Përgatitja e raporteve javore në nivel ekzekutiv
- Përgatitja e raporteve javore të gjendjes së rrjetit
- Pjesëmarrja në testet e roaming
- Planifikimi dhe dimensionimi i elementeve të rrjetit NSS/BSS
- Përgatitja e urdhrave të punës dhe pjesëmarrja në ekzekutimin e tyre
- Studimi i versioneve të reja të SW në fushat përkatëse

KUALIFIKIMET E KANDIDATËVE:

- Diplome Universitare në Inxhinieri Elektronike (Preferohet profili Telekomunikacion dhe mesatare e notave mbi 7)
- Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze (e shkukur dhe e folur)
- Eksperiencë e punës në fushën e telekomunikacionit është avantazh.
- Njohuri shumë të mira kompjuterike dhe të paketes Microsoft Office (Word, Excel, PowerPoint, MS Project, MS Visio, AutoCAD)
- Aftësi kërkimore.
- Aftësi komunikuese dhe prezantuese.
- Aftësi për të punuar në grup.
- Gatishmëri për të punuar mbi orarin normal të punës.
- Gatishmëri për të udhëtuar jashtë Tiranës.
- Dëshirë dhe aftësi për të mesuar.
- Kandidatët duhet të jenë të pajisur me pasaportë.

Të interesuarit duhet të plotësojnë Formularin e Aplikimit, i cili gjendet:

- ☐ Në Internet, adresa www.amc.al
- ☐ Pranë recepsionit të AMC-së, në zyrat tona në Laprakë.
- ☐ Pranë dyqaneve të AMC-së.

KUJDES: NE FORMULARIN E APLIKIMIT, TEK "POSITION YOU APPLY FOR", JU LUTEMI PLOTESONI KODIN:

- NBPRS - Per pozicionin Specialist Planifikimi dhe Raportimi NSS/BSS.
- VPS - Per pozicionin Specialist Planifikimi VAS.
- HD - Per pozicionin Specialist Help Desk

Formularin e plotësuar, së bashku me referencë dhe vërtetime për aftësitë dhe eksperiencat e përshkruara në të, mund ta dorëzoni në recepsionin e AMC-së, dy dyqanet AMC, në adresën e-mail human-resources@amc.al

Për çdo informacion, jeni të mirëpritur të kontaktoni me në Nr.04275151.

Data e fundit e aplikimit 20 Shkurt 2007

Ne kërkojmë një SPECIALIST HELP-DESK

DETAT KRYESORE TË POZICIONIT

- Suport i userëve në rastet e problemeve të hardware dhe software.
- Instalim, konfigurim dhe mirëmbajtje e hardware të PC.
- Instalim, konfigurim dhe mirëmbajtje e software të PC.
- Kontrolli i sigurisë së rrjetit të përdoruesve të sistemeve IT.
- Aplikimi i politikave të aksesit dhe sigurisë për përdoruesit e sistemeve lokale.
- Instalim, konfigurim dhe mirëmbajtje e rrjetit.
- Regjistrimi i problemeve të përdoruesve të rrjetit.
- Operimi në aplikimin e Help Desk të AMC-së.
- Përgatitja e raporteve të përjavshme statistikore mbi problemet dhe zgjidhjet e tyre.
- Pjesëmarrja dhe kontributi në zbatimin e projekteve sipas kërkesës.

KUALIFIKIMET E KANDIDATËVE:

- Diplome Universitare në Inxhinieri Elektronike ose Informatike (Preferohet mesatare e notave mbi 7).
- Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze (e shkukur dhe e folur)
- Te pakten një vit eksperiencë pune.
- Njohuri shumë të mira në sistemet operative si WIN XP/2003.
- Njohuri shumë të mira në Programat Office si MS Office XP/2003 Aftësi për të punuar në grup.
- Gatishmëri për të punuar mbi orarin normal të punës.
- Dëshirë dhe aftësi për të mesuar.

Ne kërkojmë SPECIALIST PLANIFIKIMI VAS

QELIMI I POZICIONIT: Specialist i Departamentit të Core Network & VAS Engineering, Sektori i VAS dhe OSS, është përgjegjës për planifikimin dhe dimensionimin e rrjetit VAS, implementimin dhe ndjekjen e projekteve, përgatitjen e raporteve mbi performancën dhe cilësinë e rrjetit.

DETAT KRYESORE TË POZICIONIT:

- Planifikimi dhe dimensionimi i platformave VAS (Prepaid, IN, SMS, VMS)
- Përgatitja e raporteve të ndryshme që lidhen me IN dhe Sistemet e mesazheve
- Implementimi i shërbimeve të reja me vlerë të shtuar
- Pjesëmarrja në testet e roaming
- Monitorimi i treguesve të cilësive së rrjetit për platformat VAS
- Përgatitja e urdhrave të punës dhe pjesëmarrja në ekzekutimin e tyre
- Studimi i versioneve të reja të SW për platformat VAS

KUALIFIKIMET E KANDIDATËVE:

- Diplome Universitare në Inxhinieri Elektronike ose Informatike (Preferohet profile telekomunikacion dhe mesatare e notave mbi 7)
- Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze (e shkukur dhe e folur)
- Eksperiencë e punës në fushën e telekomunikacionit është avantazh.
- Njohuri baze në Unix dhe Database (Oracle dhe Informix).
- Njohuri baze mbi shërbimet e lidhura me Internet-in (avantazh).
- Njohuri shumë të mira kompjuterike dhe të paketes Microsoft Office (Word, Excel, PowerPoint, MS Project, MS Visio, AutoCAD)
- Dëshirë për të mesuar mbi teknologjitë e reja në fushën e telekomunikacionit dhe të informatikës.
- Aftësi komunikuese dhe prezantuese.
- Aftësi për të punuar në grup.
- Gatishmëri për të punuar mbi orarin normal të punës.
- Gatishmëri për të udhëtuar jashtë Tiranës.
- Kandidatët duhet të jenë të pajisur me pasaportë.

U mbushën dje tre vjet nga vdekja e aktorit, regjisorit dhe dramaturgut Ferdinand Radi



Vështrim i paharruar

Si dje tre vjet më parë, u nda nga jeta aktori, regjisor dhe dramaturgu Ferdinand Radi. Në kujtesën e publikut, ai mbahet mend për fizikun e tij të bëshëm dhe pamjen impozante, ku konturoheshin tiparet imponuese të një njeriu që bartte jo vetëm potencë fizike, por dhe një kumt të thellë artistik, gjë që e shprehu më së miri në rolet tij në kinema e teatër. Jo gjithmonë me role të njëjta, me kahe nga personazhe dhe karaktere që ndilnin frikë, Ferdinand Radi luajti mjeshhtërisht dhe role me ndjeshmëri karakteri, siç do të mbahet mend ai i arxhiut në filmin "Vdekja e kalit". Aty Radi do të afirmohej dhe njëherë si aktor që mund të vishte kostumin e shumë karaktereve, duke lu larguar atij me sens forcën dhe brutalitetin, siç e përfaqëson më së miri në dramën "Ezopi", në rolin e Etiopasit me kamxhik në dorë. Rol të ngjashëm ai ka pasur dhe në filmin "I treti" në rolin e Zahos, ndërkohë që te filmi "Ilegalët" luajti rolin e kaporal Botit e tek "Përsëri në pranverë", rolin e matrapazit. Një ndër rolet e tij më të spikatura do të mbetet dhe ai i tipografit te filmi "Kur zbardhi një ditë". Me gjithsej 13 role në kinematografi, Ferdinand Radi mbeti aktor i karaktereve të veçanta. Mjeshhtëria e tij aktorese nuk përqendrohej vetëm te portreti, por mbi të gjitha te vështrimi, tingëllimi i veçantë i batutës dhe plastika e rrallë e tipareve. Pas viteve '90, ku kulmoi me rolin e arxhiut te "Vdekja e kalit", Ferdinand Radi i mëshoi më tepër regjisurës dhe skenarëve, duke pasur firmën e tij në shumë vepra të njohura. Ndër to, më e spikatura, në një famë që nuk ka të venitur, mbetet komedia "Tetë persona plus". Radi ishte skenarist dhe regjisor i kësaj pjese të njohur, që ishte ndër më të suksesshmet e vëna në skenën e Teatrit Kombëtar, pas '90-ës. Vitet e fundit, Ferdinand Radi ishte i përqendruar dhe te përgatitja e së bijës, Rozana Radi, në artin e aktrimit, e cila mbetet trashëguesja e të atit në këtë lërmë. Madje, 3 vjet më parë, ai ndërroi jetë, ndërsa e bija ishte duke u përgatitur për një premierë në Akademinë e Arteve, evenimente të cilat Ferdinand Radi i ndiqte me shumë interes. Artisti i njohur u nda nga jeta në moshën 62-vjeçare, si pasqje e një ataku kardiak. Radi lindi më 29 gusht 1942 në qytetin e Durrësit. Karrierën artistike e nisi me lëvizjen amatore në Tiranë, ndërsa më vonë kreu një kurs specializimi për regjisorë pranë Teatrit Kombëtar. Vite më pas, ai u shndërrua në një nga figurat më simpatike dhe më të preferuara për publikun.

KULTURE

Historia e një prej kryeveprave të Rilindjes gjermane, pak e njohur në Shqipëri, ashtu sikurse gëzojnë famë mitet e tjera të artit pamor evropian

LEGJENDA e DUARVE

Sipas kësaj historie, nga tetëmbëdhjetë fëmijët e familjes Albrehti dhe një vëlla tjetër i tij kishin talent për pikturë dhe me gjithë kushtet e vështira ekonomike të familjes, ushqenin dëshirën për të mësuar këtë art. Duke qenë se nuk mundeshin të udhëtonin të dy për këtë qëllim, ata hedhin një short. Në fillim njëri prej tyre do të punonte dhe do të përballonte shpenzimet e tjetrit dhe më pas do të shkëmbejin rolet



Pas katër vjetësh Albrehti kthehet në shtëpi si piktor i afirmuar, gjatë festimit familjar të rastit falënderon të vëllain dhe tregon për shortin që ata kishin hedhur duke thënë se tashmë ishte radha e tij të punonte që i vëllai të mësonte mjeshhtërinë e pikturës. Por i vëllai tregon duart e tij dhe qetësisht i thotë se nga puna e rëndë ato e kanë humbur shkathtësinë

ERMIR HOXHA

Periudha e Rilindjes me të drejtë konsiderohet si koha kur identiteti evropian që nisi të marrë formë që nga fillimi i mijëvjeçarit të dytë me kryqëzatat dhe problemet politike që e tejkalonin shtrirjen e tyre lokale, filloi të konsolidohet e të gjëjë një mënyrë shprehjeje universale përmes artit. Duke hapur perspektiva të reja botëkuptimore dhe historike, bumi i artit rilindas u parapriu hulumtimeve dhe zhvillimeve shkencore që i sollën fuqi ushtarake e politike Evropës, e cila u bë qendra e botës në plot kuptimin e fjalës. Shumë shpejt pasi lindi në Itali, stimuli artistik i Rilindjes u përhap edhe në vendet e tjera të Evropës, duke marrë një karakter të veçantë në çdo vend.

Njëri nga pionerët kryesorë të Rilindjes gjermane ishte piktori Albrecht Dyrer, autor i dhjetëra pikturave në teknika të ndryshme, i cili shumë shpejt do të fitonte famë në tërë Evropën dhe jo vetëm si piktor por, si shumica e artistëve të Rilindjes, edhe si matematikan.

Albrecht Dyrer lindi më 1471 në Gjermani, si fëmija i tretë ndër tetëmbëdhjetë. Ai dhe familja e tij e pikasën talentin e tij për pikturë dhe në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare Dyreri ndërmori, sipas traditës së kohës, një udhëtim që zgjati katër vjet, në kërkim të mjeshtrëve nga të cilët të mund të mësonte teknikat e pikturës. Pas kthimit në Nuremberg, ku jetonte familja e tij dhe pas një martese me motive më shumë ekonomike, ai shkoi në Itali për të avancuar dijet e tij dhe për të mësuar teknika të reja. Pas kthimit nga Italia, Dyreri nisi të punojë intensivisht dhe krijoi shumë nga punët e tij më të famshme, si seritë e Apokalipsit, të mundimit

të Krishtit, të Virgjreshës etj. Në këto punime vihet re ndikimi italian i kombinuar me elementet vendore të veriut. Përveç shumëllojshmërisë së teknikave, krijimet e Dyrerit shfaqin edhe një tematikë të gjerë, që nga skicat anatomike e portretet, deri te panoramat dhe tablotë me temë fetare e historike. Më 1506 ai shkoi përsëri në Itali dhe me gjithë reputacionin e madh që gëzonte në qendrën e artit evropian, pas një viti u kthye sërish në

Nuremberg. Pas një udhëtimi në Holandë dhe Belgjikë në vitin 1520, gjatë të cilit mori një sëmundje të pakuptueshme e cila ia uli produktivitetin, Dyrer u kthye përfundimisht në Gjermani. I ndikuar nga predikimet e Martin Luterit, ai u kushtua studimeve fetare dhe matematikës, duke shkruar disa libra mbi matematikën dhe gjeometrinë. Dyrer vdiq në vitin 1529, në moshën tridhjetëgjatëvjeçare.

Ndonëse ishte autor i shumë tablove të mëdha, një nga punimet më të famshme të Dyrerit është ai që njihet si "Duart në Lutje", një skicë e thjeshtë që paraqet dy duar të bashkuara për lutje. Kjo mendohet të jetë një skicë paraprake e një pikturë të një apostulli që lutet në altar, por rreth historisë së saj qarkullon një version shumë i përhapur, jo i vërtetuar. Sipas kësaj historie, nga tetëmbëdhjetë fëmijët e familjes Albrehti dhe një vëlla tjetër i tij kishin talent për pikturë dhe me gjithë kushtet e vështira ekonomike të familjes, ushqenin dëshirën për të mësuar këtë art. Duke qenë se nuk mundeshin të udhëtonin të dy për këtë qëllim, ata hedhin një short. Në fillim njëri prej tyre do të punonte dhe do të përballonte shpenzimet e tjetrit dhe më pas do të shkëmbejin rolet. Shorti i ra Albrehtit për të marrë udhët në kërkim të dijes dhe i vëllai e mbështeti duke punuar. Pas katër vjetësh Albrehti kthehet në shtëpi si piktor i afirmuar, gjatë festimit familjar të rastit falënderon të vëllain dhe tregon për shortin që ata kishin hedhur duke thënë se tashmë ishte radha e tij të punonte që i vëllai të mësonte mjeshhtërinë e pikturës. Por i vëllai tregon duart e tij dhe qetësisht i thotë se nga puna e rëndë ato e kanë humbur shkathtësinë dhe ndonëse sipas marrëveshjes që ata kishin bërë atij i takonte të studionte me shpenzimet e Albrehtit, talenti i tij nuk vliente më pasi duart i ishin bërë të paafta për punën e hollë të pikturës. I mallëngjyer nga kjo, për t'i shprehur mirënjohjen Albrehti ia pikturon duart në formë faljeje. Linjat e detajuara të pikturës, të cilat i japin shprehje dhe ndjesi të thellë asaj, e kanë bërë të famshme këtë pikturë. Edhe pse ajo e vërtetuar si fakt, kjo histori është një lexim universal prekës i artit dhe jetës.



AUTOPORTRETI ALBREHT DYRER

ARTAN SANTO – ana tjetër e bankierit / Shënime për librin e tij “INDIVID”

“Ta mohosh trishtimin është HARDROCK”

Në këto kohëra të trazuara, duket se ajo që e ka më të vështirë për t'u evidentuar dhe për të mbijetuar është poezia. Kjo ndodh vetëm për një fakt fare të thjeshtë. Ndryshe nga realiteti i ofruar (dukshëm mashtrues), nga mjetet e tjera, le të themi, për shembull nëpër spektakle, as sidomos nga politika etj., ku ai zbukurohet, ose pëson deformim të plotë, poezia nuk di të shtiret, nuk di të zbukurojë, apo të mashtrë. Duhet thënë se kjo është e besueshme për gjithë poezinë e vërtetë, nga kushdo të jetë shkruar ajo, por kur poezia shkruhet nga një bankier, siç është z. Artan Santo, këtu ajo merr një kuptim të veçantë. Duke u nisur nga fakti se ai është bankier, ende pa shfletuar librin, mund të të krijohet përshtypja se vargu poetik mund të jetë infektuar nga frohtësia dhe ngurtësia e shifrave, të punës së tij të përditshme. Artan Santo e ka kapërcyer me sukses këtë keqkuptim që mund të të lindë, kur poezinë e shkruan një njeri i lidhur ngushtësisht me shifrat. Është guxim poetik dhe kurajë, që ndërsa je i zhytur në botën e shifrave, të shpalesh edhe një anë tjetër të shpirtit tënd, ndoshta më të bukurën, botën poetike. Në dukje të krijohet përshtypja se këto dy botë qëndrojnë larg njëra-tjetrës dhe t'i ofrosh ato duhet talent. Unë mendoj se ky talent jo vetëm që nuk i mungon, por është përligjur plotësisht nga ana e poetit z. Santo dhe kjo përbën një risi. I singertë deri në dhimbje, si të gjithë poetët, ai nuk ngurron të shpalojë hapur dëshirën që të bëjë ç'është e mundur, që kjo botë të jetë pak më ndryshe, duke u shprehur: “Sa do të doja të të kisha shok / Që ëndërrën tënde para teje ta shihja / Dhe ëndërrën time ty ta falja / Që kësaj bote të mos i jepnim lot”. Ky singëritet zbulohet në mënyrë më intime edhe te poezia “Flokët”, apo “Mikut tim FÇ”, ku fare spontanisht dhe singërisht, gjërat e bukura të shpirtit të tij, e në këtë rast vargjet, ai do t'i ndajë me dikë. Jo vetëm poezia, por edhe proza e shkurtër, madje do të thosha edhe ato pjesë të jetëshkrimit të tij, shkruar në këtë vëllim, tingëllojnë të freskëta dhe të mbajnë të lidhur pas tyre, deri në fund të librit. Poeti është pjesë e realitetit. Ky realitet në të shumtën e rasteve është gri. I dhimbset atdheu i tij, kur në aeroportin e vendit tënd të trajtojnë si njeri të dorës së dytë. Këtë dhimbje ai e shpreh me vargjet: “Atdheun tënd si pa të keq, ta hedh tej”. Ndihet i trishtuar, më shumë se i trishtuar, kur shkruan: “Kushedi sa kohë duhej që të vinin dritat...”. E kjo ndodh se pas çdo poezie, ai ndihet i lidhur ngushtë me vendin e tij, është banor i këtij vendi, por edhe pjesë e pashkëputur e tij. Është bir i kësaj toke dhe si i tillë nuk ka si të mos reflektojë në çdo varg të tij, hallet e shqetësimit e saj. Kjo bëhet herë me dhimbje, apo edhe me nota ironie, siç ndodh te poezia: “Fshatçe”. Vargu i z. Santo, rrjedh natyrisht, i thjeshtë dhe komunikues, duket tentuar të zbulojë anë të veçanta, shpesh të panjohura të botës së poetit, por edhe kur lexuesi ndeshet me problemet e ditës, që duket se i njëh nga afera, forma e të thënit nga poeti, i bën ato më tërheqëse. Artan Santo është i besueshëm në poezi edhe



Autori jo rrallë “arratiset” nga realiteti, po si të thuash kjo arratisje është e kontrolluar. Ai do dhe s’do të jetë larg botës ku jeton. Që në leximin e parë bindesh se bankieri dhe poeti rrinë mjeshtërisht dhe besueshëm pranë njëri-tjetrit. Artan Santo e dashuron poezinë, e ka dashuruar shumë kohë më parë, po kjo dashuri nuk e pengon në të njëjtën kohë që ai të dashurojë edhe punën e tij të përditshme. Artan Santo e ka ndier se ka akumuluar brenda vetes një përvojë poetike

kur trishtohet, ndërsa shkruan: “Brenda meje bie shi”, duke shpalosur një shpirt të tallazitur nga ato që vëren rreth vetes, por

ndihet i lirë në lumturinë, po sidomos në dhimbjen e tij dhe kjo e dyta duhet theksuar. Në këtë kuadër evidentohet e përbashkëta

Ndryshe nga realiteti i ofruar (dukshëm mashtrues), nga mjetet e tjera, le të themi, për shembull nëpër spektakle, as sidomos nga politika etj., ku ai zbukurohet, ose pëson deformim të plotë, poezia nuk di të shtiret, nuk di të zbukurojë, apo të mashtrë.

e të gjithë poetëve, shpirti i tyre i destinuar për t'u ngjizur me dhimbjen si tharmi i vërtetë i poezisë. Lexoni poezinë: “Zukatja e Printerit” dhe do të bindeni për këtë. Aty janë pranë e pranë edhe nëpunësi, edhe një njeri krejt anonim, i cili shfleton gazetën e ditës. “Një tjetër letër të bardhë bërë katran. Së bashku në një tavolinë janë”, apo “Ekspressi i vjetër mbushur me katran, në cep të tavolinës, duke lënë të kup-tosh se ka një lidhje të çuditshme midis katranit të printerit me grinë e jetës së përditshme. Theksova se autori jo arratiset nga realiteti, po si të thuash s’do të jetë larg botës ku jeton. Që në leximin

e parë bindesh se bankieri dhe poeti rrinë mjeshtërisht dhe besueshëm pranë njëri-tjetrit. Artan Santo e dashuron poezinë, e ka dashuruar shumë kohë më parë, po kjo dashuri nuk e pengon në të njëjtën kohë që ai të dashurojë edhe punën e tij të përditshme. Artan Santo e ka ndier se ka akumuluar brenda vetes një përvojë poetike. E ka ndier se ka diçka për të thënë dhe këtë e ka thënë në një formë të bukur. Në asnjë rresht të këtij vëllimi nuk ndihet ngjyrosja, zbukurimi, apo marrja e pozave artificiale. Në këtë botë, ku “nuk ia vlen të jesh i vlerë”, a nëse e huazojmë autorin e librit, ku më së shumti trishtimi është Lento, anashkalimi i këtij trishtimi është rock, ndërsa të mundohesh ta mohosh trishtimin është hardrock, natyra poetike e shpirtit të autorit nuk i anashkalon as këtij trishtimi, as edhe problemeve të tjera që e rrethojnë atë dhe botën ku jeton, por ka ditur të mbledhë grimca të kësaj jete, duke iu trajtuar poetikisht. Nuk është e mjaftueshme të thuash se këtë libër e ka bërë një bankier. Artan Santo është as më shumë dhe as më pak, poet-bankier që në çdo aspekt të veprimtarisë së tij të përditshme, di të zbulojë poezinë.

Sokrat Habilaj



1 VIT ABONIM NE DIGITALB = 15 000 LEKE

1 VIT ABONIM NE SUPERSPORT = 18 000 LEKE

OFERTE



1 VIT ABONIM NE DIGITALB + 1 VIT ABONIM NE SUPERSPORT

= 28 000 LEKE

kjo ofertë mbaron atëherë kur mbarojnë kartat

NGA DIGITALB DHE SUPERSPORT

SHIKIM TE KENDSHEM!



BOTE



Kandidatja e socialistëve francezë për zgjedhjet presidenciale prezanton programin politik

Royal, "pakt nderi" me francezët

Por në në sondazhe kryeson kandidati i së djathtës, Nikolas Sarkozy

Kandidatja socialiste për zgjedhjet presidenciale të Francës, Segolene Royal, ka publikuar dje në Paris programin e saj politik. Ajo lancoi para mbështetësve një platformë prej 100 pikash me një përqendrim të veçantë te programet sociale, duke premtuar paga më të larta dhe ndërtimin e shtëpive me kosto më të ulët. Royal është kritikuar për vonesë në publikimin e platformës së saj, kur kanë mbetur edhe 10 javë nga raundi i parë i zgjedhjeve presidenciale. Ndërkohë në sondazhe ajo është renditur disa pikë më pas se rivali i saj kryesor i së djathtës, Nikolas Sarkozy. Royal paraqiti "paktin e saj presidencial" para një turme entuziaste delegatësh të Partisë Socialiste, që shpesh herë shpërthenin në thirrjet "Segolene, presidente!". "Unë e ndiej sot se kam paraqitur para jush dicka më shumë se një platformë", tha ajo. "Kam paraqitur para jush një pakt nderi, një pakt presidencial që unë ia propozoj gjithkujt, më të dobët dhe më të fortit, atyre që kanë qenë mbështetës tanë dhe atyre që nuk kanë qenë të tillë, sepse Franca ka nevojë për të gjithë francezët". Pjesa më e madhe e 100 pikave të platformës së kandidatës socialiste përputheshin me programin zgjedhor të kësaj partie, të publikuar vitin e kaluar. Të tjera, si propozimet për të ngritur juri qytetare për të vlerësuar punën e Asamblesë Kombëtare dhe kampet e stilit ushtarak për shkelset e mitur të ligjit, janë ide krejtësisht të reja. Segolene Royal veçoi se do të donte të rriste pagat minimale nga 1250 euro, që janë aktualisht në 1500 euro dhe të ndërtonte 120 mijë apartamente me kosto të ulët çdo vit. Asistenca për të papunët do të rritet e po ashtu edhe pensionet për të moshuarit pa mbështetje. Royal ka mbrojtur vendimin e saj për të vonuar shpalljen e platformës së saj politike, duke thënë se ka qenë një "fazë dëgjimi", ka mbledhur ide nga vetë francezët nëpërmjet internetit dhe nëpër takimet e shumta publike të zhvilluara anembanë vendit. Segolene Roy-



al ka qenë ylli politik i Francës gjatë gjysmës së dytë të vitit të shkuar. Ajo njohu një ngritje meteorike për shkak të karizmës së saj dhe aftësisë për të mbledhur mbështetës. Pikërisht falë këtyre cilësive ajo mundi edhe dy nga figurat e larta të Partisë Socialiste në zgjedhjet partiake për kandidatin presidencial. Por, që nga fillimi i vitit 2007,

gjërat duket se ndryshuan. Ka pasur një seri gafash të bëra nga kandidatja socialiste, si dhe shenja të pakënaqësisë së brendshme që padyshim kanë bërë që rivali i së djathtës franceze, ministri i Brendshëm Nikolas Sarkozy të njihte rritje në sondazhe dhe të meritte kryesimin, të paktën përkohësisht.

PREMTIMET

PAGAT
Paga minimale do të rritet nga 1250 euro në 1500, sa më shpejt që të jetë e mundur, gjatë legjislaturës së ardhshme

APARTAMENTET
Do të ndërtohen 120 mijë shtëpi të reja në vit, me kosto të ulët, të cilat do t'i përfutur personat me të ardhura të pakta

JAVA E PUNËS
Negociata për të konsoliduar javën 35-orëshe të punës, si dhe ngritjen e kampave "ushtarakë" për kriminelët e mitur

JURIA
Kandidatja socialiste ka premtuar ngritjen e një juri qytetare për të vlerësuar punën e Asamblesë Kombëtare të Francës

Deklarata

Zyrtarët amerikanë: Armët iraniane vrasin në Irak

Bomba të teknologjisë së lartë që kanë qenë veçanërisht vdekjeprurëse për ushtarët amerikanë në Irak, janë prodhuar në Iran dhe janë dërguar në vendin fqinj sipas urdhrave të "niveleve më të larta" të qeverisë iraniane, tha një zyrtar i zbulimit amerikan të dielën. Ai nënvizoi se nga qershori 2004 e deri javën e kaluar, më shumë se 170 amerikanë janë vrarë nga këto bomba. Këto armë janë në gjendje të shkatërrojnë tanket e ushtrisë. Zyrtari tha se shërbimi amerikan i zbulimit mendon që bombat janë prodhuar në Iran dhe janë dërguar në Irak me urdhër të zyrtarëve të lartë të qeverisë iraniane, gjithsesi ai nuk është ndalur në detaje të mëtejshme. Zyrtarët amerikanë prej vitesh kanë aluduar se armët hynin në Irak nga Irani, por nuk kanë shkruar deri atëherë se të akuzonin liderët kryesorë iraniane në këtë çështje. Zyrtarët amerikanë thonë tani se Irani po punon me ndërmjetësinë e rebelëve shiitë për futjen në Irak të bombave të rrezikshme. Sipas tyre, pjesa më e madhe e komponentëve të këtyre bombave hynin në Irak në afërsi të Amaras, një qytet iranian që kufizohet me Meran dhe Basrën në Irakun e jugut.

Reagimi

SHBA kritikon Putinin: Një Luftë e Ftohtë mjafton

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Robert Gejts, kritikoi të dielën sulmin që Presidenti rus, Vladimir Putin, bëri mbi politikën e jashtme amerikane, duke e cilësuar atë "një retorikë boshë të një spiuni të vjetër" dhe tha se në çdo rrethë, bashkëpunimi me Moskën mbetet i rëndësishëm. Në një fjalim të mbajtur të shtunën në Gjermani, Vladimir Putin theksoi se Shtetet e Bashkuara po e bënin botën një vend më të rrezikshëm për shkak se po ndiqte një politikë që synon ta shndërronte këtë në "superfuqinë e vetme". Një zëdhënës i Shtëpisë së Bardhë tha se ishte "i habitur dhe i zhgënjyer" nga këto komente, ndërsa disa zyrtarë evropianë theksuan se ajo ishte një thirrje rrizgjimi nga një Rusi më e "egër", që është fuqizuar së fundmi nga rritja e çmimeve të naftës dhe gazit të saj. Por, pavarësisht nga këto shqetësime, Shtëpia e Bardhë dhe sekretari Gejts nënvizuan nevojën për bashkëpunim me Moskën. "Ne të gjithë përballemi me probleme dhe sfida të përbashkëta që mund të përballohen në bashkëpunim me vende të tjera, përfshirë edhe Rusinë", tha Gejts. "Një Luftë e Ftohtë është e mjaftueshme. Nuk mund të ketë të dytë".

Zvicra, vendi asnjëanës me mentalitet bunkerësh

Përse vendi alpin vazhdon të përgatitet për luftë bërthamore?

Shumë historianë do të pajtoheshin me faktin se rënia e murit të Berlinit shënoi fundin e Luftës së Ftohtë, por në Zvicër kërcënimet i luftës bërthamore ka lënë një trashëgimi të paprecedente. Nëse udhëton përmes Zvicrës, duke ndjekur jugun drejt Italisë, do të kalosh nëpër Lucernë dhe kjo do të thotë se do të hysh domosdoshmërisht në tunelin Sonnenberg. Këto tunele përreth Lucernës mund të jenë thuajse acurues, veçanërisht kur bën mot i mirë. Të tjerë, siç është Lucernë, mund të jenë një shprehje e pamjenjshmërisë së mentalitetit bunkerësh. Por, Sonnenbergu nuk është thjesht një tunel. Ai është bunker i madh bërthamor në botë. Sipas ligjit zviceran, qeveritë duhet të garantojnë hapësira të sigurta të nëndheshme për çdo banor dhe në fillim të viteve '70 Lucernës i mungonin shumë hapësira të tilla. Dhe tuneli i Sonnenbergut, që sapo ishte ndërtuar, u duk se ishte zgjidhja perfekte: duke e pajisur atë me gjithçka ka nevojë një bunker bërthamor, mund të strehesh aty 20 mijë njerëz. "Në fakt, ne e morëm idenë nga britanikët",

Sipas ligjit zviceran, qeveritë duhet të garantojnë hapësira të sigurta të nëndheshme për çdo banor

shpjegon Verner Fischer, shefi i mbrojtjes civile për Lucernën. "Londinezit e shfrytëzuan nëntokën si një bunker gjatë ndërrhyjeve". Ndoshta kjo mund të jetë e vërtetë. Tuneli i Sonnenbergut fillon me dyert që janë një metër e gjysmë të trasha dhe peshojnë 350 tonë secila. Sonnenberg në teori është në gjendje të bëjë ballë një bombe megatonit, që shpërthen edhe gjysmë milje larg tij. Një bombë një megatonëshe është e barabartë me 70 bomba nga ato që shpërthenin në Hiroshimë. Në bërthamë tuneli është një monument surrealist i dëshirës së Zvicrës neutrale për t'i mbijetuar një

luftë totale që natyrisht do të kishte filluar diku tjetër. Çdo mundësi është menduar mirë. Në tunele ka hapësira të mëdha fjetjeje. Ka një teatër, një postë policie dhe sic nënvizon Fischer, edhe një burg. "Fakti që mund të ketë një luftë bërthamore jashtë nuk do të thotë se ne nuk do të kemi probleme sociale këtu", thotë ai. Ka pasur madje edhe zëra për një projekt zyrtar postare, por gjithsesi shumëkush do të pyeste "kur bota jashtë digjet, kujt do t'i shkrumimim...? Cila do të ishte adresa, për më tepër, kush do ta dërgonte letrën në destinacion?" Pas kësaj, ka edhe drita të ngjyrosura që tregojnë nëse jashtë është ditë apo natë. Dhe pa dyshim vendi që prodhon orët më të famshme në botë, nuk do të dëshiron të humbiste ritmet e kohës. Në këtë tunel mund të ndeshësh në të vërtetë disa hapa gjigandë të inxhinierisë: filtrat e ajrit, të projektuar për të mbajtur gjallë 20 mijë frymë me 192 metra kub oksigjen jo radioaktiv për kohë të ditë. Ata janë në të vërtetë mahimtarë. Për më tepër, salla ku ata gjenden ka dimensionet e një katedraleje mesjetare.



Bunkerë me zgjedhje

Por, ndërsa Sonnenbergu mund të jetë bunker i më i madh, kjo nuk do të thotë që ai është i vetmi. Në fakt, ka më shumë se një qerlek milion bunkerësh të tillë në Zvicër, kjo për shkak se 17 vjet pas përfundimit të Luftës së Ftohtë politika e ndërtimit të bunkerëve për të gjithë popullatën vazhdon të qëndrojë në fuqi. Ka nga ata zviceranë që kanë edhe bunkerë privatë në shtëpitë e tyre, që ditët e sotme më së shumti përdoren për të "magazinuuar" mallra të ndryshme, duke filluar që nga vera e deri te skitë. Sipas zyrës lokale të mbrojtjes civile, ka 40 për qind më shumë vende në bunkerë për popullatën. E pra, në rast se do të ndodhte e paimagjinueshmja, shumëkush në Zvicër do të kishte luksin të zgjidhte. Mund të

zgjedhësh një bunker pranë shtëpisë të projektuar për 10 persona. Ka gjithsesi edhe plot bunkerë më të mëdhenj, ku "rreziku" i mërzitjes do të ishte disi më i vogël. Ndërkohë, në shumë shtëpi të reja që po ndërtohen, vlihet re se buldozerët gërmojnë thellë në tokë për të plotësuar standardet e një bunker bërthamor privat. Por përse duhet situatë përfaqësues 4 për qind e vlerës së shtëpisë vetëm për t'u përgatitur për një kërcënim, që në fakt asnjëherë nuk është zhdukur? Karl Vidmer, zëvendës drejtor i mbrojtjes civile në Zvicër, thekson: "Ne shpesh ia bëjmë vetes këtë pyetje. Por, nëse e mendon mirë, nuk ka asgjë të keqe në marrjen e masave për çdo rast. Në çdo moment mund të ketë një rrezik të ri".



SPORT



Kampionët janë shumë larg formës së shfaqur në dy sezonet e fundit, duke rënë në vendin e 6-të



DELIU

Ish-trajneri i Elbasanit u largua nga drejtuesit e skuadrës pas javës së 17-të, ndërsa ai e mori vesh lajmin nga mediat, pasi shkarkimi nga detyra nuk i ishte komunikuar



Barazimi me Apoloninë rrezikon postin e Gëzdarit në stolin e skuadrës. E detyrueshme fitorja me Teutën javën e ardhshme

Lëkundet përsëri pankina e Elbasanit

Mungesa e rezultateve pozitive afër "gijotinën" e trajnerit

ERMAL KUKA

Dy rezultate aspak të pranueshme për Elbasanin, humbja në shtëpi me Partizanin dhe së fundmi barazimi me Apoloninë kanë komplikuar situatën e Edmond Gëzdarit në stolin e skuadrës kampione. Trajneri i afruar në pjesën e dytë të sezonit pranë verdhebluve, tashmë rrezikon të largohet pa lënë gjurmë në ecurinë e ekipit. Rënia e skuadrës në vendin e 6-të në renditje dhe largimi i tifozërisë nga skuadra ka bërë që presidenti Laze të rishikojë pozitën e trajnerit të tij dhe të fillojë të mendojë sa më parë për një zëvendësues të mundshëm.

Largimi i 18 lojtarëve gjatë merkatos së janarit dhe afrimi i elementëve të tjerë me eksperiencë nga kampionati vendas dhe kampionatet e huaja nuk ka sjellë ndryshimin e pritur nga verdheblutë, që është shprehur veten jashtë luftës për kreun, por aktualisht edhe jashtë Evropës. Nëse për trajnerin e mëparshëm të verdhebluve, Luan Deliu, rezultati fatal eliminimi nga Kupa e Shqipërisë, presidenti Laze duket se nuk po kënaqet as me punën e pasardhësit të tij, pasi skuadra ka rënë ndjeshëm në renditje. Sikur të mos mjaftonte humbja në shtëpi me Partizanin, Elbasani është larguar i turpëruar këtë fundjavë nga Fieri, pasi barazimi me Apoloninë vendosë, që gjendet në vendet e fundit në klasifikim. Nga burime pranë verdhebluve, mësohet se presidenti nuk ka fajësuar lojtarët për këtë situatë, por pikërisht trajnerin, i cili ka marrë të gjitha përformimet që ka kërkuar, por ende nuk ka arritur të garantojë rezultate. Mësohet se Laze ka vendosur që tani një objektiv minimal, atë të fitores në javën e ardhshme kundër Teutës së vendit të tretë në renditje. Nëse Gëzdarin nuk do të arrijë të ndërtojë një formacion të aftë për t'u përballur me një nga skuadrat rivale, mësohet se presidenti Laze do të fillojë të kërkojë menjëherë zëvendësuesin e tij. Presidenti ka hartuar prej kohësh një listë me emra që mund të zëvendësojnë



Gëzdarin, në rast dështimi të këtij të fundit. Nuk janë bërë ende të diskutuar emrat e trajnerëve të mundshëm që figuronë në këtë listë, por është mësuar se bëhet fjalë për teknikë që kanë drejtuar skuadrat më në zë të

kampionatit shqiptar në vitet e fundit dhe që aktualisht janë pa një kontratë.

Sot, në klubin verdheblu pritet të zhvillohet një analizë e hollësishme e asaj që ka ndodhur në

KOMENT

NGA GËZIM SINEMATI

Nuk është coincidentë ajo që ndodh pas ndeshjes me Maqedoninë. Të parët që tentojnë t'i bëjnë kozmetikë humbjes janë veteranët. Kapiteni Tare, që nuk luan me Lacion, por që ka autoritetin e njeriut që ndikon në formacion të kuqezinjëve, mendon se ishte një miqësorë ku u provuan të rinjtë. Emri i Hykës është alibia më e përshtatshme. Në të vërtetë, këtë miqësorë mund ta pagëzosh edhe si ndeshjen e veteranëve të lodhur. Duke filluar me Hasin, Haxhin dhe vetë kapitenin Tare. Bile edhe Altin Lala është krejt njeri tjetër kur e shikon pas disa ditësh në Bundesligë me Hanoverin. Ashtu si Brigel, edhe profesor Otto Baric ka zotësinë të tregohet i paqëndrueshëm në ato që thotë publikisht: "Nuk do të ketë më futbollist që do të luajë me Kombëtaren pa pasur ekip..." Ky vendim nuk cenon Taren, i cili konsi-

Profesor Otto na kishte premtuar se nuk do të shikonim në fushë futbollistë që nuk luajnë me klubet e tyre. Siç duket ai ngatërron Bogdanin me Taren?!



Partizani

As fitorja nuk kënaq Xhanin

Ndonëse Partizani është ngjitur në vendin e dytë në renditje, presidenti i të kuqeve, Albert Xhani, nuk është i kënaqur plotësisht me skuadrën e tij. Pas ndeshjes të së shtunës me Kastriotin, ai i ka "tërhequr veshin" trajnerit Lika për mënyrën se si ka luajtur skuadra. Mësohet se Xhani nuk ka qenë dakord me mënyrën se si skuadra është përpjekur më shumë të mbrojë avantazhin se sa ta thellojë atë, duke u përqendruar më shumë në shkatërrimin e aksioneve të kundërshtarëve se sa në krijimin e rasteve të tjera për shënim. Por, në krahasim me herët e tjera, Xhani e ka cilësuar gjithçka si "kritikë konstruktive", duke mos dashur të shkatërrojë gjithë punën e mirë të bërë deri tani. Të kuqet janë në vendin e dytë në kampionat dhe ende në garë për kualifikimin në gjysmëfinalen e Kupës së Shqipërisë.

fundjavë, duke ndarë edhe fajet mbi secilin. Por, ashtu si në javën e kaluar, ndërsa nuk mohohet mundësia e vendosjes së gjobave ndaj disa prej futbollistëve. Ashtu si për Gëzdarin, presidenti i kampi-

onëve do të paralajmërojë që gjithë futbollistët që në rast të mosarritjes së objektivave minimale, do të largohen pas shumë ceremoni nga ekipi, që në vitet e fundit ka qenë gjithmonë afër kreut të renditjes.

Një humbje për të cilën kemi meritë...

derohet edhe nga shefat si i "pazëvendësueshëm" dhe Bogdani, futbollisti më i kushtueshëm shqiptar, tradhtohet edhe njëherë. Zërat brenda Kombëtares thonë se Baric ka bërë ritualin e zakonshëm, duke ndërruar formacionin disa herë në momentet e fundit. Mjegulla në kokën e tij bëhet më e madhe kur "veteranët", me në krye Taren, imponohen për të krijuar 11 vetat që do të zbrisin në fushë.

Humbja me Maqedoninë nuk i përket vetëm shifrave. Ajo ishte një humbje e porositur po të kujtohet stili në të cilin u zhvendos kjo ndeshje në Shkodër, aventurën e këmbimit të hoteleve nga kuqezinjët dhe deklaratat tymuese se "kjo miqësore duhet fituar për shumë arsye".

Nuk është rastësi që presidenti Duka tregohet i zhgënjyer nga punonjësit e tij, aq sa edhe të gjobisë dy prej tyre. Ndërkohë harrohet gjoba e shkatërratë e vërtetë të turpit të radhës.

Legjionarët



Bogdani, sërish i "padukshëm"

Bushi-Curri, golat kuqezi të fundjavës

Nëse Bogdani dhe Tare vazhdojnë të zhgënjëjnë, sulmuesit e tjerë shqiptarë që militojnë në kampionatet evropiane nuk e kanë të vështirë të gjejnë rrugën e rrjetës. Alban Bushi dhe ka qenë protagonist në fitoren e skuadrës së Apollon Kallamarias me rezultatin 3-1 kundër PAOK-ut. Sulmuesi i përfaqësueses shqiptare, i lënë në hije në dy vitet e fundit nga Brigel dhe tashmë edhe Baric, ka treguar përsëri se nuk e ka humbur nuhatjen e golit. Sulmuesi e ka filluar ndeshjen si titullar dhe ka qenë protagonist thuhet në çdo aksion të rrezikshëm të ekipit të tij. Nëse në pjesën e parë ai nuk arrin të gjejë rrugën e rrjetës, në 45 minutat e dyta është padyshim lojtari i ndeshjes. Vetëm 3 minuta pasi fillon pjesa e dytë, Bushi gjuan në portë, portieri grushton dhe Favali arrin të kthejë topin në rrjetë. Por Bushi nuk ndalet me këtë asist, pasi vë firmën e tij në rezultat në ndeshjes në minutën e 58-të, kur shfrytëzon një harkim të Favali për të dërguar topin në rrjetë me një guajtje të fuqishme. Sulmuesi shqiptar do të shënojë përsëri 10 minuta më pas, por këtë radhë goli i tij është anuluar për pozicion jashtë loje. Në minutën e 83-të, ai është shfaqur i vetëm para portierit kundërshtar, por guajta e tij ndalet nga shtylla pingule dhe më pas Orfanos arrin të ndjekë aksionin dhe të dërgojë topin në rrjetë.

Për sulmuesin shqiptar kjo ka qenë padyshim ndeshja më e mirë e sezonit, pasi ai ka ndihmuar skuadrën të largohet nga fundi i tabelës së klasifikimit në pozitë më të kënaqshme në renditje. Ky ishte goli i 5-të në këtë sezon për Bushin. Por ai nuk ka qenë i vetmi kuqezi që ka shënuar në këtë fundjavë. Në Bundesligën 2, Skeridilaj Curri ka shënuar golin e ndër të humbjen 2-1 të Aue përballë Groiter Furth. I aktivizuar si zëvendësues në pjesën e dytë të takimit, sulmuesi kavajas ka shënuar në minutën e 89-të të ndeshjes me një guajtje të fuqishme nga distanca, si për t'i treguar trajnerit se meriton më shumë minuta në dispozicion. Ndërkohë, Bogdani ka luajtur si titullar me Kievon përballë Interit, por pa arritur të rrezikojë asnjëherë portën kundërshtarë. Ndërsa Tare është futur në fushë vetëm si zëvendësues në minutat shpesh, duke qenë vetëm figurant në takimin Atalanta-Lacio.

e. kuka

Roma ruan ritmin për kreun në Serinë A. Milani fiton me Ronaldon në fushë, ndalet Palermo

Interi, mbretëresha e re e Evropës

Skuadra zikaltër barazon rekordin e Realit me 15 fitore radhazi në kampionat

Interi rrëmben edhe fitoren e 15 radhazi, duke barazuar rekordin evropian që mbahej nga Real i Madridit, pasi ka nënshtruar jashtë fushë Kievon me rezultatin 2-0. Në Bentegodin e shkretë nga tifozët, për shkak të dekretit të ri mbi dhunën që shkaktoi edhe ngjarjet tragjike në Katania, zikaltrit kanë gjetur suksesin falë golave të Adrianos dhe Krespos. Braziliani ka rigjetur muzën e tij virtuoz dhe pa përfunduar kronometri i minutës së parë të takimit, topi i shkëlmuar nga e majta e Perandorit do të varet në rrjetën e Sicilianos. Pjesa e parë mbyllet me rezultatin 1-0, ndërkohë që 6 minuta nga fillimi i së dytës, Hernan Krespo thumbon sërish me një gjuajtje të fuqishme nga jashtë zone, për të siguruar fitoren e zikaltrëve, që vazhdojnë të mbajnë ende me 11 pikë larg Romën. Verdhëkuqtë kanë ruajtur ritmin e kreut, duke fituar në Olimpiko me 3-0 me Parmën. Nuk ka munguar edhe goli i kapitenit Toti, që ka thyer rekordin e prezencave në fushë me romanët, plot 452 ndeshje. Perrota dhe Tadei kanë rumbullakosur shifrat. Surpriza e javës padyshim është Palermo, i cili humbet në shtëpi me Empolin, falë një goli të shënuar nga Almiron, që u jep të drejtë toscanëve të ngjiten në vendin e katërt, duke përfutur edhe nga barazimi 1-1 i Katanias me Mesinën. Ky takim, në fakt, ka nisur një orë me vonesë, për shkak të kohës së keqe. Miqet nga Katania kanë kaluar të parët në avantazh me Zankin, por Maskara ka barazuar shifrat në pjesën e dytë për Mesinën. Ronaldo ka bërë debutimin në Serinë A dhe Milani ka fituar në San Siro me Livornon. Fenomeni ka bërë një prezantim të shkëlqyer në rikthimin e tij të dytë në Milano, ndërkohë që Gatzuo dhe Jankulovski i kanë dhënë të drejtë skuadrës kuqezi në San Siro, që ka hapur dyert vetëm për abonentët. Gatzuo ka shënuar në minutën e 29-të, Lukareli pas dy minutash ka barazuar, ndërkohë në të 68-ën me supergol ka afruar Milanin me Ligën e Kampionëve. Fiorentina ka arritur një fitore shumë të rëndësishme me Udinezin 2-0, me golat e Reginaldos dhe Pacinini. Nuk ka shkuar më shumë se një 0-0 në Bergamo Lacio kundër Atalantës. Në barazim është ndarë edhe takimi mes Kaljarit dhe Stenës 2-2. Sampdorias i janë dashur dy gola për të formuluar fitoren e saj kundrejt Askolit të vendit të fundit, Maxhio dhe Françesini, autorët e golave. Bie sërish në shtëpi Torino, këtë herë e ndëshkuar nga Rexhina, që duket se ka vendosur të shpëtojë kategorinë. Skuadra e Xakeronit është nënshtruar me rezultatin 2-1 dhe tashmë ndahet vetëm me 3 pikë diferencë nga kalabrezët.

ITALI SERIA A

REZULTATET

Atalanta - Lacio	0-0
Kaljari - Siena	2-2
Kievo - Inter	0-2
Fiorentina - Udineze	2-0
Milan - Livorno	2-1
Palermo - Empoli	0-1
Roma - Parma	3-0
Sampdoria - Ascoli	2-0
Torino - Rexhina	1-2
Mesina - Katania	1-1

KLASIFIKIMI

Skuadra	Nd.	Pik.
Inter	22	60
Roma	22	49
Palermo	23	42
Empoli	22	32
Lacio	22	31
Katania	23	31
Milan	22	30
Atalanta	22	29
Udineze	22	29
Sampdoria	22	27
Fiorentina	22	25
Siena	22	25
Kaljari	22	23
Livorno	22	23
Torino	22	22
Rexhina	22	19
Kievo	22	18
Mesina	22	17
Parma	22	15
Ascoli	22	12



PORTUGEZI

Fantazisti luzitan kërkon 8,3 milionë sterlina në vit nga "Dajhtë e kuq"

Kristiano Ronaldo bën kokëfortin: Dua të jem futbollisti më i paguar

Kristiano Ronaldo ka filluar të mendojë seriozisht idenë për të qenë futbollisti më i paguar në botë. Në fakt, deklarata më e fundit e asit të Manchester Junajtid është një kërcënim i vërtetë për klubin që ka pronesin e kartonit të mesfushorit: "Bëmëni futbollistin më të paguar në botë ose në të kundërt do të largohem nga Manchester Junajtid"

“

"Bëmëni futbollistin më të paguar në botë, ose në të kundërt do të largohem nga Manchester Junajtid"

”



tuesit e "Dajhtë e kuq" për rinovimin e kontratës me shogërinë, ndërsa kanë bërë të ditur edhe kontaktet me klubet e tjera evropiane. "Kemi nisur shumë kontakte me shume klube evropiane - ka deklaruar një zë i afërt me Kristiano Ronaldon, në një in-

“

"Nëse Junajtid beson se ai është futbollisti më i mirë në botë, atëherë duhet ta paguajë më shumë"

”

garë dyshe për të tentuar blerjen e fantazistit. Sipas asaj që zbulon tabloidi britanik "The Sun", Barcelona dhe Real i Madridit janë duke përgatitur ofertat e tyre për portugezin, që duket se po e shfrytëzon më së miri këtë moment. Dy klubet e fuqishme spanjolle janë të gatshme të derdhin 60 milionë euro për futbollistin e Kombëtares portugeze. Klubi katalanas ka mbështetjen e sheikut Mansour Al-Balawi, multimiliarderi i klubit saudit Al-Itihad, i cili është gati të ofrojë 30 milionë sterlina për të ndihmuar presidentin Laporta, me të cilin ai punon në disa biznese të tij.

tivist të publikuar nga "News of the World" - por nëse Junajtid beson se ai është futbollisti më i mirë në botë, atëherë duhet ta paguajë me shumën më të lartë në botë", përfundon deklarimi. E ndërkohë që portugezi ka vënë limitet e tij, ka nisur një

PRIMERA DIVISION

REZULTATET

Selta Vigo-Espanjol	0-2
Getafe-Valencia	0-2
Gimnastik-Osasuna	2-3
Levante-Rekreativo	2-1
Majorka-Saragoza	2-1
Vilareal-La Korunja	0-2
Barcelona-Rasing	2-0

KLASIFIKIMI

Skuadra	Nd.	P
Barcelona	22	46
Sevilja	22	43
Real Madrid	22	41
Valencia	22	39
A. Madrid	21	36
Saragoza	22	35
Getafe	22	35
Rekreativo	22	33
Osasuna	22	30
Espanjol	22	29
Rasing	22	29
La Korunja	22	29
Vilareal	22	29
Majorka	22	26
Betis	22	25
Levante	22	25
A. Bilbao	21	22
Selta Vigo	22	22
R. Sociedad	22	14
Gimnastik	22	13

PREMIERSHIP

REZULTATET

Bolton-Fulham	2-1
Arsenal-Uigan	2-1

KLASIFIKIMI

Skuadra	Nd.	P
Man Utd	27	66
Çelsi	27	60
Liverpul	27	50
Arsenal	26	49
Bolton	27	47
Riding	27	43
Portsmouth	27	41
Everton	26	39
Njukasëll	27	36
Billebërn	27	34
Totenhem	26	33
M'sboro	27	32
Aston Villa	27	32
Fulham	27	32
Sheffild	27	30
Man Siti	26	30
Uigan	26	25
Uest Hem	27	20
Çariton	27	20
Uotford	26	18

BUNDESLIGA

REZULTATET

B. Mynih-A. Bilefeld	1-0
Bohum-Nyrenberg	0-2

KLASIFIKIMI

Skuadra	Nd.	P
Shalke	21	48
Verder	21	42
Shtutgart	21	41
Bajern M.	21	37
Herta	21	33
Nyrenberg	21	33
Leverkusen	21	29
Hanover	21	27
B. Dortmund	21	25
Volfsburg	21	24
A. Bilefeld	21	23
Frankfurt	21	23
E. Kotbus	21	22
Mainz	21	21
Bohum	21	20
A. Ahen	21	20
B. M'gladbach	21	20
Hamburg	21	18

Trajneri

Hidink refuzon ofertën e Çelsit

Trajneri holandez, Gus Hidink, ka hedhur poshtë mundësinë e afërimit në pankinën e Çelsit para mbarimit të kontratës së tij me përfaqësuesen e Rusisë. Ndonëse trajneri është një mik i Roman Abramoviç dhe është kandidati kryesor për të zëvendësuar Murinjon, ai vetë ka preferuar që të respektojë paktin me drejtuesit e federatës ruse. "Nuk kam folur me Roman Abramoviç rreth kalimit tim te Çelsi. Do të jem në drejtimin e përfaqësueses së Rusisë deri në verën e vitit 2008, ndaj tani për tani mendoj për gjëra të tjera", ka deklaruar trajneri holandez për tabloidin anglez, "Mail On Sunday".



Spanjë

Getafe poshtëron Valencian

Skuadra e Getafes i ka dhënë fund ëndrrave të Valencias për titullin kampion, duke e mundur me rezultatin 3-0. Vendasit kanë zhvilluar një pjesë të dytë të jashtëzakonshme, duke shënuar menjëherë me anë të Kotelos, ndërsa Guiza dhe Naço kanë vluosur rezultatin përfundimtar. Me këtë fitore, Getafe është ngjitur në vendin e 7-të në renditje, ndërsa Valencia ka mbetur në vendin e katërt në klasifikim, duke mos arritur të mbajë hapin e kryesuesve. Majorka ka arritur të ndalë një tjetër pretendente për zonën e kupave të Evropës, Real Saragozën, pas fitores 2-1 që i ka larguar ishullorët nga zona e ftohtë e klasifikimit.



së shpejti
në
Shqipëri

Përfaqësues për Shqipërinë
Kosovën dhe Maqedoninë



GGG

sot
ora 21:00



SHQIP nga Rudina Xhunga në TOP CHANNEL



Fushata elektorale në vend.

Ngjarjet kryesore të javës, cilat janë perspektivat pas zgjedhjeve, nën vëzhgimin e analizën e gazetarëve e analistëve të njohur në vend.